

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Çështje Europiane dhe të Sigurisë - 20

ÇËSHËTJE EUROPIANE DHE TË SIGURISË

EUROPEAN AND SECURITY AFFAIRS

Revistë katërmujore mbi sigurinë

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Bordi botues:

Prof. Dr. Rexhep Meidani (kryetar)

Prof. Asoc. Dr. Kristaq Xharo (anëtar)

Prof. Asoc. Dr. Arshi Çela (anëtar)

Dr. Eranda Gjomema (anëtar)

Elona Dhëmbo, Kandidate për Dr. (anëtar)

Redaktor përgjegjës:

Elira Hroni – MA

Ndihmuan në përgatitje:

Besiana Kuçi

Egest Gjokutaj

Ky numër reviste botohet me mbështetjen financiare të
Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s dhe
Fondacioni Shoqëria e Hapur OSI Think tank Fund

PËRMBAJTJA

Cristina Galusca

Perspektivat e zhvillimit të Ballkanit Perëndimor në lidhje me
Sigurinë dhe bashkëpunimin ekonomik 9

Enis Fita, Phd ©

Sfidat e Sigurisë Globale dhe domosdoshmëria e
Bashkëpunimit Rajonal për Integrimin e Ballkanit
Perëndimor 32

Florian Trauner

Qeverisje nëpërmjet kondicionalitetit, qeverisje në rrjet apo të
dyja? Studimi i politikave të brendshme të Sigurisë së BE-
së, në Ballkanin Perëndimor 46

Genti Bardhi

Aspekte të Sigurisë Rajonale në Ballkan dhe impakti mbi
Bashkëpunimin Rajonal 58

Jonida Hoxha, LLM

Zhvillimi i Paktit të Stabilitetit dhe modelet e Bashkëpunimit
Rajonal në Fushën e Sigurisë të fituara prej tij. 76

Rade Rajkovchevski, MSC dhe Dimitar Kirkovski, MA

Dimensioni Rajonal i pjesëmarrjes në misionet jashtë
vendit 82

Abstracts 75

PARATHËNIE

Në përpjekje për të kontribuar në informimin e publikut mbi çështjet kryesore të politikave, mbi reformat dhe performacën e Sektorit të Sigurisë në përgjithësi, trendet evropiane dhe globale të sigurisë, debatin aktual dhe të ardhshëm mbi fushat prioritare të NATO-s, sfidat e Shqipërisë për reformimin e institucioneve dhe qeverisjes në sektorin e sigurisë, çështjet debatuese dhe partneritetet e NATO-s, me BE-në dhe organizatat e tjera botërore, ky numër i Revistës për Çështjet Evropiane dhe të Sigurisë vjen me një tematikë të veçantë mbi: *“Perspektivat e Reformave në Sektorin e Sigurisë në Shqipëri: Reforma dhe Sfida të Strukturave Rregullator Ligjore dhe Kushtetuese”*.

Kjo fushë studimi duke u përqendruar te sfidat dhe problemet e reformave ligjore në Sektorin e Sigurisë në vend, sjell njëkohësisht një panoramë më të gjerë të perspektivës evropiane në qeverisjen e Sektorit të Sigurisë apo të aktorëve të tjerë që kanë një impakt domethënës mbi këtë sektor.

Cristina Galusca*

PERSPEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR, NË LIDHJE ME SIGURINË DHE BASHKËPUNIMIN EKONOMIK

Kriza e thellë ekonomike kërkon rivlerësimin e dobishmërisë së instrumenteve të politikave të BE-së. Thuhet se fondet strukturore dhe ato të kohezionit duhen përdorur më shumë për t'u përballur me efektet e recesionit dhe për konsolidimin fiskal në vendet e zonës Euro.

Sfidat aktuale ndaj paqes dhe sigurisë kërkojnë një përgjigje globale e cila bazohet në bashkëpunim dhe në një sistem multilateral efikas. Në nivelin e sistemit financiar dhe ekonomik, në shtetet përbërëse të ish-Republikës Federale të Jugosllavisë mund të flitet për një zhvillim të diferencuar që nxitet nga politikat kombëtare specifike. Të gjithë vendet nevojitet të fokusohen tek qeverisja e mirë, shteti i së drejtës dhe tek përshpejtimi i reformës ekonomike.

Vendet e Ballkanit Perëndimor janë të rrethuara nga të gjitha anët nga vendet anëtare të BE-së. Perspektiva e anëtarësimit i inkurajon këto vende që të kenë prioritet objektivat që ato ndajnë së bashku me vendet e BE-së. Bashkëpunimi ndërmjet NATO-s dhe BE-së, në Ballkan mundësoi shembullin më të mirë të asaj çfarë dy organizatat mund të bëjnë së bashku.

Fjalë kyçe: bashkëpunimi rajonal, perspektivat e anëtarësimit, sistemi ekonomik

* Cristina Galusca (cristinagalusca@gmail.com) është Doktrante në universitetin Kombëtar të Mbrojtjes "Carol I". Ajo ka punuar si Atashe Diplomatike në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe aktualisht është konsull në Konsullatën e Përgjithshme të Rumanisë në Balti, Moldavi. Ajo është diplomuar në Akademinë e Studimeve Ekonomike, Bukuresht, në Fakultetin e Kibernetikës, Statistikave dhe Informatikës Ekonomike. Më pas është specializuar në Marrëdhënie Evropiane dhe të drejtë ndërkombëtare, duke ndjekur dy programe master në Akademinë e Studimeve Ekonomike dhe në Fakultetin e Marrëdhënieve ndërkombëtare dhe një në Francë në universitetin e "Orleans".

Hyrje

Për shumicën e vendeve të Ballkanit, tranzicioni drejt ekonomisë së tregut ka hapur një epokë të re të bashkëpunimit ekonomik dhe të marrëdhënieve të përfitimit reciprok ndërmjet tyre. Për fqinjët e tyre, ky zhvillim ka kontribuar për rivendosjen e marrëdhënieve historike, ekonomike dhe tregtare me këto vende, marrëdhënie të cilat gjatë periudhës së pasluftës së dytë botërore, kanë qenë në kontraktim të vazhdueshëm në terma relativë. Edhe pse konfliktet e armatosura, diferencat politike dhe pabarazitë ekonomike të brendshme nuk lejojnë zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike me të gjitha vendet fqinje, ato kanë vendosur lidhje ndërmjet tyre në fushat e tregtisë, investimeve, lëvizshmërisë së punës dhe bashkëpunimit teknologjik.

Kriza ndërkombëtare nxori në pah dhe theksoi ndasitë brenda BE-së. Termi *“gjeometri e ndryshueshme”* çon vite mbrapa origjinën e krizës ekonomike. Ne flasim në këtë punim për mungesën e konvergjencës ekonomike, tensionet në mekanizmat vendimmarrës, dhe dështimit të politikave të BE-së. Dimensionet e gjeometrisë së ndryshueshme mund të jenë të rrezikshme nëse analizojmë situatën në terma të ekonomive të vendeve të BE-së. Krizat sovraane të borxheve kanë ndarë zonën Euro në dy pjesë: një grup që ka dalë nga recesioni dhe që nuk i është dashur të përdorë masa shtrënguese (konsolidimi fiskal), dhe një krah jugor (plus Irlanda) i cili po kërcënohet nga dinamikat e rretheve vicioze.

Rajoni i Ballkanit është veçanërisht i prekshëm në këtë fushë për shkak të mungesës së stabilizimit automatik dhe mospasjes së sistemeve të mbrojtjes sociale si dhe për mungesë të një aksesimi të lehtë tek mekanizmat e mbështetjes dhe ato financiare të zonës Euro. Në një kontekst evropian më të gjerë kriza ka pasur së paku tre efekte negative mbi Ballkanin:

- **Së pari**, duke qenë e shqetësuar me çështjet ekonomike, BE-ja ka vendosur zgjerimin në vend të dytë të agjendës së saj

- **Së dyti**, lufta kundër krizës së burimeve merr shumicën e resurseve të qeverive të Ballkanit si dhe vëmendjen ndaj reformave që kërkohen për aderim.

- **Së treti**, duke qenë se BE-ja, kërkon krijimin e një regjimi të ri qeverisjeje ekonomike, nuk ka asnjë dyshim se, një theks më i madh do të vendoset tek politikat ekonomike dhe financiare të vendeve candidate. Ndoshta BE-ja, do të përpiqet të parandalojë drejtpërdrejt ose indirekt hyrjen e vendeve të cilat në përgjithësi perceptohen si të dobëta ekonomikisht dhe të paafta për të bashkëpunuar me rregulla më strikte.

Rajoni i Ballkanit Perëndimor: situata ekonomike dhe impakti i krizës financiare

Vendet jashtë zonës Euro grupohen në disa kategori sipas masës së disniveleve në fazën e konsolidimit fiskal ku ato ndodhen (ku nevojiteshin dhe përshtatjet më kryesore), rregullave të politikës monetare dhe kursit të këmbimit nëse ato kërkojnë ndihmë financiare të jashtme, si edhe nëse vendet janë ose jo pjesë e zonës *Schengen*. Nëse BE-ja, nuk krijon politika efikase për të stimuluar konvergjencën ekonomike, mekanizmat e thjeshtë në nivel kombëtar nuk do të jenë të afta të përballen me tendencat e fragmentizimit ekonomik. Kriza e thellë kërkon rikonsiderimin dhe dobishmërinë e instrumenteve politike në nivel evropian. Disa argumentojnë se, fondet strukturore dhe ato të kohezionit duhen përdorur kryesisht për balancimin e efekteve të recesionit mbi konsolidimin fiskal në vendet e zonës Euro. Rumania për shembull, është ende në nivel të ulët për sa i përket thithjes së këtyre fondeve evropiane.

Kriza botërore e ushqimit ka nxjerrë në pah një aset me vlerë të veçantë të vendit tonë: tokën me cilësi të mirë. Toka bujqësore në Rumani është një aset që duhet kapitalizuar më aftësisht për të përfutur fonde nga BE-ja, për modernizimin e zonave rurale, (reforma e Politikës së Përbashkët Bujqësore (CAP, PPB)). Mund të vërehet se anëtarësimi në BE ashtu si edhe ai në zonën Euro, nuk përjashton më një vend nga mundësia e ndërmarrjes së një përfshirjeje shumëpalëshe me donatorët ndërkombëtarë (FMN, BB dhe BERZH). Rumania duhet të konsiderojë me kujdes propozimet për reformim të qeverisjes ekonomike të BE-së. Ne na nevojitet:

- Pasja e konsolidimit fiskal për të mos krijuar premisa për ulje të rritjes së qëndrueshme duke ulur shpenzimet publike në nivele kritike.

- Një planifikim shumëvjeçar të buxhetit sipas koordinimit politik të BE-së.

- Të luftojmë korrupsionin në sektorin publik.

Nëse analizojmë rritjen e çmimeve të konsumit, Rumania renditet e para në Bashkimin Evropian: në janar të vitit 2011 ato u rritën me 7%, krahasuar me muajin e parë të vitit 2010, ndërsa inflacioni i BE-së, ishte 2.7%, sipas të dhënave të *Eurostatit*. Në muajin e fundit të vitit 2010, çmimet e konsumit në Rumani u rritën me një normë vjetore prej 7.9%, e cila ishte më e larta në BE ku ky indikator shënonte 2.7%. Në krye të vendeve me inflacion të lartë që prej janarit të vitit 2011, Rumania ndiqet nga Estonia (5.1%) dhe nga Greqia (4.9%). Nivelet vjetore më të

ulëta të inflacionit vërehen në Irlandë (0.2%) dhe në Suedi (1.4%). Në Hungari çmimet e konsumit janë rritur me një normë vjetore prej 4%, dhe në Bullgari me 4.3%. Në Gjermani, Francë dhe Angli inflacioni qëndroi në nivelet 2%, 1.9% dhe 4%. Krahasuar me dhjetorin e vitit 2010, inflacioni vjetor u rrit në 15 vende anëtare dhe u ul në vende të tjera. Instituti Kombëtar i Statistikave njoftoi në shkurt se, inflacioni vjetor kishte rënë nga 7.96% në dhjetor 2010 në 6.99%, në janar 2011 pas rritjes së nivelit mujor me 0.77%, kryesisht si pasojë e çmimeve më të larta të perimeve, frutave, karburantit, ngrohjes, librave, revistave dhe gazetave.

Për Rumaninë pritet stabilizim dhe rritje ekonomike. Edhe pse PBB-ja, ka rënë gjatë çerekut të fundit të vitit 2010, indikatorët pritet të rimarrin rritjen gjatë vitit 2011. Rritja pritet të jetë rreth 1-1.5%, pasi arriti në 2% gjatë vitit 2010. Inflacioni është projektuar pak mbi 8% në fund të vitit 2011 si rrjedhojë e rritjes së TVSH-së. Përmirësimi i përthithjes së fondeve strukturorë të BE-së, është kryesor për sigurimin e investimeve të nevojshëm në fushat që përbëjnë shqetësimet specifike të buxhetit. Sistemi bankar u prek nga kriza por ka ende kapital të mirë dhe likuiditet. Kreditë e këqija ka gjasa të vazhdojnë të rriten deri në mes të vitit 2011, për shkak të aktivitetit të dobët ekonomik. Rezervat e kapitalit mbeten të mëdha. Bilanci i pagesave mbetet gjerësisht i pandryshueshëm. Deficiti aktual mbetet tek rreth 5.5% e PBB-së, dhe parashikohet të rritet në 6% deri në vitin 2012.

Reformat e imponuara dhe masat e ndërmarra mund të përshtaten lehtësisht për vendet e Ballkanit Perëndimor. Përgjatë çmontimit të regjimeve autoritare, zhvillimet e fundit në disa vende të rajonit tregojnë universalitetin e vlerave demokratike dhe të Drejtave të Njeriut. Nuk mund të arrihet progres në paqe dhe zhvillim nëse injorohen të Drejtat e Njeriut dhe Demokracia. Sfidat aktuale për paqen dhe sigurinë kërkojnë një përgjigje globale bazuar në bashkëpunim dhe në një sistem shumëpalësh efikas.

Lidhur me sistemin ekonomik dhe financiar të shteteve të ish-Republikës Federative të Jugosllavisë mund të flitet për një zhvillim të diferencuar të udhëhequr nga politikat kombëtare specifike. Kroacia ka tërhequr investime të huaja masive në të gjithë sektorët e ekonomisë. Pavarësisht përmasave të tij gjeografike, në Mal të Zi, si pasojë e përshtatjes së shpejtë me Euron, si monedhë kombëtare dhe reformave të fuqishme të filluara pas shkëputjes nga Serbia, tregu i brendshëm është zgjeruar dhe shtuar. Për Serbinë dhe Bosnjë Hercegovinën, pengesat politike kanë ngadalësuar avancimin e reformave dhe në rastin e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (FYROM),

përmasat e vogla të tregut kanë theksuar se potenciali i ofruar është shumë i vogël.

Për shkak të pengesave kushtetuese, Bosnjë-Hercegovina (BIH) ka kuadro institucionale dhe ligjorë komplekse. Ekonomia dhe infrastruktura vendit u “shtypën” virtualisht nga konfliktet e armatosura të viteve ‘90 dhe kjo reflektohet në “panoramën” e tregut të brendshëm. Ka pasur dëme të mëdha në nivel kombëtar por pas një periudhe të vështirë si pasojë e rigjenerimit të humbjeve, Bosnjë-Hercegovina vazhdon të jetë në një periudhë tranzicioni. Trendet e rritjes së indikatorëve ekonomikë po ndihen nga popullsia vetëm gjatë viteve të fundit. Brenda vendit, praktikat e tregtisë dhe çmimet e paarsyeshme të dumping-ut mund të çojnë drejt kolapsit të sistemit.

Dëshira për t’u bërë pjesë e Bashkimit Evropian, është përkthyer në një progres më të madh për Kroacinë krahasuar me shtetet e tjera ish-Jugosllave. Legjislacioni është përshtatur sipas direktivave të BE-së (pra kur të jetë pjesë e Komunitetit Evropian, kompanitë e sigurimeve kroate do të shesin produktet e tyre të sigurimeve në vendet e BE-së, si edhe kompanitë e sigurimeve të BE-së, do të kenë mundësi të veprojnë në Kroaci). Nga perspektiva ekonomike, turizmi është dega kryesore e ekonomisë në Kroaci. Numri i turistëve është 10 milionë në vit dhe turizmi përbën një të pestën e PBB-së, së vendit. Sipas disa analistëve, ekonomia është shumë e bazuar tek turizmi çka e bën atë vulnerabil kundrejt zhvillimit ekonomik global dhe për politikat ndërkombëtare. Megjithatë, pavarësisht krizës turizmi ka një rënie më pak të dukshme se sa sektorët e tjerë të ekonomisë kroate. Për vitin 2011, autoritetet vendore kërkojnë të mbajnë nivelin e papunësisë të regjistruar në fund të vitit 2010 dhe po ashtu për sa u përket të ardhurave të përbashkëta.

Kosova është një republikë ish-Jugosllave me status special. Duke filluar nga tetori i vitit 2010, 71 vende anëtarë të OKB-së, 22 vende anëtarë të BE-së dhe 24 nga 28 anëtarët e NATO-s, njohin pavarësinë e saj. Rumania nuk ka njohur pavarësinë e Kosovës, sepse ajo nuk mbështet separatizmin e njëanshëm, i cili është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Kosova u bë anëtare e FMN-së, dhe e Bankës Botërore nën emërtimin Republika e Kosovës. Tregu i brendshëm i saj është ende shumë i ri.

FYROM ka qenë e destabilizuar nga lufta në Kosovë në vitin 1999 kur rreth 360. 000 shqiptarë të Kosovës u strehuan në territorin e saj. Lidhur me tregun e brendshëm, një kuadër ligjor i përgjithshëm është përgatitur sipas direktivave të BE-së. Gjatë viteve të fundit ekonomia ka regjistruar një tendencë të dukshme rritjeje.

Një degë e rëndësishme e ekonomisë malazeze është turizmi. Ky sektor është pjesë e një projekti të qartë afatgjatë të zhvillimit. Investimet e ndërmarra gjatë viteve të fundit kanë rezultuar në arritjen e një prej dinamikave më të mëdha në botë. Së fundmi, Mali i Zi është nën një proces të vazhdueshëm liberalizimi, privatizimi dhe ristrukturimi të sektorëve ekonomikë. Qëllimi kryesor është aderimi në BE dhe NATO. Maturiteti në politikat ekonomike është vendosur nga malazezët që prej vitit 2002 duke adoptuar Euron, si monedhën e tyre kombëtare. Megjithatë, qeveria e Malit të Zi ka zhvilluar një program të qartë zhvillimi, i cili përqendrohet në dy drejtime, njëri që çon drejt rritjes në sektorin e turizmit dhe tjetri për privatizimin dhe tërheqjen e investitorëve të huaj. Synimi final është zhvillimi i infrastrukturës dhe krijimi i vendeve të reja të punës. Ndikimet negative në kuadrin institucional dhe ligjor janë të dukshme dhe janë sipas Direktivave të BE-së.

Lidhur me kuadrin rregullator, tregu i brendshëm në Serbi, ka kaluar përmes ndryshimesh të mëdha gjatë vitit 2004, kur ligjet u përshtatën sipas Direktivave të BE-së. Si rrjedhojë, u vendosën standarde të reja për aftësinë e pagesve dhe Banka Kombëtare u emërua si mbikëqyrëse. Për mbrojtjen dhe sigurimin e investitorëve dhe në vijim të zbatimit të këtyre ligjeve, Banka Kombëtare hoqi licencat e disa kompanive që nuk përmbushnin kriteret e përcaktuara. Kjo ka rezultuar në rritje të transparencës ndërmjet tregjeve. Për të krijuar një treg të balancuar dhe konkurrues si segmenti bazë i sistemit financiar nevojiten disa veprime. Ndërmjet këtyre duhet përmendur: fokusimi tek lojtarët nga fusha të ndryshme të qeverisjes së korporatave, përmirësimi i procedurave për menaxhimin e rrezikut dhe teknikave për vlerësimin e investimeve dhe rritja e transparencës në marrëdhëniet me konsumatorin.

Lidhur me negociatat e Kroacisë për hyrjen në BE¹, vendi ka arritur fazën finale duke iu treguar të gjithë vendeve të përfshira në proces se, bindja mund të shndërrohet në realitet. Serbia ka dorëzuar aplikimin e saj për anëtarësim. Raportet mbi aplikimet për anëtarësim të Malit të Zi dhe Shqipërisë u publikuan gjatë fundit të vitit 2010. Liberalizimi i vizave për vendet e Ballkanit Perëndimor, ka shënuar progres të dukshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve afatgjata ndërmjet Sllovenisë dhe Kroacisë, si edhe një dialog ndërmjet Serbisë dhe Kosovës², po përgatitet të fillojë. Megjithatë, shumë sfida vazhdojnë të mbeten, për shkak të krizës financiare globale, hapi i reformave është ulur.

1. Konkluzionet e Këshillit Evropian, 14-15 dhjetor 2010.

2. Sipas rezolutës 1244/99 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Integrimi Euro-Atlantik kërkohet për përshpejtimin e reformave dhe për përfshirjen e të gjithë aktorëve për një qeverisje më të mirë. Duhet të insistohet në forcimin e shtetit ligjor, përshpejtimin e reformave ekonomike dhe përmirësimin e kapacitetit për të miratuar dhe zbatuar *acquis communautaire*. Disa çështje që pengojnë bashkëpunimin rajonal mbeten të hapura dhe bashkëpunimi rajonal pengohet nga mosmarrëveshjet rreth statusit të Kosovës. Zgjerimi shërben për interesat e BE-së, dhe të vendeve që duan të jenë pjesë e tij. Zgjerimi i BE-së³, kontribuon jo vetëm për stabilitetin e Evropës por edhe për sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve të saj. Vendet e përfshira në procesin e zgjerimit mundohen të arrijnë standardet evropiane në të gjithë fushat e traktateve të BE-së. Kjo do të mbështeste BE-në, në arritjen e objektivave të saj. Aktualisht, një nga objektivat më të rëndësishëm është gjetja e një zgjidhjeje për krizën ekonomike, rivendosja e rritjes ekonomike dhe krijimi i vendeve të punës nëpërmjet strategjisë së reformave 2020 dhe forcimi i sigurisë në BE.

Programi i Komisionit Evropian për vitin 2011, synon intensifikimin e dialogut ekonomik me vendet e përfshira në procesin e zgjerimit, që do të lejonte përpjekjet e përqendruara për të anashkaluar krizën dhe për të krijuar vende të reja pune. Kjo tregohet nga eksperiencia e kaluar. Gjatë viteve 1998-2008, tregtia ndërmjet vendeve të reja dhe të vjetra anëtare është trefishuar nga 150 në 450 miliardë Euro. Procesi i zgjerimit të BE-së, ka mundësuar burimet financiare për të ndërhyrë, krahas institucioneve financiare ndërkombëtare, për ruajtjen e stabilitetit ekonomik në kohë krize.

Në Kroaci, ardhja në fuqi e Ivo Josiphovic-it në fillim të vitit 2010, ndryshoi pozicionin e vendit kundrejt Serbisë. Dy vendet kanë arritur në konkluzionin se problemi i riatdhesimit të refugjatëve nga Kroacia, mosmarrëveshja për kufirin ndërmjet Serbisë dhe Kroacisë, çështjet e personave të humbur, minoriteteve dhe të drejtave të tyre mund të zgjidhen vetëm me anë mjetesh diplomatike. Edhe nëse ata përpiqen të zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë dy vendet mendojnë se, zgjidhjet jo gjyqësore janë më konvenientet. Hyrja e Kroacisë në BE në vitin 2012, mund të përdoret nga Serbia dhe Kroacia mund të shndërrohet nga rival në mbështetës të hyrjes së Serbisë në BE.

3. Speech by the Commissioner for Enlargement and European Neighbourhood Policy, Stefan Füle, the presentation package to expand the foreign affairs Commission of the European Parliament, Bruksel, 9 nëntor 2010 (SPEECH/10/638).

Evropianizimi i Kroacisë është në interes të të gjithë vendeve të Ballkanit. Ky shpirt mbështetjeje reciproke në procesin e anëtarësimit në BE, është politika e re rajonale.

Në 19 janar 2011, Parlamenti Evropian aprovoi Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA) me Serbinë. Kjo shënon tregtinë e lirë ndërmjet BE-së dhe Beogradit. Për t'u bërë efektive marrëveshja duhet ratifikuar nga secili vend anëtar i BE-së. Si kusht për hyrjen në BE, marrëveshja thekson nevojën që autoritetet serbe të bashkëpunojnë me Gjykatën Ndërkombëtare për krimet në ish-Jugosllavi, në Hagë. Beogradi ka firmosur fillimin e procesit të Asocimit me BE-në në prill 2008, dhe deri tani vetëm 11 vende anëtare kanë filluar procesin e ratifikimit të MSA-së, që prej vitit 2010.

Përfaqësuesit Evropianë gjithashtu kanë kërkuar që Beogradi të fillojë dialogun me Kosovën nën mbikëqyrjen e BE-së, për shkak të vullnetit dhe këmbënguljes për arritjen e një stabiliteti në rritje në rajon. Parlamenti Evropian (PE), nxit Beogradin për shkatërrimin e strukturave paralele në provincën serbe të Kosovës, të cilat janë “pengesë për procesin e decentralizimit” si dhe “pengojnë integrimin e plotë të serbëve etnikë”, në institucionet e Kosovës. Lidhur me liberalizimin e vizave për qytetarët serbë, Parlamenti Evropian sugjeroi se, autoritetet e Beogradit duhet të ndërmarrin masat e duhura për të kufizuar shkeljet e ligjit lidhur me dokumentet e identitetit.

Pra serbët duhet të informohen se, pas vendosjes së regjimit të udhëtimit pa viza, ata do të kenë jo vetëm të drejta por edhe detyrime. Sipas raporteve, Serbia është vendi me numrin më të madh të refugjatëve dhe të personave të zhvendosur në Evropë. Parlamenti Evropian miratoi një rezolutë për integrimin evropian të Serbisë, dhe kërkoi miratimin e masave ligjore për të luftuar diskriminimin. Masat e reja do të sigurojnë trajtim të barabartë për të gjithë qytetarët e Serbisë, pavarësisht etnisë së tyre. Në këtë kontekst, objektivi kryesor për Serbinë në vitin 2011, është që ajo të marrë statusin kandidat për anëtarësimin në BE, duke theksuar se ata shpresojnë që negociimet të fillojnë në pranverë të vitit 2012.

Në fund të shkurtit 2011, në Bruksel u zhvilluan punimet e Komitetit të Punëve të Jashtme (KPJ, FAC). Një çështje e rëndësishme për agjendën e këtij komiteti ishte situata në Bosnjë Hercegovinë. Objektivi i diskutimeve ishte formulimi i drejtimeve të reja strategjike për BE-në, për të siguruar zbatimin e tranzicionit nga faza e post-Dejtonit në fazën përgatitore për fillimin e negociatave. Elementët kryesorë mbi të cilat u fokusuan diskutimet ishin identifikimi i perspektivave për përfundimin e mandatit të Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë (ZPL, OHR) dhe për

miratimin e një sërë masash shtrënguese (regjimi i lëvizjes dhe i pasurisë personale), që mund t'ju aplikohen individëve në BIH, të cilët do të pengonin zbatimin e Marrëveshjes së Dejtonit.

Ministri i Jashtëm rumun mbështeti koordinimin efektiv të Këshillit të BE-së, për Zbatimin e Paqes (KZP, PIC) për të krijuar një qasje të përbashkët sipas së, cilës bashkimi i mandatit të Përfaqësuesit Special të BE-së, dhe të Përfaqësuesit të Lartë është një faqe paraprake në një proces i cili përfundon me mbylljen e Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë (ZPL). Gjithashtu, e ardhmja e strategjisë së BE-së për BIH, duhet të përfshijë një gamë më të gjerë çështjesh ekonomike, integrimin politik dhe ligjor, të adresuara në një mënyrë të integruar, duke lejuar këtë vend që të arrijë fazën ku ai ftohet të nisë negociatat me BE-në, në një kohë sa më të shkurtër.

Vendet me një integrim më të madh financiar dhe ekonomik filluan të vuanin infektimin nga rreziqet globale dhe nga mungesa e likuiditetit të parave si rrjedhojë e ngadalësimit ekonomik në nivel BE-je. Në çerekun e fundit të vitit 2009, kriza globale ka prekur dhe Ballkanin Perëndimor në fushat financiare dhe ato ekonomike, kryesisht për shkak të reduktimit të kërkesës së brendshme, uljes së investimeve të huaja direkt dhe të prurjes së kapitaleve si dhe prej një rritjeje ekonomike më të ulët. Pa anashkaluar perspektivat për një rimëkëmbje të lehtë në vitin 2010 dhe 2011, efektet e krizës janë të dukshme në periudhë afatgjatë dhe do të jenë të dukshme dhe në të ardhmen e afërt. Aksesit tek kapitali i huaj dhe investimi i huaj direkt në rajon mund të mbetet i kufizuar për njëfarë kohe. Edhe pse investimet e huaja direkt mund të rifillojnë pas tejkalimit të krizës prurjet ndërkombëtare të remitancave mund të ulen ndërkohë, kapitali i huaj ka pak gjasa që të jetë i disponuar dhe kjo do të sjellë rata shkëmbimi më të larta. Kjo do të kërkonte një rregullim të pabarazive të brendshme mbështetur nga një politikë më e kujdesshme dhe më e përzier.

Kalimi i kohës ka nxjerrë në pah se, sidomos në vendet ish-komuniste tranzicioni drejt ekonomisë së tregut ka penguar për një kohë të gjatë një përshtatje të shpejtë me standardet e BE-së, edhe pse qëllimi i përbashkët ka qenë integrimi në Bashkimin Evropian. Për secilin prej vendeve të ish-Republikës Federative të Jugosllavisë sfidat kryesore kanë variuar nga krijimi i rregulloreve të reja ligjore tek rezultatet e ndryshme që ka dhënë forcimi i tregjeve konkurruese të cilat kanë zënë vendin e monopoleve të mëparshëm. Për shkak të konflikteve politike dhe të armatosura kriza ka prekur ekonominë gjatë procesit të reformimit si edhe tregun e brendshëm.

Kriza e ekonomike ka prekur të gjitha vendet e përfshira në procesin e zgjerimit, ndërsa ndikimi i saj ka qenë i ndryshëm në varësi të strukturës ekonomike të vendit. Shqipëria, Kosova dhe Republika ish-Jugosllave e Maqedonisë, u prekën më pak prej krizës sepse ekonomitë e tyre kishin varësi më të vogël kundrejt eksporteve dhe tregjet e brendshme u përballën me sukses me krizat e tyre. Kroacia, Serbia dhe Turqia ekonomitë e të cilave ishin më të integruara në tregun botëror u prekën më ashpër nga kriza. Për shkak të varësisë nga financimet e jashtme dhe me një numër të vogël sektorësh aktivë, Mali i Zi ka marrë një përplasje të fortë. Në Bosnjë-Hercegovinë, ndikimi u balancua nga politikat fiskale pro ciklike dhe nga një buxhet që parashikonte përqindje të lartë subvencionesh dhe transfertash sociale.

Gjatë vitit 2010, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë dhënë shenja të dobëta rimëkëmbjeje. Aktualisht, kërkesa e brendshme mbetet e ulët duke reflektuar vështirësimin e kushteve për kreditdhënie dhe papunësinë e vazhdueshme. BE-ja, së bashku me institucionet ndërkombëtare financiare ka ofruar mbështetje për tejkalimin e ndikimit të krizës. Arritja e niveleve të qëndrueshme dhe një rimëkëmbje reale do të kërkonin reforma strukturore të mëtejshme dhe politika fiskale të kujdesshme. Burimet e brendshme të rritjes duhen shfrytëzuar në mënyrë më efikase, për përmirësimin e kapaciteteve të prodhimit dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Përshpejtimi i reformave strukturore në tregun e punës dhe atë të produkteve dhe përmirësimi i cilësisë së shpenzimeve publike do të rriste kapacitetin e ekonomive të Ballkanit Perëndimor për të konkurruar me tregje të tjera në zhvillim dhe për tërheqjen e investimeve të huaja gjatë fazës së rimëkëmbjes çka mbetet një faktor kryesor për rritjen ekonomike të rajonit. Në këtë kuadër, duke konsideruar mbivendosjen e krizës ekonomike me vështirësitë politike që janë evidentuar gjatë procesit të bashkëpunimit rajonal në lidhje me pavarësinë e Kosovës nga disa vende të rajonit, Komisioni Evropian theksoi nevojën që Ballkani Perëndimor, të mbetet i përfshirë në bashkëpunimin rajonal.

Bashkëpunimi ndërkufitar rajonal

Zhvillimi i bashkëpunimit rajonal është në interesin e të gjithë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ky është një faktor kryesor, për vendosjen e një klime politike të qëndrueshme, sigurisë dhe

prosperitetit ekonomik. Bashkëpunimi rajonal është gjithashtu një kriter i nevojshëm për Marrëveshjet e Stabilizim Asocimit, të cilat janë në zhvillim e sipër në rajon. Në këtë këndvështrim, bashkëpunimi rajonal qëndron në themel të politikave të BE-së, në Ballkanin Perëndimor (Procesit të Stabilizim Asocimit që iu mundëson vendeve të rajonit të drejtën për anëtarësim në BE). Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë kuptuar se, kanë përgjegjësi kundrejt njëri-tjetrit dhe se ndajnë një sërë sfidash, disa prej të cilave lidhen me bashkëpunimin ndërkuftar. Ata e shohin tashmë përfitimin e konsiderueshëm të bashkëpunimit rajonal në terma të mirëkuptimit politik dhe prosperitetit ekonomik e social.

Kjo qasje për zgjidhjen e disa çështjeve nëpërmjet bashkëpunimit reflektohet qartësisht në progresin konkret të arritur në terren. Është shumë inkurajuese që fusha si tregtia, energjia dhe transporti janë ndërmjet atyre ku bashkëpunimi rajonal është më i dukshëm. Zhvillimi ekonomik në rajon është gjithashtu thelbësor për gjenerimin e vendeve të nevojshme të punës. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të rritur besimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njerëzve dhe vendeve. Në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme vendet duhet të shtojnë përpjekjet për rritjen e bashkëpunimit rajonal dhe për arritjen e rezultateve. Zgjerimi i bashkëpunimit rajonal në Evropën Juglindore, është faktor kryesor pavarësisht stadeve të ndryshëm të integritit Euro-Atlantik të secilit vend. Gjithashtu ai përbën një kriter të rëndësishëm për rrugën evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Stabiliteti, prosperiteti dhe siguria në rajon kanë një interes të madh për BE-në. Bashkimi Evropian do të vazhdojë të inkurajojë gjithë përpjekjet për nxitjen e bashkëpunimit rajonal.

Shumë prej sfidave me të cilat përballen vendet e Ballkanit Perëndimor, janë jo vetëm të zakonshme por kanë dimension rajonal dhe përfshijnë fqinjët e rajonit. Që nga zgjerimi i 1 majit 2004, BE-ja dhe Ballkani Perëndimor janë afruar me njëri-tjetrin ndërkohë që situata në vendet e Ballkanit Perëndimor, progresi i tyre drejt integritit Evropian dhe marrëdhëniet e ardhshme me BE-në, përbëjnë pa dyshim interes imediat për unionin. Që kur Bullgaria dhe Rumania u anëtarësuan në BE, i gjithë rajoni kufizohet nga vende anëtare të unionit. Kjo ka pasoja të rëndësishme si për vendet e rajonit ashtu edhe për BE-në, në një sërë fushash ku më kryesoret janë lëvizja e lirë e mallrave, shërbimeve dhe njerëzve. Këto sfida duhen adresuar në kontekstin e gjerë të gjithë rajonit të Evropës Juglindore. Arsyet politike, ekonomike dhe të sigurisë, për të cilat bashkëpunimi rajonal në Ballkanin Perëndimor është kryesor janë të lidhura

ngushtë me njëra-tjetrën. Kështu stabiliteti rajonal dhe siguria janë të domosdoshëm për zhvillimin ekonomik dhe kjo nga ana e saj promovon stabilitetin dhe sigurinë në rajon.

Bashkëpunimi rajonal luan rolin kryesor gjatë adresimit të sfidave të sigurisë sepse problemet më urgjente, si krimi i organizuar ose menaxhimi i integruar i vijave kufitare dhe emigrimi i paligjshëm, mund të zgjidhen në mënyrë efektive me anë të një qasjeje ndërkufitare. Bashkëpunimi rajonal mund të çojë drejt rezultateve të prekshme në siguri dhe drejtësi, për lirinë e njerëzve që jetojnë në rajon. Përpjekjet për adresimin e faktorëve që mund të shqetësojnë stabilitetin dhe zhvillimin rajonal si edhe kërcënimet e sigurisë së BE-së, do të jenë të suksesshme, nëse vendet e Ballkanit Perëndimor dhe BE-ja, do të bashkëpunojnë për luftën ndaj këtyre rreziqeve të cilat pengojnë rritjen e ligjshme ekonomike, shtetin e së drejtës, demokracinë dhe stabilitetin e rajonit.

Lufta ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit është prioritet kryesor për qeveritë e rajonit. Theks i veçantë vendoset tek lufta kundër të gjitha formave të trafikimit (sidomos atij të qenieve njerëzore, drogës dhe armëve dhe kontrabandës së mallrave). Forcimi i bashkëpunimit operacional të policive dhe prokurorive të rajonit është thelbësor. Bashkëpunimi rajonal kontribuon për pajtimin, ruajtjen e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, dhe pasjen e klimës së duhur për marrëdhënie bilaterale të shkëlqyera.

Përgjatë rrugës së tyre evropiane dhe me mbështetjen e BE-së, vendet e rajonit pavarësisht ndryshimeve aktuale të statusit të tyre lidhur me integrimin evropian, vazhdojnë të zhvillohen. Bashkëpunimi rajonal është kryesor për progresin drejt anëtarësimit. Projektet e Komisionit mbështesin pjesëmarrjen e Kosovës, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Shqipërisë në programin IPA, CBC. Gjatë vitit 2011, do të përfshihen gjithashtu edhe projekte me Malin e Zi.

Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkufitar në Ballkanin Perëndimor përbën një nga fushat kryesore të ndërhyrjes së institucioneve ndërkombëtare shumëpalëshe si Bashkimi Evropian, Banka Botërore, PNUD-i dhe BERZH-i. Për të treguar këtë fakt dhe për të forcuar bashkëpunimin me vendet që kufizojnë Bashkimin Evropian, Instrumenti Evropian i Partneritetit dhe Fqinjësisë (IEPF, ENPI) përfshin një komponent të veçantë për bashkëpunimin ndërkufitar. Ekzistojnë 15 projekte bashkëpunimi ndërkufitar (9 për kufijtë tokësorë, tre për ata detarë dhe tre për basenet detare). Ata janë vendosur përgjatë kufijve jugorë dhe lindorë të Bashkimit Evropian dhe kanë një financim total prej 1.2 miliardë Eurosh për

periudhën 2007-2013. Rajonet e bashkëpunimit ndërkufitar shtrihen në të dy anët e kufijve të BE-së, dhe kanë një popullsi totale prej afro 257.5 milionësh nga të cilët 45% jetojnë në kufijtë veriorë dhe lindorë dhe 55% në kufijtë jugorë (49% e këtyre jetojnë në rajonet kufitare të BE-së, dhe 51% në rajonet kufitare të vendeve partnere).

Lloji i fondeve që shpërndahen nga programi CBC, thekson objektivat afatgjata dhe qëndrueshmërinë. Kjo përfshirje shumëpalëshe dhe vullneti i komunitetit ndërkombëtar përbëjnë një faktor kryesor për arritjen e progresit rajonal dhe ndërkufitar në Ballkanin Perëndimor. Po arrihet një progres gradual edhe pse këto iniciativa janë ende në një nivel relativisht të ulët, duhen konsideruar gjithashtu luftërat dhe tensionet etnike të viteve 1990.

Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (KBR, RCC) i themeluar në vitin 2008, dhe bazuar në Sarajevë, është shenja më e dukshme e një kapaciteti institucional të ri për të avancuar pronësinë rajonale dhe vendore të procesit politik. Ekziston shpresa se një bashkëpunim i tillë rajonal në Ballkan mund të ndërmerret edhe nga ata që pritet të përfitojnë prej tij. KBR-ja, promovon bashkëpunimin e ndërsjellët dhe integrimin Evropian dhe Euro-Atlantik të Evropës Juglindore. Ai fokusohet në gjashtë fusha prioriteti: zhvillimi ekonomik dhe social, energjia, drejtësia, infrastruktura dhe çështjet e brendshme, bashkëpunimi në fushën e sigurisë, ndërtimi i kapaciteteve njerëzore dhe bashkëpunimi parlamentar. Në terma operationale, Kryetarët e Shteteve dhe Qeverive të vendeve të Evropës Juglindore në kuadër të procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (PBEJL, CPSEE) (ku përfshihen Greqia, Turqia, Ballkani Lindor dhe ai Perëndimor dhe zona e Detit të Zi) sigurojnë mbështetjen politike për punën vjetore të KBR-së, ndërsa Komisioni Evropian ofron shumicën e financimit. Objektivi kryesor është gjenerimi dhe koordinimi i projekteve të zhvillimit të një natyre të gjerë rajonale që sjellin të mira për secilin anëtar.

Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkufitar në kontekstin e BE-së, përdor një qasje të modeluar gjerësisht mbi principin e fondeve strukturore, ku përfshihen projektet shumëvjeçarë, partneriteti dhe bashkëfinancimi, të hartuar për të konsideruar rregullat dhe rregulloret specifike të jashtme të Komisionit Evropian. Një risi kryesore e IEF, CBC-së. mund të shihet tek fakti se projektet që përfshijnë rajonet në të dy krahët e kufirit të BE-së, kanë buxhet të vetëm, struktura menaxhimi të përbashkëta dhe kuadër ligjor dhe rregulla të përbashkëta zbatimi duke kontribuar kështu në balancimin e partneritetit ndërmjet vendeve pjesëmarrëse.

Mln. Euro	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Kroacia	9.7	14.7	15.9	15.6	15.8	16.1	16.7
RIJM	4.1	4.0	4.3	5.0	5.1	5.2	5.2
Turqia	2.1	2.8	3.4	9.5	9.7	9.9	10.1
Shqipëria	6.6	8.5	9.8	9.9	10.1	10.2	10.6
Bosnjë Hercegovina	3.9	4.5	4.6	4.2	4.3	4.3	4.4
Mali i Zi	3.9	4.5	4.6	4.2	4.3	4.3	4.4
Serbia	8.2	11.4	12.2	11.7	11.9	12.1	11.6
Kosova	0	0	0	2.8	2.8	2.9	2.9

Tabela 1: Asistenca e CBC-së, ofruar nga BE-ja në kuadër të projekteve të IPA-s, 2007-2013.

Burimi: Com (2009), 543

Komisioni Evropian gjithashtu promovon bashkëpunimin ndërkufitar dhe zhvillimet bilaterale në Ballkanin Perëndimor me anë të Instrumentit Përpara Aderimin (IPA), një instrument ndihme financiare. Ky instrument ka qenë funksional që prej vitit 2008, dhe aktualisht vepron për të gjithë vendet e Evropës Juglindore, që duan anëtarësimin në BE. Programet vjetore zbatohen në bashkëpunim me komunitetin ndërkombëtar të donatorëve dhe bashkë-menaxhohen me përfaqësuesit vendorë të vendeve përfituese.

Për të treguar veprimin e IPA-s, konsiderohet Programi Vjetor 2009-2010, për bashkëpunimin me Malin e Zi. Nën titullin e dytë të prioritetëve, të ashtuquajturin kriteri ekonomik, Delegacioni i BE-së, në Podgoricë ka dhënë një garant prej pesë milionë eurosh për rehabilitimin e linjës hekurudhore Bar-Vrbnica, që të çon në kufi me Serbinë. Përfitues të këtij projekti janë Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacioneve dhe kompanitë hekurudhore të vendeve të përfshira. Meqenëse një investim i tillë për infrastrukturën e transportit kërkon burime financiare të konsiderueshëm të cilët nuk zotërohen prej vendeve përfituese, projekti bashkë-financohet me hua shtesë nga Banka Evropiane e Investimeve dhe BERZH-i, të cilat arrijnë në total në 10 milionë Euro.

Cikli i Komisionit për projektet e IPA-s, 2009-2010 i referohet programeve të përbashkëta të bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet Malit të Zi, Shqipërisë dhe Kosovës në rajonin e Kukësit. Rehabilitimi dhe përmirësimi i infrastrukturës për kalimin e kufirit në Morin në rajonin e Kukësit (që ndodhet në kufi ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës) ka një buxhet total prej 0.46 milionësh gjatë periudhës 2009-2010. Krahasuar me shembullin e mëparshëm, shumat janë të vogla, kryesisht sepse shumë rregullore zbatimi nuk ekzistojnë në Kosovë. Aktualisht,

meqenëse programi CBC i BE-së, përfshin edhe bashkëpunimin me Kosovën preket nga kufizimet e procesit në vazhdim të njohjes ndërkombëtare të kësaj të fundit. Këto kufizime sugjerojnë se, pabarazitë rajonale mund të forcohen pavarësisht se bashkëpunimi ndërkufitar kërkon t'i ulë ato.

Një tjetër shembull që thekson rëndësinë dhe sfidat e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkufitar janë të drejtat e minoriteteve në Ballkanin Perëndimor. Shumë vende në rajon vazhdojnë të kenë refugjatë dhe persona të shpërngulur që prej konflikteve të viteve 1990-të. Në Malin e Zi, për shembull, autoritetet e Podgoricës duhet që ende të zgjidhin statusin e rreth 16.200 refugjatëve nga Kosova. Bashkëpunimi ndërkufitar i Malit të Zi dhe Kosovës, një fushë kjo delikate, duhet të adresojë çështje të tilla si:

- Statusi i ligjshëm i refugjatëve dhe të shpërngulurve (për shembull lidhur me aksesin tek punësimi i të huajve)
- Ndërtimin e rezidencave për refugjatët Romë nga Kosova
- Krijimin e kushteve ligjore për integrimin e refugjatëve dhe të shpërngulurve, që duan të qëndrojnë në Malin e Zi dhe të marrin shtetësinë me anë të natyralizimit.
- Aftësinë për të përthithur dhe riintegruar refugjatët. Mundësimin e strehimit, pjesëmarrjes në tregun e punës dhe me infrastrukturën e nevojshme për arsim.

Ndërsa Mali i Zi dhe Kosova, përpiqen bashkërisht për zgjidhjen e disa prej këtyre sfidave, mbeten ende çështje të pazgjidhura me vendet fqinje. Serbia mund të blloktojë iniciativa të tilla bilaterale.

Bashkëpunimi për mbrojtjen dhe trajnimi i përbashkët i policive kufitare janë gjithashtu shumë të rëndësishëm. Ato zhvillohen ndërmjet vendesh që përpara një dekade ishin në luftë. Negociatat mbi marrëveshjet për sigurinë sociale ndërmjet vendeve të ndryshme të Ballkanit Perëndimor vijnë.

Sfida më e madhe për bashkëpunimin ndërkufitar në Ballkanin Perëndimor, lidhet me marrëveshjet institucionale dhe politike ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. Serbia refuzon të njohë Kosovën si shtet sovran dhe i pavarur dhe nuk njeht legjitimitetin e kufijve të saj. Ndërkohë kjo e fundit, po përpiket të bindë popullsinë e saj etnike shqiptare për bashkëpunimin ndërkufitar, i cili mund të jetë në interesin e vetë kësaj të fundit lidhur me avancimin e njohjes ndërkombëtare.

Bashkëpunimi ndërkufitar gjithashtu kërkon arritjen e progresit ekonomik në tregti dhe investime publike e private nga BE-ja, BERZH-i dhe Banka Botërore. Megjithatë, iniciativat e biznesit janë ato që nxitin më së pari këtë lloj bashkëpunimi rajonal.

Kapacitetet politike dhe zbatuese mbështeten nga politikat specifike të Bashkimit Evropian, Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare.

Prospekte për integrimin Euro-Atlantik

Rajoni i Ballkanit Perëndimor, po kufizohet me vendet anëtare të BE-së. Ndërtimi i korridoreve trans-Evropiane të transportit, diversifikimi i burimeve të energjisë, negociimet dhe përshtatjet mbi ndryshimet klimatike, ulja e ndotjes së ajrit dhe ujërave ndërkufitarë janë disa nga objektivat e BE-së, që duhen arritur, plotësimi i të cilave kushtëzohet nga vullneti i plotë i vendeve të përfshira në procesin e aderimit. Rrjedhimisht, ato gjenerojnë përfitime nga progresi në fushat e mësipërme; prospekti për aderim inkurajon ato që t'i japin prioritet objektivave që ndajnë BE-në. Garantët e dhëna nëpërmjet Instrumentit për Para Aderim (IPA) dhe kreditë nga Banka Evropiane e Investimeve, dhe nga institucione të tjera financiare ndërkombëtare mundësojnë mbështetjen praktike.

Eksperienca e liberalizimit të vizave për Ballkanin Perëndimor, tregon sa shumë mund të arrihet duke kombinuar vendosjen e kritereve strikte me ofrimin e përfitimeve që lidhen me progresin drejt anëtarësimit në BE. Procesi i anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe ndikimi i BE-së, rrisin aftësinë tërheqëse të saj në Zonën e Mesdheut dhe Detit të Zi, si edhe në basenin e lumit Danub. Institucionet e BE-së, dhe vendet anëtare duhet të bashkëpunojnë për të forcuar të kuptuarit dhe mbështetjen për procesin e zgjerimit si dhe për të shpjeguar se, si kjo politikë mund të kontribuojë për përmbushjen e objektivave të përbashkëta. Lidhur me tregun unik të BE-së, Komisioni do të kërkojë heqjen e një sërë bllokimesh të vazhdueshme dhe të gjenerojë një potencial të ri për rritje. Nëpërmjet zgjerimit vendet e përfshira në proces do të adoptojnë gradualisht *acquis communautaire*, duke zgjeruar kështu hapësirën ku ata aplikojnë një sërë standardesh të njëtrajtshëm. Kjo duhet të nxitë investime të reja, inovacion dhe kohezion social si edhe duhet të rritë tërheqjen e modelit rregullator të BE-së, ndërmjet vendeve fqinje si dhe në arenën ndërkombëtare.

Zgjerimi i NATO-s, ka kontribuar dukshëm për sigurinë e Aleatëve, (perspektiva e zgjerimit të ardhshëm dhe shpirti bashkëpunues në fushën e sigurisë ofroi një përkufizim më të gjerë të stabilitetit në Evropë). Ideja e Evropës si një e vetme, e lirë dhe me prosperitet mund të arrihet vetëm duke ndarë vlerat

e përbashkëta. Asaj do t'i shërbehej më mirë përmes integritit eventual në strukturat Euro-Atlantike. Dera për në NATO, mbetet e hapur për demokracitë evropiane që ndajnë vlerat e Aleancës dhe që dëshirojnë dhe janë të afta për të marrë përsipër përgjegjësitë dhe detyrimet e anëtarësisë si edhe përfshirja e të cilave mund të kontribuojë tek vlerat e përgjithshme të sigurisë dhe stabilitetit.

Bashkëpunimi ndërmjet NATO-s dhe BE-së, në Ballkan ka mundësuar shembullin më të mirë të asaj çfarë këto dy organizata mund të bëjnë së bashku. Bashkëpunimi në vende si Bosnjë-Hercegovina dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, ka pasur një ndikim pozitiv të drejtpërdrejtë mbi stabilitetin dhe sigurinë rajonale. Eksperienca e suksesshme e bashkëpunimit NATO-BE në Ballkanin Perëndimor, ka treguar se të dy organizatat janë partnerë të domosdoshëm për forcimin e sigurisë rajonale dhe asaj Euro-Atlantike. Rumania, si vend anëtar i NATO-s dhe BE-së, mbështet reformat demokratike dhe integritin e Ballkanit Perëndimor si edhe është pjesëmarrëse në programet për përballje me sfidat globale si terrorizmi, përhapja e armëve të shkatërrimit në masë ose trafikimi i qenieve njerëzore. Ekziston një potencial i madh për bashkëpunim me materializimin e së cilit NATO-ja dhe BE-ja, mund të kenë së bashku një ndikim të rëndësishëm në sigurinë rajonale. Anëtarësimi do të bëhet pas konsolidimit të reformave të brendshme. Integriti Euro-Atlantik është veçanërisht i rëndësishëm sepse të dy organizatat mundësojnë stabilitet dhe siguri në rajon.

Komisioni Evropian do të vazhdojë të përdorë të gjithë instrumentet e tij të aderimit dhe mekanizmat e mbikëqyrjes ekonomike për të monitoruar përforcimin ekonomik dhe fiskal të vendeve të Ballkanit Perëndimor. BE-ja, ka dialog të rregullt me vendet kandidate duke i familjarizuar ato me politikën e tij të koordinimit dhe mbikëqyrjes së politikave ekonomike brenda BE-së. Një proces i ngjashëm është mundësuar dhe me vendet kandidate potenciale. Dialogët ekonomikë ndërmjet Komisionit dhe vendeve të përfshira në procesin e anëtarësimin, në kuadër të kohezionit përdoren për mbikëqyrjen e politikave ekonomike. Përveç dialogut dhe mbikëqyrjes BE-ja, mbështet fuqimisht përpjekjet për rimëkëmbje ekonomike, stabilitet makroekonomik dhe konsolidim të vendeve të përfshira në procesin e anëtarësimin. Zgjerimi kontribuon në përmbushjen e Strategjisë Evropë 2020, duke zgjeruar zonën ku vepron kuadri rregullator i BE-së, dhe duke krijuar mundësi të reja për tregti.

Në fillim të procesit të integritit, një sërë konfliktesh politike dhe të armatosura të fillim të viteve '90 kanë qenë nga faktorët

kryesorë, që kanë krijuar një bllokadë ekonomike të zgjatur për Serbinë dhe kanë sjellë mospranimin e këtij vendi në BE. Aktualisht pozicioni i Serbisë kundrejt Kosovës, është pengesa kryesore në këtë drejtim. Gjatë dekadës së fundit vendet e Ballkanit Perëndimor, kanë bërë progres të dukshëm për stabilitetin dhe bashkëpunimin rajonal.

Megjithatë, një sërë problemesh, të cilat kanë ardhur si pasojë e konflikteve në rajon mbeten ende të pazgjidhura dhe ndikojnë si në punët e brendshme të shteteve ashtu dhe në marrëdhëniet ndërmjet tyre. Objektivi afatgjatë i SHBA-së, për Bosnjë-Hercegovinën është që vendi të ketë stabilitet dhe prosperitet, një autoritet shtetëror të fortë dhe efikas dhe të jetë i orientuar drejt Bashkimit Evropian. Në perspektiva afatgjata qeveria e BIH, SHBA-ja dhe BE-ja, kanë të njëjtat pikëpamje për të ardhmen e Bosnjë-Hercegovinës dhe rajonit në tërësi.

Kroacia ka bërë progres të konsiderueshëm për përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit dhe negociatat e saj kanë arritur stadin final. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë vazhdon të përmbushë mjaftueshëm kriterin politik. Ka pasur progres të mëtjeshëm në fushat kryesore të reformës edhe pse jo me hapa të njëjtë. Përpjekje të mëtjeshme nevojiten sidomos lidhur me reformën e gjyqësorit dhe administratën publike. Në opinionin e tij, Komisioni rekomandon hapjen e negociatave për anëtarësim me Malin e Zi dhe Shqipërinë, kur ato të kenë arritur nivelin e kërkuar të bashkëpunimit me kriteret e anëtarësisë të vendosura në Kopenhagën në vitin 1993. Dy vendet duhet të përmbushin prioritetet specifike kryesore sipas opinionëve në fjalë. Kroacia ka paraqitur aplikimin e saj për anëtarësim në BE, në dhjetor 2009 dhe në tetor 2010, Këshilli ka ftuar Komisionin që të hartojë një opinion për këtë aplikim. Negociatat për zgjerim mund të përfundojnë në fillim të vitit 2011, me kusht që Zagrebi të vazhdojë përmbushjen e reformave të nisura.

Serbia vazhdon të zbatojë agjendën e reformave politike dhe të arrijë rezultate të mira në zbatimin e Marrëveshjes së Ndërmjetme. Lidhur me përmbushjen e kërkesave për MSA-në, ajo është në rrugë të mirë dhe ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për pajtimin e rajonit. Përpjekje të mëtjeshme nevojiten për reformën në gjyqësor dhe administratën publike dhe për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Serbia duhet të ketë gjithashtu një qasje më konstruktive kundrejt pjesëmarrjes së Kosovës në tregtinë dhe bashkëpunimin rajonal.

Gjithashtu duhet të rritet bashkëpunimi për mbështetjen e misionit së BE-së, për shtetin Ligjor (EULEX) në veri të Kosovës. Në vijim të opinionit të shprehur në korrik 2010, nga Gjykata

Ndërkombëtare e Drejtësisë lidhur me ligjshmërinë e deklaratës për pavarësi të Kosovës, Kosova dhe Serbia përballen me një numër pengesash të dukshme për gjetjen e një kompromisi afatgjatë. Njohja diplomatike e shtetësisë së Kosovës është pengesa bilaterale aktuale. Kjo është arsyeja përse prezenca dhe përfshirja aktive e BE-së, për gjetjen e një zgjidhjeje të pranueshme për të dy palët është thelbësore për mbajtjen e një klime të favorshme. Lehtësimi i pajtimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, është sfidë kryesore për një Bashkim Evropian heterogjen. Procesi i decentralizimit në Kosovë ka avancuar dukshëm dhe ka rritur bashkëpunimin me EULEX-in. Qeveria ka përmirësuar aftësitë e saj për zbatimin e agjendës evropiane dhe të politikës së reformave në Kosovë.

Megjithatë, ekzistojnë ende sfida të dukshme lidhur me shtetin ligjor, që përfshijnë reformimin e administratës publike dhe gjyqësorit, si edhe luftën kundër korrupsionit, krimin të organizuar dhe pastrimit të parave. Dialogu dhe pajtimi ndërmjet komuniteteve dhe mbrojtja dhe integrimi i minoriteteve në veçanti i Serbëve në Kosovë, vazhdojnë të përbëjnë probleme të dukshme në rajon. Bosnjë-Hercegovina duhet të formojë një qeveri që të shprehë vullnetin për përpjekjet e ardhshme drejt BE-së, dhe të intensifikojë hapin e reformave. Vendit i duhet që së pari të ndërmarrë masa emergjente për të përputhur kushtetutën e saj me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe duhet të përmirësojë funksionimin e institucioneve të saj.

Që prej vitit 1999, përfaqësuesit e OKB-së, janë përpjekur të arrijnë një marrëveshje ndërmjet dy vendeve fqinjë Greqisë dhe Republikës ish-Jugosllave të Maqedonisë (RIJM-së). Në 9 shkurt 2011 në zyrat qendrore të OKB-së, u zhvillua një takim me të dërguarin Mathiew Nimetz dhe me ambasadorët e të dy vendeve në OKB, për të gjetur një zgjidhje mbi emrin e RIJM-së, njohja e të cilës me emrin aktual është bllokuar nga Greqia që në vitin 1991. Në fund të marsit 2011, GJND-ja ka analizuar mosmarrëveshjen që ka vendosur në kundërshti të dy vendet. Athina akuzon Shkupin se ai ka ndalur anëtarësimin e tij në NATO.

Rreth 20.000 folës të rumanishtes, Arumunë, Vlleh dhe Megleno-Rumunë, jetojnë në këtë vend. Për shkak të politikave komuniste të asimilimit të detyrueshëm dhe integritit të minoriteteve kombëtare, aktualisht ekziston një ndarje e thellë në komunitetin Arumun. Për të dy vendet të drejtat e minoriteteve janë mjaft të rëndësishme. Në 23 shkurt 2011, u firmos një memorandum bashkëpunimi për integrimin Euro-Atlantik,

ndërmjet Ministrive të Jashtme të të dy vendeve. RIJM-ja, ka bërë përpjekje konstruktive për përmirësimin e klimës ndëretnike. Rumania do të vazhdojë të veprojë për përfundimin e zgjerimit të NATO-s dhe BE-së, me vendet e Ballkanit Perëndimor.

Përfundime

Procesi i integritimit Euro-Atlantik, po përparon me një nivel i cili është gjerësisht në varësi të kapaciteteve të vendeve kandidatë, për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësisë. Kjo kërkon reforma të qëndrueshme si edhe përshtatje ligjore dhe institucionale të besueshme dhe bindëse. Kur vendet përkatëse do të përmbushin standardet duke përfshirë ato që lidhen me demokracinë, shtetin ligjor dhe të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, BE-ja dhe NATO do të bashkëpunojnë për të ecur drejt fazave të tjera të procesit.

Rajoni i Ballkanit Perëndimor, është krijuar artificialisht për t'i shërbyer strategjisë së BE-së, dhe synimeve gjeopolitike më të gjera të aktorëve ndërkombëtarë. Bashkëpunimi rajonal është vendosur në kontekstin më të gjerë hapësinor së Evropës Juglindore. Procesi i bashkëpunimit rajonal ndikohet dukshëm nga natyra konkurruese e integritimeve në NATO dhe në BE. Transformimi në një pjesë me prosperitet të Evropës nuk varet kryesisht nga këmbëngulja e integritimit rajonal dhe as nga implementimi i tij në kuadër të procesit të integritimit, por nga aftësia e shteteve të rajonit për të mbledhur të gjithë implikimet dhe rëndësinë e bashkëpunimit rajonal dhe integritimit në strukturat Euro-Atlantike, si edhe për të përshtatur veprimet e tyre në këtë kuadër. Me krijimin dhe përcaktimin e prioritetëve të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, rajoni ka hyrë në një fazë të tretë vendimtare të transformimit. Kjo është ende një fazë tranzitore sepse nxitja e institucioneve ndërkombëtare është ende më e fuqishme sesa ajo e vendeve të rajonit. Mbështetja e ofruar nga elitat politike të vendeve përkatëse për këtë institucion unik rajonal si edhe niveli në të cilin ai reflekton dhe artikulon interesat e rajonit, do të jenë kryesorë për perspektivat e bashkëpunimit rajonal.

Procesi i integritimit në Bashkimin Evropian dhe NATO, është nxitësi kryesor për transformimin ekonomik dhe politik të rajonit. Këto procese integritimi janë faktorët kryesorë për promovimin e bashkëpunimit rajonal. Anëtarësimi në BE, nuk është vetëm shpresa më e mirë për stabilizimin dhe transformimin e rajonit por edhe për zhvillimin e mirë të

bashkëpunimit rajonal. Duke marrë parasysh se, perspektiva e qartë e anëtarësimit në BE është qëllimi strategjik i të gjithë vendeve të Ballkanit Perëndimor, si edhe se kjo mundëson motivimin e vullnetit të elitave politike lokale, për reformat e domosdoshme për një transformim të qartë të rajonit, zhvillimi i një strategjie të qartë për zgjerimin duhet të përbëjë një prioritet kryesor për rajonin.

Të gjithë shtetet e rajonit duhet të arrijnë të njëjtin status të vendit kandidat. Kështu do të lehtësohet harmonizimi i proceseve multilaterale të MSA-ve, me programin bilateral të CBC-së. Shenja e parë e dukshme e vullnetit lidhur me prospektin e ardhshëm për anëtarësim të rajonit është liberalizimi i plotë i vizave për të gjithë vendet. Bashkëpunimi rajonal përballet me pengesa për zhvillimin e tij. Më kryesoret prej tyre janë:

1. Efektet e pavarësisë së Kosovës mbi stabilitetin dhe bashkëpunimin rajonal.

2. Dilema e politikës së jashtme të Serbisë.

3. Problemet e rindërtimit të shtetit në Bosnjë-Hercegovinë dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

4. Problemet e kohezionit të brendshëm në shumë vende.

5. Strukturat shtetërore të dobëta në Shqipëri

Pavarësisht efekteve potenciale negative të barrierave rekomandohet që të vazhdohet ndërtimi i rrjeteve dhe urave lidhëse ndërmjet rrjeteve të aktorëve joshtetërore. Bazuar në eksperiencën e rajoneve të tjera, pritet që një bashkëpunim rajonal i tillë të zhvillohet pas hyrjes në NATO dhe BE, kur vendet e rajonit do të kenë vendosur dhe promovuar interesat e përbashkëta në kontekstin specifik më të gjerë të zonës Euro-Atlantike.

Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (KBR) analizoi ndikimin e krizës ekonomike globale mbi vendet e Ballkanit Perëndimor dhe vlerësoi një sërë veprimesh politike të ndërmarra dhe mënyra për arritjen e një pozicioni më të mirë konkurrues të rajonit në ekonominë globale. Problemi kryesor që doli në pah, është forcimi i kapacitetit për zhvillimin dhe zbatimin e opsioneve më të përshtatshme politike dhe për përdorimin e duhur të burimeve në dispozicion për tejkalimin e krizës dhe në terma afatgjatë, për arritjen e rritjes ekonomike dhe avantazhit konkurrues të qëndrueshëm dhe të bazuar me njohuri në rajon.

Kishte tre fusha kryesore ku aktivitetet e tjera të rajonit do të planifikohen:

1. Lidhur me burimet njerëzore në rajon si një parakusht kryesor për pasjen e një konkurrence afatgjatë (arsim, kërkim dhe zhvillim, kapacitete rinovuese);

2. Krijimi i kushteve për stimulimin e zhvillimit të njohurive (roli i institucioneve, bizneseve, rrjeteve ndërkombëtare, përmirësimi i bashkëpunimit rajonal dhe integrimi në BE).

3. Vendosja e mekanizmave për një bashkëpunim më të gjerë, i cili do të mundësonte aktivitete të sinkronizuara për mbi 40 organizata dhe iniciativa rajonale të cilat veprojnë tashmë në fusha të ndryshme dhe kontribuojnë për një qasje më të harmonizuar gjatë adresimit të sfidave të shumta rajonale (duke filluar që nga tregtia, investimet, studimet shëndetësore dhe zhvilluese e deri tek lufta kundër krimit të organizuar dhe katastrofave natyrore).

Është në diskutim e sipër zhvillimi i një platforme rajonale, që do të lehtësonte opsionet afatgjata dhe strategjike të politikave duke u përqendruar në tejkalimin e krizës dhe aderimin në BE (projekti për të Ardhmen e Ballkanit Perëndimor 2020, hartuar sipas projekteve afatgjatë të Strategjisë së BE-së, 2020 si vazhdimësi e strategjisë së Lisbonës, e cila u zhvillua për periudhën 2000-2010).

Të dhënat nga vendet anëtare të BE-së në rajon, Komisioni Evropian, Institucionet Ndërkombëtare Financiare, Sekretariati i CEFTA-s, nga iniciativa të tjera rajonale si edhe nga biznesmenët në rajon kanë nxjerrë në pah problemet kryesore, me të cilat përballet rajoni në zhvillimin ekonomik dhe atë shoqëror. Një formulë e përbashkët për të gjithë drejtimit e synuara është qeverisja e mirë dhe mënyrat për arritjen e saj. Masa shtesë nevojiten në zhvillimin e burimeve dhe përmirësimin e potencialit konkurrues. Komisioni do të vazhdojë të përdorë plotësisht instrumentet e tij të anëtarësimit dhe mekanizmat e mbikëqyrjes ekonomike për monitorimin e politikave ekonomike dhe fiskale të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Bashkimi Evropian ka dialog të rregullt me vendet kandidate, duke i familjarizuar ato me koordinimin dhe mbikëqyrjen e politikave ekonomike brenda BE-së. Një proces i ngjashëm është krijuar për vendet kandidate potenciale. Dialogu ekonomik ndërmjet komisionit dhe vendeve të përfshira në procesin e zgjerimit në kuadër të anëtarësimit janë përdorur për mbikëqyrjen e politikave ekonomike. Paralel me përpjekjet për dialog dhe mbikëqyrje BE-ja, mbështet në mënyrë aktive përpjekjet për rimëkëmbje, stabilizimin makro-ekonomik, dhe konsolidimin e vendeve të përfshira në procesin e zgjerimit. Prosesi i zgjerimit kontribuon për arritjen e objektivave të Strategjisë Evropa 2020, duke zgjeruar fushën në të cilën vepron kuadri rregullator i BE-së, dhe duke krijuar mundësi të reja tregtie.

Bibliografia

1. Anatol, L., Trenin, D., *Ambivalent Neighbours: The EU, NATO AND THE Price of Membership*, Carnegie Endowment for International Peace, 2003.
2. Aspinwall M.m Shcneider G., *Institutional research of the European Union: Mapping the fjeld*, 2001, 1-18
3. Avery, G., *The enlargement negotiations, the futre of Europe: Integration and Enlargement*, London: Routledge 2004, 35-62.
4. Begg I., Hodson D., Maher I., *Economic Policy Coordination in the European Union*, National Institute Economic Review, vol. 183, 2003.
5. Chirav M.D., Dumitru D., Ion E., *Organizatii si institutii politike si de securitate*, "Carol I" National Defense University Publishing house, Bucharest, 2007
6. De Grauwe, P., Schnabl G., *EMU: Entry Strategies for New Member States*, *Intereconomics*, vol.39, pp. 241-47; 2004.
7. Dinu, M.S.m Balcanji de Vest, "Carol I" National Defence University Publishing house, Bucharest, 2007.
8. Dumitru L.C., *Implicarea NATO in managementul crizelor din Balcanii de Vest*, "Carol I" National Defence University Publishing House, Bucharest, 2007.
9. Kenen P., Meade E., *EU accession and the Euro: Together or far appart?*, *International Economic Policy Briefs*, No PB03-9, Institute for International Economics, Washington , 2003.
10. Muresan, D., Buse D., *Securitatea si insecuritatea in Balcani de Vest: criza intetnica din noua federatie iugoslava*, CTEA Publishing House, Bucharest, 2008
11. Muresan, M., *Integrarea in UE si NATO a statelor Balcanilor de Vest. Impact Strategic*, "Carol I" National Defence University Publishing house, Bucharest, 2008.
12. *Defence Select Committee Report on the future of NATO*, Martin Butcher, 2008 The Acronym Institute.
13. *The Western Balkans: Between the Economic Crisis and the Euroepan Perspective*, Institute for Regional and International Studies, Sofia, septembrie 2010.
14. *IMF Country Report No 11/20*, Washington DC, ianuarie 2011, IMf.
15. <http://ec.europa.eu>.

Enis Fita, Phd ©
Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare
Universiteti Kristal

SFIDAT E SIGURISË GLOBALE
 DHE DOMOSDOSHMERIA
 E BASHKËPUNIMIT RAJONAL PËR
 INTEGRIMIN E BALLKANIT PERËNDIMOR

Abstrakt

Vendet e rajonit të Ballkanit janë përfshirë në një të pandalshëm integruer në strukturat e BE-së dhe NATO-s. Ato përballë kësaj problematike konkrete po përcaktojnë tendencat e zhvillimeve të ardhshme, për rekomandimin e politikave të përshtatjes dhe ristrukturimit ndaj modeleve të sjelljes së Sigurisë Globale dhe Rajonale. Sfida e sigurisë për vendet e Ballkanit ka qenë çështja e ruajtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial.

Ndryshimet e mëdha gjeopolitike dhe gjeostrategjike që përfshinë rajonin pas shembjes së komunizmit e që për pasojë sollën dhe shpërbërjen e Jugosllavisë, u shoqëruan me tensione dhe konflikte ndëretnike në rajon. Tashmë, koncepti i sigurisë rajonale është më i gjerë duke përfshirë dhe mbrojtjen e vlerave dhe parimeve themelore të sistemeve demokratike. Plotësimi i standardeve për anëtarësim në BE dhe NATO, nga vendet ballkanike ka qenë një proces i ngadalshëm, jo vetëm si pasojë e tranzicionit të gjatë demokratik të këtyre vendeve, por dhe si pasojë e mungesës së vullnetit të elitave politike në rajon për të kapërcyer tensionet dhe frustimet e së shkuarës.

Rajoni i Ballkanit, që pas shpërbërjes së Jugosllavisë dhe fundit të konflikteve me karakter fetar dhe etnik në Bosnjë dhe Kosovë, ka ndryshuar ndjeshëm por përmbajtja dhe cilësia e sigurisë është bërë më specifike, çështje dhe probleme akoma të pazgjidhura si: tensioni i vazhdueshëm mes komuniteteve në Bosnjë-Hercegovinës, konflikti i ashpër politik mes Kosovës dhe Serbisë, zgjidhja e çështjes së emrit të Maqedonisë etj., kërcënojnë seriozisht stabilitetin dhe sigurinë në rajon. Kjo karakteristikë e rajonit e bën atë më të brishtë për sa i përket sigurisë.

Ky punim do të fokusohet në një trajtim mbi problemet e mprehta të sigurisë rajonale dhe ndikimin e saj për integrimin evropian të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

1. Transformimi i konceptit të Sigurisë

Bota dhe mjedisi i ri i sigurisë ka pësuar ndryshime rrënjësore në shekullin e XXI. Midis studiuesve të marrëdhënieve ndërkombëtare mbështetës të qasjes realiste dhe idealiste ka ekzistuar një debat njëqindvjeçar për sa i përket konceptit të Sigurisë Globale. Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore qasja idealiste u përhap si pasojë e mbështetjes së tyre në krijimin e Lidhjes së Kombeve e cila ngjalli shpresa të mëdha, në krijimin e një rendi dhe sigurie të re ndërkombëtare. Para Luftës së Dytë Botërore, Siguria Globale konceptohej thujtse tërësisht në raport me çështjet e luftës, paqes dhe konfliktit të armatosur. Siguria kombëtare përfshinte mbrojtjen e kombit dhe territorit të tij nga sulmet nga jashtë apo trazirat e brendshme.¹ Ndërsa, pas Luftës së Dytë Botërore, gjatë periudhës 45-vjeçare të Luftës së Ftohtë do të triumfoje shkolla realiste e mendimit, e cila do të mbështetej në teorinë e balancimit të fuqisë ndërmjet SHBA-së dhe BS-së, si metodë për administrimin e fuqisë dhe të pasigurisë. Sipas qasjes realiste, nëse njëra palë tentonte të rriste fuqinë e saj ushtarake, pala tjetër duhet të kundërpërgjigjej me të njëjtën monedhë duke ruajtur një farë ekuilibri relativ gjatë Luftës së Ftohtë. Por a do të ishte efikase teoria e balancimit të fuqisë si metodë për të kontrolluar sigurinë gjatë periudhave të ndryshmeve të mëdha që pasuan me shpërbërjen e BS-së, dhe aleancës mbrojtëse të bllokut lindor, Paktit të Varshavës.

Fundi i konfrontimit ideologjik, politik, dhe ushtarak midis Lindjes dhe Perëndimit ngjalli një vizion të ri, për sigurinë dhe paqen globale. Sipas *Francis Fukujama*, fundi i Luftës së Ftohtë, nuk ishte vetëm një rilindje, por dhe një fitore e liberalizmit ndërkombëtar si pasojë e universalizimit të demokracisë liberale, si forma më e mirë e qeverisjes njerëzore.² Sipas këtij vizioni optimist, lufta dhe dhuna ndërshtetërore ishin tashmë relikte të së shkuarës që gradualisht do të zëvendësoheshin nga një epokë e re bashkëpunimi, mes aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë në garantimin e Sigurisë Globale.

Për shumë studiues të fushës, siguria është një koncept i kontestueshëm pasi dhe pse ata bien në emërues të përbashkët se, siguria në themel të saj përbën shfaqjen e kërcënimit ndaj vlerave themelore individuale dhe kolektive, ata ndahen në nivelin e trajtimit të saj, nëse siguria është individuale, kombëtare apo ndërkombëtare. Në kontekstin e Luftës së Ftohtë, siguria u

1. Mingst A.K, "Bazat e Marrëdhënive Ndërkombëtare", AIIS 2008.

2. Fukuyama.F, "The End of History", 1989.

trajtua kryesisht si “*Siguri Kombëtare*” në fuqizimin e shtetit në terma ushtarakë për ruajtjen e balancimit të fuqisë në sistemin bipolar.

Në kohët e sotme ky konceptim i sigurisë është kritikuar si tepër etnocentrik dhe i kufizuar. Studiuesit bashkëkohorë argumentojnë zgjerimin e konceptit të Sigurisë Kombëtare, duke përfshirë në të çështjet mjedisore, ekonomike, shoqërore e politike, si faktorë që ndikojnë në përmirësimin e paqes dhe stabilitetit në kontekstin global dhe lokal. *Buzan* argumenton për një vizion të sigurisë që përfshin termat politik, ekonomik, shoqëror, mjedisor dhe ushtarak gjithashtu, e cila duhet bërë pjesë e agjendës së politikave të Sigurisë Globale.³ Sipas këtij vizioni, siguria kombëtare duhet ridimensionuar në përshtatje me dinamikën e ndryshimeve të fillim viteve '90.

Fundi i shekullit të XX, solli ndryshime të thella gjeopolitike dhe gjeostrategjike.

Së pari, nisja e një procesi të vrullshëm integrues të vendeve të Evropës Qendrore e Lindore në strukturat e NATO-s dhe BE-së, kërkonte për këto vende plotësimin e shpejtë në nivel makro të standardeve politike dhe ekonomike.

Së dyti, shpërbërja e BS-së dhe Jugosllavisë, sollën probleme të reja me kufijtë, minoritetet e ideologjitë ultra nacionaliste të shoqëruara me tensione ndëretnike duke rrezikuar stabilitetin rajonal. Këto procese ndryshimesh të thella që shoqëruan botën e pas Luftës së Ftohtë, rritën vëmendjen mbi konceptin e “*Sigurisë Shoqërore*” të fokusuar jo vetëm për shoqëritë e prekura nga procesi i shpërbërjes së shtet-kombit, por edhe mbi krijimin embrional të një shoqërie globale.⁴

Procesi i globalizimit u shoqërua me rreziqe të reja ndaj sigurisë në nivel global. Rreziqe të cilat dalin jashtë kontrollit në nivel shtetëror të tilla si, krizat e sistemit monetar ndërkombëtar, ngrohja globale, terrorizmi ndërkombëtar, katastrofat nga aksidentet nukleare etj. Kështu në shekullin e ri debati është fokusuar, mbi Sigurinë Globale dhe Ndërkombëtare si rrjedhojë e ndryshimeve të mëdha të politikave botërore nën ndikimin e procesit të globalizimit. Ekziston një mendim i përgjithshëm se, për tu përballur me këtë dinamikë ndryshimesh, nevojitet rikonceptimi i një agjende të përbashkët mbi Sigurinë Globale, midis aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë.

Kjo domosdoshmëri vjen si pasojë e transformimit të konceptit të Sigurisë Kombëtare nën ndikimin e efekteve pozitive dhe

3. *Buzan, B., “Peoples, States and Fear”, London 1983.*

4. *Baylis, J., “Globalisation of World Politics”, Oxford 2001.*

negative të procesit të globalizimit. Efekti pozitiv i këtij procesi e bën të domosdoshëm bashkëpunimin mes shteteve në kontekstin e një ekonomie të globalizuar, ndërvarësisë në çështjet mjedisore, luftës ndaj kërcënimit të terrorizimit ndërkombëtar, të mbrojtjes ndaj krimit kibernetikë, përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë etj. *Lawler* argumenton se rritja e multilateralizmit shkaktuar nga globalizimi, ndihmon në lehtësimin e dialogut të elitave vendimmarrëse në nivel shtetëror në përcaktimin e objektivave të përbashkëta për Sigurinë Globale.⁵ **Së dyti**, globalizimi ndikon me efekte negative ndaj Sigurisë Kombëtare si pasojë e ndryshimeve të shpejta në strukturën shoqërore, rritjes së pabarazisë ekonomike, sfidave të “*shokut*” kulturor, fenomene të cilat prodhojnë konflikte mes shteteve. Ky proces i dyanshëm nënkupton se, duke qenë se shtetet nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për t’u përballur të vetme me këto sfida, bëhet e domosdoshme gjetja e zgjidhjeve multilaterale duke krijuar agjenda të përbashkëta bashkëpunimi për Sigurinë Rajonale e Globale.

2. Bashkëpunimi rajonal i vendeve të Ballkanit Perëndimor, pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë

Në dy dekadat e fundit, Ballkani ka përjetuar shumë ndryshime. Pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, Rajoni pësoi ndryshime radikale territoriale të cilat u shoqëruan dhe me konflikte të armatosura ndëretnike. Një dinamikë komplekse ndërveprimi midis faktorëve historik, etnik, fetar dhe gjeopolitikë në Evropën Juglindore (e njohur ndryshe si Ballkan), ka kontribuar në krijimin e një prej rajoneve me pak të qëndrueshme politikisht dhe më pak të zhvilluar ekonomikisht në kontinentin Evropian. Fundi i Luftës së Ftohtë, dhe veçanërisht periudha e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë e zhyti rajonin në një gjendje të thellë krize, si pasojë e konflikteve të vjetra etnike dhe çështjeve të tjera të mbetura pezull.

Gjatë gjysmës së parë të viteve '90 sidomos, mbas marrëveshjes së Paqes të *Dayton* që i dha fund luftës në Bosnjë, fusha e lojës në rajon ndryshoi në thelb. Një numër i konsiderueshëm misionesh të “komunitetit ndërkombëtar” do të vendoseshin në rajon, me qëllim kryesor monitorimin dhe raportimin e situatave. Misione të reja u vendosën nën ombrellën

5. *Weaver. O., Identity, Migration and the New Security Agenda in Europe, London 1993.*

e aktorëve të ndryshëm ndërkombëtar si OKB-së, NATO-s, OSBE-ja, FMN-ja, Banka Botërore, Këshilli i Evropës, me funksion monitorimin e zhvillimin e rrjeteve dhe aktiviteteve në dobi të “promovimit të demokracisë”, në vendet që ishin të përfshira në konflikte. Megjithatë, stabiliteti në rajon është larg pritshmërisë së “komunitetit ndërkombëtar”. Dayton i dha fund luftës në Bosnje-Hercegovinës, por përgjakjet në Ballkan do të ripërsëriteshin me konfliktin e Kosovës dhe Maqedonisë më pas.

Përgjithësisht, deri në zgjidhjen e krizës së Kosovës, BE-së i kishte munguar një strategji e përbashkët për Ballkanin, i cili kishte gjeneruar në dhjetë vite vetëm kriza dhe luftëra. Për këtë arsye, ky rajon përbënte për BE-në, një sfidë që duhej përballuar për pasigurinë dhe paqëndrueshmërinë që mund të eksportonte jashtë kufijve të tij. Sërish duke shmangur premtimet e paqarta për anëtarësim, BE-ja edhe njëherë duhej të harmonizonte mbështetjen e “komunitetit ndërkombëtar”, ndaj rajonit.

Etapat e zhvillimit rajonal nën ndikimin e aktorëve ndërkombëtarë filloi në vitin 1996, me nismën e parë në Ballkan e quajtur Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP), si një pjesë e strategjisë evropiane, për të ndihmuar rajonin për të dalë nga kriza e rënies së ish-regjimeve komuniste. SEECP është një forum bashkëpunimi që u përqendrua në çështje të tilla si: forcimi i sigurisë, stabiliteti i marrëdhënieve të mira fqinjësore, zhvillimin ekonomik, drejtësia, lufta kundër krimit të organizuar, drogës dhe trafikëve të paligjshme të armëve dhe terrorizmit.

Gjatë viteve 1999 (kriza e Kosovës) dhe 2001 (kryengritja në Maqedoni), vendet pjesëmarrëse të SEECP (Shqipëria, B-H, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Rumania, Serbia, Turqia), u ndanë për shkak të dallimeve të tyre në çështjet e Ballkanit Perëndimor. Pas deklaratës së SEECP-së, për çështjen e Kosovës në vitin 1999, Jugosllavia e kundërshtoi deklarinimin, e cila më pas u përjashtua nga SEECP-ja. Edhe pse SEECP-ja, nuk ka pasur një ndikim të rëndësishëm në rajon, ai mbetet i vetmi forum që ishte krijuar nga vendet e rajonit.

Kështu që në 1999, në të njëjtën kohë me ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë, filloi edhe vënia në jetë e “Paktit të Stabilitetit”, si korniza ligjore e bashkëpunimit rajonal me mbështetjen e fuqishme të “komunitetit ndërkombëtar”. Pakti i Stabilitetit u shndërrua shumë shpejt në tryezën rajonale për të diskutuar rreth problemeve për zgjidhjen e tyre bashkërisht. Secila prej këtyre tryezave ka promovuar nisma të ndryshme rajonale si

për shembull: Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), e cila synon liberalizimin e marrëdhënieve tregtare midis Shqipërisë, Bosnje- Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë, Moldavisë, Malit të Zi, Serbisë dhe UNMIK-ut, në emër të Kosovës nën UNSCR1244. Kjo marrëveshje ishte një shtytje më e fuqishme për të ndodhur ndryshimet e duhura. Pakti i Stabilitetit për Ballkanin⁶, i nënshkruar në vitin 1999, ishte përpjekja e parë serioze e bashkësisë ndërkombëtare me një strategji të përbashkët dhe afatgjatë për stabilitetin, mirëqenien dhe trajtimin e çështjeve si lufta kundër korrupsionit e krimit të organizuar.

Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore, ishte një histori suksesi pasi realizoi stabilitetin rajonal duke ia kaluar përgjegjësitë Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC). Me qëllim që bashkëpunimi rajonal të konkretizohej me objektiva të qarta, në Tryezën Rajonale të Beogradit në vitin 2006, u vendos krijimi i Këshillit Rajonal i Bashkëpunimit (RCC), i cili do të duhej të merete përgjegjësitë e tij. Si e tillë RCC-ja, vazhdoi punën e Paktit të Stabilitetit, por me dallimin kryesor se, kjo strukturë tashmë është në pronësi gjithnjë e më shumë nga vendet e rajonit. Detyra e saj nuk është më për të stabilizuar rajonin, por tani për ta udhëhequr atë drejt integritimit Euro-Atlantik. Krijimi i RCC-së, kishte për mision lehtësimin e bashkëpunimit rajonal përmes:

1. Zhvillimit ekonomik (tregtia, investimet)⁷.
2. Përmirësimit të infrastrukturës (transporti⁸, mbrojtja e mjedisit⁹, energjia¹⁰).
3. Drejtësinë dhe punët e brendshme (lufta kundër krimit të organizuar¹¹ dhe korrupsionit¹²).
4. Bashkëpunimi mbi sigurinë (Sektori i Sigurisë)¹³.

6. Me iniciativën e BE-së u miratua në Këln të Gjermanisë nga 40 vende dhe organizata partnere për të promovuar Paqen, Demokracinë, të Drejtat e Njeriut dhe zhvillimin ekonomik për EJL-në.

7. CEFTA-Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore nënshkruar në Bukuresht 2006.

8. Në vitin 2006 u krijua Këshilli Drejtues Rajonal dhe Observatori i Transportit të EJL, SEETO, me seli në Beograd.

9. Programi Rajonal i Rikonstruktimit e Mjedisit për EJL (REREP)

10. Nëntë vende të EJL janë nënshkruese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë në Athinë 2005.

11. Iniciativa kundër Krimit të Organizuar (SPOC) e Paktit të Stabilitetit 2002; SEEPAG - Grupi Këshillues i Prokurorëve të EJL formuar në vitin 2003; SECI - Qendra Rajonale në Bukuresht kundër krimit ndërkufitar.

12. Iniciativa kundër Korrupsionit RAI, e Paktit të Stabilitetit

13. Komiteti i Koordinimit të Ministrave të Mbrojtjes së EJL (SEDMI) dhe i Komitetit Drejtues Politik-Usharak (PMSC) të Forcës Shumëkombëshe të Paqes (MPFSEE).

5. Ndërtimit të kapitalit njerëzor (arsim, trajnim profesional dhe teknik).

6. Bashkëpunimit parlamentar.

Bashkëpunimi rajonal do të shihej si një domosdoshmëri dhe parakusht për vendet e Ballkanit në Procesin e Stabilizim Asocimit (PSA). Përpjekjet e BE-së, kundrejt bashkëpunimit rajonal konstruktiv janë bazuar në stabilizimin politik, ekonomik e të sigurisë në funksion të perspektivës së përbashkët për anëtarësim në BE. Aktivitetet e BE-së, lidhur me bashkëpunimin rajonal janë zhvilluar në nivele të ndryshme:

- Niveli Bilateral – marrëdhëniet midis vendeve të rajonit dhe me vendet fqinje brenda kornizës së marrëdhënieve bilaterale të BE-së.

- Niveli Rajonal Multilateral – si mbështetje e iniciativave rajonale dhe bashkëpunimit brenda Ballkanit Perëndimor ose më gjerë brenda kornizave të marrëdhënieve të shteteve të Evropës Juglindore; përfshirja e rajonit si një i tërë në kornizat e marrëdhënieve multilaterale në nivelet evropiane dhe ato globale.

Qëllimet e BE-së, në promovimin e bashkëpunimit rajonal ishin në fillimet e tyre në dobi të shtet-ndërtimit të rajonit pas trazirave. Në fillim të shekullit të ri, Stabilizimi dhe Asocimi ishin qëllimet më të avancuara të strategjisë për integrim për të përshpejtuar reformat. Pas rrëzimit të regjimit të Millosheviçit, objektivat e vendeve të rajonit u fokusuan në arritjen e standardeve për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Bashkëpunimi Evropian u pa si një pjesë integrale e përgatitjeve për anëtarësim në strukturat Evropiane. Kontributi i çdo vendi në arritjen e objektivave rajonale do të ndihmonte në plotësimin e standardeve të kërkuara për anëtarësim me të drejta të plota brenda BE-së. Gjithashtu qëllimet e vendosura për t'u arritur nëpërmjet bashkëpunimit rajonal janë një mjet për të arritur një stabilitet dhe për të vazhduar me reformat e mëtejshme.

Pikërisht, forcimi i marrëdhënieve shumëpalëshe rajonale, u materializua në aktivitetin e një varg iniciativash rajonale: Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECp), Iniciativa për Bashkëpunimin në EUL (SECI), Pakti i Stabilitetit për EUL (SPSEE), Iniciativa e Evropës Qendrore (CEI), Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi, Nisma Adriatiko-Joniane, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) etj. Angazhimi i vendeve të EUL-së, në këto nisma i ka shërbyer promovimit të fqinjësisë së mirë, sigurisë dhe stabilitetit rajonal, sigurimit të mbështetjes politike për financime të projekteve në fushat prioritet për zhvillimin kombëtar e rajonal. Shqipëria është pjesëtare aktive në të gjitha

nismat që veprojnë në rajonin e Evropës Juglindore.

Bashkëpunimi rajonal është në interesin më të madh të vendeve të Ballkanit, pasi është në dobi të vetë këtyre vendeve dhe është një parakusht i nevojshëm për zhvillim e secilit prej vendeve të përfshira. Megjithatë, bashkëpunimi rajonal në fusha të ndryshme si për shembull, tregtia, energjia, infrastruktura, çështjen e ambientit, drejtësisë dhe punëve të brendshme, edukimit dhe shkencave, kulturës etj., po zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme, në veçanti në nivel bilateral. Lufta kundër krimit të organizuar, menaxhimi i migracionit, zhvillimi i infrastrukturës rajonale, dhe përmirësimi i cilësisë së ambientit, zhvillimi i tregjeve të përbashkëta, ngritja e kapaciteteve njerëzore, janë faktorë të identifikuar si iniciativat kryesore për bashkëpunim dhe përfitime të përbashkëta. Qeveritë e rajonit kanë kuptuar se, afërsia gjeografike dhe fizike, kohezioni social dhe kulturor në termat e etnicitetit, dhe mbi të gjitha qëllimi i përbashkët për anëtarësim në strukturat euro-atlantike, si NATO dhe BE, krijojnë një bazë të qëndrueshme për forma më të avancuara të bashkëpunimit rajonal.

3. Perspektiva dhe sfidat për Sigurinë Rajonale në fillim të shekullit të ri

Më shumë se dhjetë vjet kanë kaluar që nga lançimi i Paktit të Stabilitetit në një rajon të prekur nga luftërat shkatërruese shoqëruar me vite pasigurie, frikë, mosbesim, madje edhe urrejtje. Zhvillimi i bashkëpunimit rajonal u evidentua si një faktor kyç për vendosjen e stabilitetit politik, sigurisë dhe prosperitetit ekonomik. Pas luftërave dhe konflikteve me karakter etnik në Ballkan lind pyetja: Se cilat janë çështjet apo sprovat e sigurisë për vendet e Evropës Juglindore në fillim të shekullit të XXI?

Në nivel kombëtar, pikënisja është natyra e shtetit pasi institucionet shtetërore në Ballkan, mbeten akoma të brishta. Kërcënimet kryesore me të cilat përballemi sot në rrafshin rajonal janë: sfida për të vendosur shtetin ligjor, për të forcuar institucionet dhe për të bërë qeverisjen efektive, rritja ekonomike, lufta kundër krimit të organizuar, trafiqet e paligjshme, korrupsionit dhe terrorizmi.¹⁴ Sfidat e çdo shteti ballkanik në fushën e sigurisë janë, njëkohësisht, dhe sfidat rajonale të

¹⁴ Demi, L., *Sfidat politike të sigurisë. Përpyekjet e Shqipërisë për t'u anëtarësuar në NATO dhe bashkëpunimi ynë rajonal, Konferenca e 11-të, e Këshillit Atlantik të Shqipërisë, prill 2006.*

sigurisë. Shtetet Ballkanike, nuk mund të përballen të vetme me këto sfida, prandaj dhe bashkëpunimi rajonal në fushën e sigurisë është një domosdoshmëri për integrimin e këtyre vendeve në familjen e përbashkët evropiane.

Pas gati dy dekadash, të rrëzimit të regjimit komunist, Ballkani ende vuan pasojat e së shkuarës konflikteve. Kosova dhe Bosnja-Hercegovina, janë konfliktet e fundit në rajon ende në proces në nivel politik, të cilat prodhojnë akoma fërkime dhe tension me ndikim për të gjithë rajonin. Anëtarësimi në NATO i dy vendeve në rajon, Kroacisë dhe Shqipërisë, dhe aspirata për anëtarësimin e Ballkanit Perëndimor në BE e bën shumë të rëndësishme çështjen e stabilitetit dhe bashkëpunimit në rajon.

Sigurisht, përmirësimi i sigurisë është i rëndësishëm jo vetëm për vet rajonin, por edhe për aktorët ndërkombëtarë të përfshirë në Sigurinë e Rajonit. Për shkak të çështjeve të përbashkëta që ndikojnë në rajon, bashkëpunimi rajonal ka një ndikim të madh në përmirësimin e Sigurisë në Rajon. Siç përmenda më sipër, sot sfera e Sigurisë Globale dhe Rajonale është shumë më e gjerë. Në raport me sigurinë rajonale lind pyetja: Se cilat janë prioritetet e sigurisë dhe cilët janë mekanizmat dhe masat e nevojshme për arritjen e tyre?

Është e rëndësishme të theksohet se, siguria në dimensionin horizontal përfshin çështjet ushtarake, ekonomike, shoqërore e mjedisore etj. Pas rënies së komunizmit në Ballkan, ndodhën ndryshime radikale ku Siguria Rajonale nuk ndikohet më vetëm nga kërcënimi ushtarak, por varet nga çështje të reja të tilla si: nacionalizmi, stabiliteti ekonomik dhe siguria e kufijve.

Dimensioni vertikal i sigurisë fokusohet mbi aktorët e ndryshëm të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, që nga individi, shteti, dhe në organizatat rajonale dhe mbirajonale. Edhe pse një pjesë e madhe e studimeve të sigurisë përqendrohet te shteti si aktor qendror, në shekullin e XXI, nuk është i vetmi aktor në fushën e lojës. Në mjedisin e sotëm global, sovraniteti i kombit-shtetit është dobësuar për shkak se shteti tashmë është i ndërvarur nga veprimi i organizatave ndërkombëtare dhe mbikombëtare. Pra, bashkëpunimi mes shteteve të rajonit mbi sigurinë bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm, për sigurinë e tyre të përbashkët. Përse problematikat e vendeve të Ballkanit Perëndimor janë të ndërlydhura me njëra-tjetrën? Siguria dhe stabiliteti i rajonit nuk mund të trajtohet apo të zgjidhet për secilin shtet më vete.

Siç përmenda më sipër, ekzistojnë shumë probleme që rrezikojnë paqen e brishtë në rajon. Çfarë rajoni ka nevojë sot është: dialogu politik, stabiliteti, mirëkuptimi reciprok. Ndërhyrja

e NATO-s dhe Bashkimit Evropian, në rajon është vendimtare për sigurinë rajonale.

SHBA dhe NATO kanë luajtur një rol kryesor për bashkëpunimin rajonal në çështjet e sigurisë që në Samitin e Uashingtonit në vitin 1999, u përpunua një nismë për vendet e EJL. Aty u shpall iniciativa e NATO-s, për EJL me qëllim për të çuar më tej bashkëpunimin ballkanik dhe sigurinë e stabilitetin afatgjatë në rajon. Në vitin 2003, Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia, nënshkruan “Kartën e Partneritetit” (A3). Kjo nismë ishte një tregues i vizionit të përbashkët për paqen dhe stabilitetin në rajon dhe progresivisht drejt anëtarësimit të tyre në NATO. Karta gjithashtu ripohoi se palët ndajnë përkushtimin e tyre politik për të forcuar institucionet demokratike, shoqërinë civile, sundimin e ligjit, ekonominë e tregut, për të luftuar korrupsionin dhe krimin, dhe për të mbrojtur të Drejtat e Njeriut dhe liritë qytetare për të gjithë individët në vendet e Evropës Juglindore. Nisma e “SHBA - Karta e Adriatikut” është iniciativa më efektive rajonale, jo vetëm për shkak të rezultatit të saj (dy nga tre vendet pjesëmarrëse janë anëtare në NATO), por kjo kartë ka promovuar stabilitetin rajonal pasi ajo shërbeu si, një forum për të diskutuar jo vetëm çështje ushtarake, por edhe çështje të tjera të tilla si ekonomia, demokracia, shoqëria civile, sundimi i ligjit.

Sot në Ballkanin Perëndimor, në aspektin e sigurisë ushtarake ne mund të vëzhgojmë një situatë relativisht të sigurt e të qëndrueshme pasi “paqja negative”, e përkufizuar si mungesë e luftës, është arritur dhe përgjithësisht kërcënimet tradicionale ndaj sigurisë janë zvogëluar. Nga ana tjetër, problemet politike, sociale dhe ekonomike mbeten ende pengesa serioze në rrugën e arritjes së një “paqeje pozitive” të qëndrueshme e cila do të udhëheqë konsolidimin e shteteve demokratike. Krahas zhvillimeve pozitive çështje të vështira në procesin e ndërtimit të paqes në rajon ende mbeten të pazgjydhura si: procesi i papërfunduar i shtet-ndërtimit, përkatësisht të shteteve të dobëta si Bosnje-Hercegovina dhe Kosova dhe marrëdhëniet e brishta ndëretnike duke përfshirë dhe Maqedoninë.

Nën frymën e konceptit të “bashkëpunimit mbi sigurinë”, shtetet, qeveritë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë kanë tashmë një hapësirë të gjerë veprimi për të zhvilluar një mjedis të qëndrueshëm të Sigurisë Rajonale. Pavarësisht ose vetëm për shkak të përvojës së luftës, bashkëpunimi rajonal duhet të jetë një element kyç në këtë zhvillim. Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore dhe pasardhësi i tij, Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC), kanë përmbushur një detyrë të rëndësishme në ngritjen

e vetëdijes së aktorëve rajonal për trajtimin e kërcënimeve moderne në një kuadër bashkëpunimi¹⁵.

Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC), ka vënë bashkëpunimin në fushën e sigurisë midis përparësive të saj kryesore. Me mbështetjen e fortë të RCC-së, disa nisma po punojnë me sukses në këtë fushë. Qëllimi kryesor është që të arrihet një pronësi e plotë rajonale. Për arritjen e këtij qëllimi, Sekretariati i RCC-së ka zhvilluar strategjinë dhe programin e punës për 2011-2013, me objektiva dhe aktivitete konkrete në fushën e bashkëpunimit për sigurinë. Shtylla themelore për këtë bashkëpunim është krijimi i një platforme për shkëmbimin rajonal të informacionit të klasifikuar si një parakusht thelbësor për çdo formë të bashkëpunimit të sigurisë rajonale.

Raporti vjetor, i majit 2011, në lidhje me bashkëpunimin rajonal në EJK, ka regjistruar një rritje të pronësisë rajonale dhe një zhvillim të qëndrueshëm në të gjitha fushat me rëndësi jetike. Ky zhvillim ka ndikuar në dinamikën e përgjithshme të bashkëpunimit rajonal. Megjithatë, zhvillimet e fundit mbi bashkëpunimin rajonal janë tregues që konfirmojnë rritjen e frymës rajonale drejt rrugës së përmirësimit të marrëdhënieve të mira fqinjësore, punës së përbashkët për të zgjidhur problemet e përbashkëta, si faktorë kryesorë që përcaktojnë prosperitetin dhe aftësinë për funksionimin efikas të vendeve të rajonit¹⁶.

Raporti dhe Programi i Punës 2011-2013, i referohen disa prej zhvillimeve të përmendura më sipër duke nxjerrë në pah sfidat në raport me qëndrueshmërinë e procesit të bashkëpunimit të sigurisë.

Bashkëpunimi në fushën e Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme ka regjistruar përmirësime pavarësisht problemeve që kanë vazhduar në rajon. Një sërë aktiviteteve dhe strukturash janë zhvilluar me përfshirjen e Sekretariatit të RCC.¹⁷ Një përgjigje e fortë rajonale i është dhënë në luftën kundër formave të rrezikshme të kriminalitetit dhe në veçanti në luftën kundër krimit të organizuar, i cili është një prioritet kryesor strategjik në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme në rajon. Sekretariati i RCC-së, u përqendrua në zhvillimin e konvergimit dhe integritit

15. Major General Johann Pucher, Regional cooperation, supporting element in building coherent and vital European Union.

16. Annual Report of the Secretary General of the Regional Cooperation Council on Regional Cooperation in South-East Europe, Sarajevo 12 May 2011.

17. Këto përfshijnë: vendosjen në vendet e Ballkanit Perëndimor të Njësisë Koordinuese të Zbatimit të së Drejtës Ndërkombëtare (ILECUS), krijimin e Rrjetit të Ekspertëve të Integritetit (IEN), në kuadër të Nismës Kundër Korrupsionit Rajonal (RAI).

të aktiviteteve të strukturave të ndryshme rajonale të policisë dhe të zbatimit të ligjit, duke përdorur normat ekzistuese të përcaktuara nga Konventa për Bashkëpunim Policor për Evropën Juglindore (PCC-SEE, Vjenë 2006), dhe Konventa e Qendrës të EJL, për zbatimin e ligjit (SELEC, Bukuresht 2009).

Në fushën e bashkëpunimit për sigurinë ka gjashtë nisma të krijuara para krijimit të RCC-së, me të cilat Sekretariati i RCC ka ndërtuar marrëdhënie të mira pune. Këto Taks Forca dhe nisma rajonale kanë zhvilluar projekte dhe mekanizma të rëndësishme në kuadër të bashkëpunimit rajonal të sigurisë, në disa prej të cilave Sekretariati RCC-së, ka qenë lidhur në mënyrë direkt apo indirekte. Sekretariati i RCC-së, ka mbështetur lidhjet e tij duke punuar me gjashtë Iniciativat Rajonale:

a. qendra rajonale RACVIAC (Qendra për Bashkëpunim në Fushën e Sigurisë), bazuar në një marrëveshje të rinogociuar kohët e fundit dhe në proces ratifikimi,

b. Sekretariatit Rajonal i Nismës për Gatishmërinë dhe Parandalimin e Fatkeqësive (DPPI), i cili funksionon mbështetur në një Memorandum Mirëkuptimi,

c. projektet e ekipit të Evropës Juglindore dhe Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (SEESAC),

d. Komiteti i Koordinimit të ministrave të Mbrojtjes së EJL (SEDMI),

e. A 5 (SHBA- Karta e Adriatikut) dhe **f.** SEEC.

Kontaktet dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me këto iniciativa ka treguar se, bashkëpunimi rajonal është duke përmirësuar koordinimin me qëllim një përdorim sa më të mirë të sinergjive ekzistuese dhe për të shmangur dyfishimin e përpjekjeve të panevojshme që konsumojnë të gjitha llojet e burimeve. Detyra e Sekretariatit të RCC-së, është që të konsolidojë më tej kornizën normative për Bashkëpunim Rajonal duke marrë parasysh nevojat e iniciativave partnere rajonale dhe rolin e tyre në zbatimin e Strategjisë dhe Programit të Punës 2011-2013.

Roli i Sekretariatit të RCC-së, në bashkëpunimin e Sigurisë Rajonale ka për objektiva, ruajtjen dhe zhvillimin e nivelit të besimit dhe zgjerimin e bashkëpunimit përmes:

a. krijimit të një mekanizmi të qëndrueshëm, të integruar dhe transparent në pronësinë e mekanizmave rajonal të bashkëpunimit midis Sektorëve të Sigurisë;

b. ruajtjen dhe riorganizimin efektiv të Taks Forcës dhe nismave rajonale për të dhënë rezultate të prekshme;

c. inicimin e nismave të reja me kosto të ulët, me ndikim të lartë në ndërtimin e besimit dhe transparencës, dhe

d. riorganizimin e burimeve të institucioneve financiare ndërkombëtare dhe komunitetit të donatorëve, në aktivitete me

vlerë të dukshme për masat e ndërtimit të sigurisë dhe reformës në Sektorin e Sigurisë. Në këtë drejtim, Sekretariati i RCC-së, ka filluar zbatimin e një sërë aktivitetesh të rëndësishme, të tilla si: zhvillimin e bashkëpunimit rajonal mes Shefave të Inteligjencës Ushtarake të EJL (SEEMIC), me mbështetjen e plotë të Drejtorisë së Zbulimit Ushtarak të BE-së; Forumit të Shefave të Autoriteteve Kombëtare të Sigurisë (SEENSA), me mbështetje të fortë të Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të Zyrës së Sigurimit në BE dhe Zyrën e NATO-s, për Sigurinë.

Për periudhën 2011-2013, RCC-ja, ka identifikuar si prioritet, rritjen e dialogut rajonal dhe mekanizmave të bashkëpunimit mbi çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes, duke përfshirë edhe zhvillimin, planifikimin dhe koordinimin e strategjive të përbashkëta. RCC do të lehtësojë dhe mbështesë zhvillimin e dialogut rajonal dhe mekanizmave të bashkëpunimit me ndikim të lartë në ndërtimin e besimit rajonal.

Duke marrë parasysh rëndësinë e përmirësimit të bashkëpunimit rajonal në fushën e reduktimit të rrezikut fatkeqësive, Sekretariati i RCC-së, ka ndërmarrë disa hapa konkretë në këtë drejtim, të tilla si një koordinim aktiv për planifikimin strategjik për programin IPA, mbështetje të drejtpërdrejtë për kryesinë e nismës DPPI¹⁸, për zbatimin e një agjende më efikase, veçanërisht lidhur me Reformën e Sekretariatit të DPPI.

Disa Autoritete Kombëtare të Sigurisë në Evropën Juglindore, anëtarë të RCC-së, kanë zhvilluar marrëdhënie të ndërsjella duke nënshkruar marrëveshje dypalëshe, por kjo është larg kënaqjes së nevojave në rritje të të gjithë aktorëve të përfshirë në procesin e ndërlidhur të shkëmbimit të informacionit të klasifikuar, si për qëllime ushtarake ashtu dhe civile.

Një nga problemet me Evropën Juglindore (EJL) është se, me çështje kaq shumë të kundërta, ndonjëherë është e vështirë për të kuptuar perspektivën e vërtetë. Në të vërtetë, Miratimi i Raportit Vjetor për bashkëpunimin rajonal në Evropën Juglindore, dëshmon se, anëtarët njohin përpjekjet e qëndrueshme dhe të vazhdueshme të RCC-së, për të punuar ngushtësisht për zbatimin e Strategjisë dhe Programit të Punës 2011-2013. Më shumë se një miratim zyrtar, ishte e qartë se në të gjitha fushat prioritet i punës ka një përparim të verifikuar. Bashkëpunimi mbi drejtësinë dhe çështjet e bashkëpunimit ka arritur në një nivel të ri si dhe bashkëpunimi rajonal i sigurisë, që deri pak kohë më parë ishte i pakonceturshëm, tashmë ka hedhur hapa konkretë.

18. DPPI - Disaster Preparedness and Prevention Initiative.

Bashkëpunimi Rajonal shihet tani si një mjet për të trajtuar zhvillimin konkret dhe praktik midis vendeve anëtare, duke hapur dritare të reja mundësish për Procesin e Bashkëpunimit të EJK (SEECF) dhe Këshillin Rajonal të Sigurisë (RCC). Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të bëjnë përpjekje të përbashkëta për lehtësimin e nevojave aktuale politike, ekonomike dhe sociale, përfshirë këtu përparimin e tyre drejt integritit në BE.

Konkluzion

Siç tregohet më lart, bashkëpunimi rajonal në Ballkan është i domosdoshëm për të ardhmen e rajonit. Bashkëpunimi është një përbërës i rëndësishëm i stabilitetit; një katalizator për pajtimin, fqinjësinë e mirë dhe marrëdhëniet të mira politike; si dhe një ndihmës për të kapërcyer nacionalizmin dhe intolerancën dhe nxitjen e mirëkuptimit reciprok dhe dialogut politik në rajon.

Duke pasur parasysh mundësitë dhe sfidat e bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor mund të shihet se, bashkëpunimi rajonal është mënyra e vetme për të zgjidhur problemet e tyre të përbashkëta të sigurisë duke pasur të njëjtin objektiv për anëtarësim në NATO dhe BE. Gjithashtu, mbështetja e jashtme (BE, SHBA, NATO) është një mundësi për të shtuar bashkëpunimin midis vendeve të rajonit.

Për stabilitetin dhe integritimin rajonal, Strategjia dhe Programi i Punës për Bashkëpunim Rajonal paraqet një mundësi dhe një sfidë në të njëjtën kohë. Kjo është një mundësi, sepse ajo është e drejtuar nga rajoni, por është edhe një sfidë, sepse ajo duhet të jetë e suksesshme në mënyrë që të promovojnë bashkëpunimin të nxitur jo nga aktorë të jashtëm, por nga vetë rajoni.

Florian Trauner¹

QEVERISJE NËPËRMJET KONDITIONALITETIT, QEVERISJE NË RRJET APO TË DYJA? STUDIMI I POLITIKAVE TË BRENDSHME TË SIGURISË SË BE-SË, NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Abstrakt

Ky shkrim synon të analizoj strategjinë e brendshme të Sigurisë së BE-së, në Ballkanin Perëndimor nëpërmjet një lenteje të “qeverisjes së jashtme”, duke bërë dallimin ndërmjet qeverisjes së jashtme nëpërmjet kondicionalitetit dhe qeverisjes në rrjet. Argumentohet se, kjo e fundit ka marr rëndësi në marrëdhëniet BE-Ballkanin Perëndimor më tepër si një plotësim se sa si një zëvendësim i qeverisjes së BE-së, nëpërmjet kondicionalitetit. Gjatë ruajtjes së ndikimit të jashtëm, BE është mbështetur gjerësisht në veglën e anëtarësimit të ardhshëm. Qasja e kondicionalitetit në BE u fuqizua duke përdorur iniciativën e liberalizimit të vizave, për të inkurajuar reforma gjithëpërfshirëse në sektorin e drejtësisë dhe punëve të brendshme. Në kuadër të qeverisjes në rrjet, BE është munduar nga njëra anë të nxis bashkëpunimin operacional dhe rrjetëzimin midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, dhe nga ana tjetër të krijoj struktura të bashkëpunimit rajonal dhe rrjete brenda për brenda rajonit.

Hyrje

Politikat e brendshme të sigurisë së BE-së, kanë marr një rëndësi të veçantë për Ballkanin Perëndimor në kuadër të Procesit të Stabilizim Asocimit për dy arsye. Ndërkohë që interesi i parë strategjik i BE-së, ka qenë të përmirësoj situatën në rajon dhe të asistoj këto shtete, të krijojnë institucione efektive dhe të përgjegjshme të zbatimit të ligjit dhe të përmirësoj sistemet e menaxhimit të kontrollit të kufirit dhe

¹ Autori është një Studiues Politik pranë Institutit për Kërkime për Integrimin Evropian i Akademisë austriake të Shkencave. (OEAW).

migracionit, *i dyti* ka qenë ndalimi i hyrjes së pasigurive nga Ballkani Perëndimor. Ky shkrim ka si qëllim të analizoj strategjinë e brendshme të sigurisë së BE-së, në Ballkanin Perëndimor nëpërmjet një lenteje “të qeverisjes së jashtme”. Në kontekstin e Zgjerimit Lindor, një literaturë e gjerë është shfaqur për qeverisjen e jashtme të BE-së, duke u përpjekur të teorizoj se si BE-ja, mund t’i bëjë vendet candidate t’i binden rregullave dhe politikave të brendshme (për një këndvështrim të përgjithshëm shiko “*Sedelmeier*”, 2006). Argumenti institucionalit racional provoi të kishte fuqi shpjeguese veçanërisht të fortë duke theksuar se, pranimi i rregullave të BE-së, para hyrjes drejtohet nga përdorimi i kondicionalitetit, që nënkupton se BE-ja, i vendos rregullat e veta si kushte që vendi aplikant duhet të përmbush për të marr shpërblime (“*Schimmelfennig and Sedelmeier*”, 2004; “*Dimitrova*”, 2002; “*Grabbe*”, 2003; “*Vachudova*”, 2005). Në vitet e fundit dhe më së shpeshti duke u fokusuar në Politikën Evropiane të Fqinjësisë, shkollar të tjerë kanë sugjeruar të shikohet roli i rrjeteve ndërqeveritare në zëvendësimin e formave hierarkike të transferimit të politikave (“*Lavenex*”, 2004-2008; “*Lavenex and Wichmann*”, 2009). Zgjerimi i rrjeteve të vendosura trans-qeveritare të BE-së, drejt vendeve fqinje propozohet si një formë alternative e qeverisjes së jashtme, duke qenë se qeverisja e jashtme nëpërmjet kondicionalitetit presupozon ekzistencën e një *acquis* të qartë mbikombëtar dhe iniciativave të jashtme të forta mbi pjesën e bashkimit, dy faktorë që nuk janë domosdoshmërisht në vend në *acquis* e drejtësisë dhe të punëve të brendshme si dhe të Politikës Evropiane të Fqinjësisë, respektivisht. Rrjeti i zgjeruar i qeverisjes mund të bëhet si rrjedhim, “një mjet për transferimin e politikave nëpërmjet mjeteve më të buta” (“*Lavenex and Wichmann*”, 2009: 83). Argumenti që ky shkrim përkrah është që kjo formë e qeverisjes në rrjet është me rëndësi në aspektin Rajonal të Ballkanit Perëndimor, më tepër si një plotësim sesa si zëvendësim i qeverisjes së BE-së, nëpërmjet kondicionalitetit.

Në kundërshtim me Politikën Evropiane të Fqinjësisë, e cila ka qenë fusha kryesore e interesit të kësaj dege të kërkimeve studimore, në Ballkanin Perëndimor BE-ja, gëzon mjetin që buron nga iniciativa e anëtarësimit tëardhshëm. Bën një dallim kryesor në ndërveprimet e përditshme nëse BE-ja, bashkëpunon apo jo në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme me një vend të tretë, që ka perspektivën në të ardhmen për t’u bërë një shtet anëtar.² Vendosja e

² Confidential interview, European Commission, DG Justice, Liberty, Security, 18 March 2009.

bashkëpunimeve operacionale midis BE-së, dhe Ballkanit Perëndimor trajtohet si një kërkesë thelbësore e Procesit të Stabilizim Asocimit dhe si një parakusht për t'u përgatitur për anëtarësim, një pikë që reflektohet qartë në strategjinë e jashtme të JHA (shtylla drejtësia dhe punët e brendshme), së BE-së, të dhjetorit 2005. "Perspektiva e zgjerimit është një mënyrë efektive për t'u përshtatur me standardet e BE-së, në punët e brendshme dhe të drejtësisë në vendet candidate dhe ato me perspektivë Evropiane, së bashku me adoptimin dhe implementimin e *acquis* dhe nëpërmjet përmirësimeve në kontaktet dhe bashkëpunimin operacional" ("*Council of the European Union*", 2005 b: 6).

Rëndësia e qeverisjes nëpërmjet kondicionalitetit...

Kur Bashkimi Evropian inicioi strategjinë e vet rajonale të para anëtarësimit, përcaktoi se kondicionaliteti duhet të jetë "betoni i procesit të Asocim Stabilizimit" ("*Council of the European Union*", 2001 b: Point III). Duke i dhënë statusin e kandidatëve potencial për anëtarësim në BE. BE-ja, mbajti qëndrimin që progresi hap pas hapi i secilit shtet të Ballkanit Perëndimor në procesin drejt anëtarësimit eventual në BE, duhet të varet nga performanca respektive në kuadër të përmbushjes së kriteve të Kopenhagën 1993, dhe kushteve të tjera specifike për çdo shtet. Deri më tani, vetëm Kroacia dhe Maqedonia kanë mundur të ngrijnë statusin e tyre nga vende candidate potenciale, në vende të mirëfillta në qershor 2004 dhe dhjetor 2005, respektivisht. Në gjykimet e veta nëse një vend kualifikohet ose jo për fazën e ardhshme të procesit të anëtarësimit në BE. BE-ja, ka vendosur theksin në çështjen e dorëzimit të të dyshuarve për krime lufte Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë (ICTY). Përsëri, disa kërkesa që lidhen me JHA, si reforma e sistemit policor dhe drejtësisë dhe lufta kundër kimit të organizuar janë radhitur lart në vlerësimet e BE. Mungesa e progresit në reformat e policisë, për shembull ishte një nga arsyet pse BE-ja, u frenua disa vite nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit me Bosnjë-Hercegovinën. Këto marrëveshje janë në qendër të Procesit të Stabilizim Asocimit dhe të vendosjes së një marrëdhënie formale kontraktuale me bashkimin, mbi periudhën tranzitore të konsideruar të nevojshme për të adoptuar standarde dhe rregullat bazë të BE-së (Pippan, 2004: 233-38). Çdo MSA përfshin një titull specifik mbi punët e brendshme dhe të sigurisë, i cili nxit bashkëpunime intensive mbi çështje si: parandalimi dhe

luftimi i krimit dhe aktivitetëve të tjera ilegale, migracioni dhe azili, pastrimi i parave dhe drogave të paligjshme.³

Në kuadër të perspektivës evropiane, shtetet e Ballkanit Perëndimor priten të vijnë më afër *acquis* së rëndësishme dhe të fillojnë programe gjithëpërfshirëse reformash për policinë, sistemet e gardave të kufijve dhe drejtësisë midis të tjerave. BE-ja, ka inkurajuar shtetet e Ballkanit Perëndimor për të vendosur një theks të veçantë mbi katër fusha prioritare (policia, rendi publik dhe krimi i organizuar, menaxhimi i integruar i kufijve, reforma gjyqësore, azili dhe migrimi), dhe të luftoj të gjitha format e trafikimit, veçanërisht të qenieve njerëzore, si dhe kontrabanda e lëndëve narkotike, armëve dhe mallrave (*“Council of the European Union”, 2003 a: 2*). Prioritetet specifike në fushë kanë ndryshuar, gjithsesi, dhe janë përcaktuar për çdo shtet në të ashtuquajturat Partneritet Evropiane ose Aderimi.⁴ Progresi i vendeve drejt implementimit të prioritetet afatmesme dhe afatgjata monitorohet nga Komisioni Evropian, i cili publikon rezultatet në raportet vjetore të Progresit. Këshilli i BE-së, mund të japë gjuhë të mëtejshme në mbledhjen e Ministrive BE-Ballkan Perëndimor mbi JHA, zakonisht i zhvilluar një herë në vit, dhe nëpërmjet iniciativave të rotacionit presidencial. Në nëntor 2002, BE ftoi Ballkanin Perëndimor në një Konferencë mbi Krimin e Organizuar në Evropën Juglindore. Formulimi i Londonit vendosi: “një angazhim të përbashkët” për të mposhtur krimin e organizuar në Evropën Juglindore dhe angazhoi Ballkanin Perëndimor të dorëzonte individualisht rekorde të arritjeve (*“The London Statement”, 2002*). Fokusi mbi krimin e organizuar u forcua më tej në Samitin e Selanikut në qershor 2003, midis BE-Ballkanit Perëndimor, nën titullin “Lufta ndaj Krimit të Organizuar, Bashkëpunimi në Çështje të tjera të Punëve të Brendshme dhe Drejtësisë”, agjenda e Selanikut theksoi rëndësinë e çështjeve të JHA në marrëdhëniet BE-Ballkanin Perëndimor. Dokumenti “nxitit vendet e rajonit të përcaktojnë dhe implementojnë masa të mëtejshme vepruese specifike për t’u kryer në të ardhmen e afërt” (*“Council of the European Union”, 2003 c*). Këto masa vepruese u prezantuan nga çdo shtet i Ballkanit Perëndimor në

³ Maqedonia ishte e para që nënshkroi këtë lloj marrëveshje, në prill të 2001, e ndjekur shpejt nga Kroacia (tetor 2001). Shtetet e tjera nënshkruan MSA-në, jo para shumë kohësh (Shqipëria në qershor 2006, Mali i Zi në tetor 2007, Serbia në prill 2008 dhe Bosnje-Hercegovina në qershor, 2008).

⁴ Nisur nga statusi i tyre i avancuar, Kroacisë dhe Maqedonisë iu dhanë Partneritet e Aderimit. Diferenca kryesore midis një Partneriteti Evropian dhe atij Aderimi është që ky i fundit strukturrohet sipas krerëve të *acquis* dhe jo sipas prioritetëve afatshkurtra dhe afatmesme.

mbledhjet pasardhëse ministrave të JHA, e para e të cilave u mbajt në nëntor të 2003. Nën presidencën e Austrisë në 2006, Këshilli miratoi një “Letër vepruese për përmirësimin e bashkëpunimit mbi krimin e organizuar, korrupsionin, emigrimin e paligjshëm dhe kundër terrorizmit, midis BE, Ballkanit Perëndimor dhe vendeve të rëndësishme të ENP” (“*Council of the European Union*”, 2006: a). Në total shtatë prioritete, u nënvizuan për vitet e ardhshme duke filluar nga përmirësimi i bashkëpunimit rajonal midis zbatimit të ligjit, prokurorëve dhe gjyqësorit mbi luftën më efektive ndaj korrupsionit, në koordinimin më efektiv të donatorëve (IBID).

Qasja e kondicionalitetit e BE-së, në rajon është forcuar duke lidhur iniciativën e udhëtimeve pa viza me performancën e shteteve në frenimin e emigrimit të paligjshëm dhe luftës kundër krimit të organizuar.⁵ Liberalizimi i vizave ka qenë një nga çështjet më të spikatura në marrëdhëniet BE-Ballkan Perëndimor, duke qenë se politikat e vizave të BE-së, kanë kufizuar mundësitë për qytetarët e Ballkanit Perëndimor për të udhëtuar në vendet e BE-së (ICG 2005). BE-ja, ka lejuar këto vende për të hyrë në skemën e liberalizimit të vizave dhe ka lidhur udhëtimin pa viza me përmbushjen e disa kushteve, duke përfshirë edhe masat kundër kalimit të paligjshëm të kufijve dhe përhapjes së dokumenteve të udhëtimit të falsifikuara, nënshkrimin e marrëveshjeve të ripranimit, një regjim i vizave i përafuar etj. Në shtator 2008, Serbia, Mali i Zi, Shqipëria, Bosnja-Hercegovina dhe Maqedonia nënshkruan marrëveshjet e KE-së, për lehtësimin e vizave dhe ripranimin të cilat i siguruan këtyre shteteve me mundësi më të lehtësuara udhëtimit për disa kategori të popullsisë, në këmbim të një bashkëpunimi më të ngushtë për kthimin e emigrantëve të paligjshëm dhe azilkërkuesve të refuzuar (“*Trauner and Kruse*”, 2008). Pasi këto marrëveshje hyn në fuqi në janar 2008, BE-ja, i lejoi këto shtete të hynin në “dialogë për liberalizimin e vizave”, të cilat janë bazuar në mirëkuptimin që nëse disa vende plotësojnë parametrat e tyre specifik të parashikuara në udhërrëfyesin e vendit ato do të lëvizin gradualisht drejt liberalizimit të vizave.

Standardet e vendosura në udhërrëfyes janë gjithëpërfshirëse dhe sipas një zyrtari të Këshillit, janë në disa raste aq gjithëpërfshirëse (dhe në disa raste me përjashtim edhe më gjithëpërfshirëse), sesa kushtet e aderimit të JHA-së, të cilat

5. Të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor me përjashtim të Kroacisë u vendosën në listën negative të vizave të Rregullave të Këshillit 539/2001 të BE (Council of the European Union, 2001:a).

vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore kanë qenë të detyruara t'i përmbushin në zgjerimet e 2004 dhe 2007.⁶ Në nëntor 2009, Këshilli i JHA-së, votoi në favor për heqjen e kërkesave për vizë për qytetarët e Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë me pasaportat biometrike, duke filluar nga 19 dhjetori 2009, por vendosi për t'i mbajtur ato për Shqipërinë dhe Bosnjë- Hercegovinën për arsye të progresit të pamjaftueshëm në përmbushjen e standardeve. Në një përpjekje për të adresuar zhgënjimin e këtyre dy shteteve, Këshilli nënvizoi që do ta trajtonte një propozim eventual për viza për Shqipërinë dhe Bosnjë-Hercegovinën në komision si “çështje urgjente” (“*Council of the European Union*”, 2009 b:17).

...dhe nëpërmjet qeverisjes në rrjet

Në lidhje me qeverisjen në rrjet, BE ka kërkuar nga njëra anë të nxis bashkëpunimin operacional dhe rrjetëzimin midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, dhe nga ana tjetër të krijoj struktura të bashkëpunimit rajonal dhe rrjete brenda rajonit. BE inkurajoi këto shtete të zhvillonin forma të bashkëpunimit rajonal midis agjencive të zbatimit të ligjit që janë të krahasueshme me ndërveprimet e brendshme të bashkimit të përshkruara në literaturën akademike si “ndërqeverisja intence” (“*Wallace*”, 2000; “*Lavenex and Wallace*”, 2005). Për sa i përket qeverisjes në rrjet midis BE dhe Ballkanit Perëndimor, BE është fokusuar në krijimin e rrjeteve të informacionit dhe zbatimit.⁷ Organet dhe agjencitë e specializuara të BE, si Zyra e Policisë Evropiane Europol (“*Occhipinti*”, 2003), u ngarkuan me detyrën e shkëmbimit dhe analizës së informacionit dhe të lehtësonin bashkëpunimin operacional ndërkufitar midis autoriteteve të zbatimit të ligjit midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor. Europol ka zhvilluar një strategji të Ballkanit Perëndimor dhe ka negociuar marrëveshje bashkëpunimi, që rregullojnë marrjen dhe transmetimin e informacionit të Europol dhe përmbylljen e

6. *Intervistë konfidenciale, Grupi i Punës së Këshillit mbi Ballkanin Perëndimor, 17 mars 2009. Zyrtarët e quajten shembullin e ngritjes së agjencive anti-korrupsion, një çështje ku BE-ja, shikohet si më strikte në dialogun e liberalizimit të vizave me Ballkanin Perëndimor, sesa në negociatat e anëtarësimit me vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Është e rëndësishme të nënvizohet, gjithësesi, që ky shembull nuk mund të riverifikohet në një dokument analize, duke qenë se udhërrëfyeset trajtohen si dokumente konfidenciale dhe nuk janë të disponueshme për publikun.*

7. *Bazuar në punën e mëparshme të Anne-Marie Slaughter, Lavenex dhe Wichmann dallojnë ndërmjet tre tipeve të rrjeteve, konkretisht rrjete informative, rrjete zbatuese dhe rrjete rregulluese (Lavenex and Wichmann 2009: 85-86).*

marrëveshjeve të konfidencialitetit. Duke shkëmbyer informacion dhe data midis Europolit dhe këtyre shteteve, BE-ja ka shpresuar të përmirësoj botëkuptimin e tyre mbi rrjetet e krimit të organizuar, në Ballkan dhe të shtoj mjetet e tyre në luftën kundër tyre. (*“Delevic”, 2007: 87*).

Europol nënshkroi një marrëveshje strategjike bashkëpunimi me Shqipërinë, Bosnjë- Hercegovinën, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë dhe një marrëveshje operacionale me Kroacinë (*“Council of the European Union”, 2008: 8*).⁸ Europol së bashku me agjencinë e BE-së, për menaxhimin e kufijve *“Frontex”*, ka zhvilluar gjithashtu vlerësime të rreziqeve dhe ka vendosur rrugë risqesh, ku duhet të operojnë skuadra të përbashkëta investigimi (*“Council of the European Union”, 2006 a:10*). Kanalet e informacionit u forcuan më tej duke i kërkuar oficerëve ndërlihdës të shteteve anëtare të gjenin informacion mbi vlerësimet e kërcënimeve nga Europol, mbi krimin e organizuar në Ballkan. Ky rrjet i oficerëve të migracionit, të cilin BE e filloi ta ndërtonte në 2001 (si rrjetin e parë të tillë mbarë botëror), supozohej të vendoste kontakte më të afërta me autoritetet e rajonit “me qëllim të kontribuonte në parandalimin dhe luftimin e migracionit të paligjshëm, kthimin e tyre dhe menaxhimin e migracionit të ligjshëm” (*“Council of the European Union”, 2004*). Në 2003, Këshilli sugjeroi të zgjerohej agjenda e oficerëve ndërlihdës për të mbuluar gjithë zonën e krimit të organizuar (*“Council of the European Union”, 2003 b: 5*).

Rrjetet zbatuese nxisin objektivin e asistimit në implementimin e standardeve të adoptuara dhe ligjit të BE (*“Lavenex dhe Wichmann”, 2009: 86*). Krijimi llojeve të tilla rrjeteve ka qenë një pjesë thelbësore e përgatitjes së vendeve për anëtarësimin në BE. Seminare dhe workshope, mbi luftën kundër krimit të organizuar u mbajtën në çdo vend dhe u financuan nga programi i Shkëmbimit të Asistencës Teknike dhe Informacionit (TAIEX). Programi TAIEX, u dizajnuar për t’iu përgjigjur problemeve që shfaqeshin në moment të fundit si rritja e trafikimit të qenieve njerëzore, dhe mbulonte një sërë fushash si krimi financiar, korrupsioni, trafikimi dhe masat e pastrimit të parave. Objektivat e përgjithshme të aktiviteteve në rrjet të programit TAIEX, ishin të përmirësonin standardet e policisë në rajon, të forconin aspektet rajonale të policisë në luftën kundër krimit të organizuar, të përmirësonin menaxhimin e kufijve dhe të reformonin gjyqësorin. (*Montanaro-Jankovski 2005: 21*). Si kontrast,

8. *Marrëveshjet strategjike rregullojnë shkëmbimin e informacionit operacional dhe teknik por përjashtojnë shkëmbimin e të dhënave përsonale.*

programi Asistenca e Komunitetit të BE-së, për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilitet (CARDS), i zëvendësuar në 2007 nga Instrumenti i Para Aderimit (IPA), u dizajnuar për të mbështetur proceset afatgjata të ndërtimit të institucioneve dhe forcimin e kapaciteteve të zbatimit të ligjit.

Fusha e drejtësisë dhe të punëve të brendshme, së bashku me asistencën ekonomike, kanë qenë fushat kryesore të financimit të BE-së, për para Aderimit. Nga 840 milion të lëshuara në 2008, për komponentin e IPA për ndihmën për tranzicionin dhe ndërtimin institucional, 33% u dizajnuar për “të nxitur qeverisjen, të inkurajoj reformat administrative dhe gjyqësore, të forcoj shtetin e së drejtës, mbështes luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të promovoj të drejtat e njeriut, të mbrojnë minoritetet dhe të zhvilloj shoqërinë civile” (“*Commission of the European Communities*”, 2008: 6).

Kur BE lançoi strategjinë e vet të para Aderimit për Ballkanin Perëndimor, përcaktoi se çdo shtet mund të hyj në BE me meritat e veta, ndërkaq përafrimi me Evropën duhet të shkoj “dorë më dorë”, duke nxitur bashkërendimin dhe bashkëpunimin rajonal (shih *Zagreb Summit*, 2000). Kjo kërkesë kishte lidhje gjithashtu me fushën politike të drejtësisë dhe punëve të brendshme, ku një mungesë e strukturave rajonale dhe rrjeteve për të prekur probleme të përbashkëta ndërkufitare u konsiderua një problem kryesor. BE-ja, vendosi veçanërisht një theks të fortë mbi përmirësimin e bashkëpunimit operacional midis këtyre shteteve. Në projektin “Konventa e Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore”, e zbatuar në gjashtë mujorin e parë të 2006, shtetet pjesëmarrëse Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Rumania dhe Serbia miratoi një konventë shumëpalëshe për përmirësimin e bashkëpunimit policor në rajon. Qëllimi zyrtar ishte të “adoptoheshin standardet Schengen në Evropën Juglindore nëpërmjet përfundimit të një konvente shumëpalëshe” (“*Council of the European Union*”, 2006: b). Konventa drejton shkëmbimin e informacionit, prezanton forma të reja të bashkëpunimit ndërkufitar si ndjekja ndërkufitare dhe sqaron një mori masash si shkëmbimi i të dhënave të ADN-së, ose vendosjen e skuadrave të përbashkëta investigative. Gjithashtu, BE-ja mbështeti vendosjen e Iniciativës Bashkëpunuese të Evropës Juglindore (SECI), Qendrën Rajonale për luftën ndaj krimit ndërkufitar, një bashkëpunim operativ midis autoriteteve kufitare dhe policore në rajon. E vendosur në Bukuresht, Qendra e SECI duhet të ndihmoj në luftimin e krimit ndërkufitar në rajon dhe sipas *Hubert Pirker*, ish-drejtuesi i Iniciativës së Paktit të Stabilitetit kundër Krimit të Organizuar, është

përpyekja për të ngritur “një Europol për Evropën Juglindore”⁹. I ngjashëm me Europol, çështjet e qendrës së SECI-së, analizojnë dhe raportojnë dhe koordinojnë operacione rajonale brenda kuadrit të shtatë Taks Forcave të specializuara që adresojnë çështjet e drogës dhe të trafikimit njerëzor, automjetet e vjedhura, kontrabandën dhe mashtrimin në kufi, krimin financiar dhe kompjuterik, terrorizmin dhe container security. Qendra asistohet gjatë veprimeve opracionale nga një rrjet prokurorësh të quajtur Grupi Këshillues i Prokurorëve të Evropës Juglindore (SEEPAG), të cilët kërkojnë të lehtësojnë bashkëpunimin gjyqësor dhe shkëmbimin e informacionit në investigimet e krimit ndërkufitar. Ministrat e Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme të BE-së, i caktuan Europol-it si detyrë të bashkëpunonte me qendrën e SECI (shiko “*Council of the European Union*”, 2006;c).

Përfundime

Ky shkrim ka vlerësuar strategjinë e BE-së, dhe paketën e politikës së jashtme për angazhimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, në arritjen e qëllimeve të veta në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme, duke u fokusuar mbi modelet e qeverisjes së jashtme në fushën e politikave (qeverisja nëpërmjet kondicionalitetit përkundrejt qeverisjes në rrjet). Kjo analizë ka treguar se, fusha politike e drejtësisë dhe punëve të brendshme u bë një fushë kryesore e bashkëpunimit midis BE-së dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor. Forcimi i agjencive të zbatimit të ligjit dhe institucioneve shtetërore dhe vendosja e policëve, policëve kufitar dhe sistemeve gjyqësore efektive dhe llogaridhënëse shikohet si një çelës për avancimin e përgjithshëm të prosperitetit dhe stabilitetit në rajon. Për të angazhuar shtetet e Ballkanit Perëndimor, në arritjen e objektivave të brendshme të sigurisë BE-ja, ka zhvilluar një strategji të dyfishtë. Duke i dhënë perspektivën e anëtarësimit në të ardhmen, BE ka iniciuar një proces para aderimi, i cili synon jo vetëm në forcimin e bashkëpunimit në fushën e JHA-së, por edhe në transformimin

⁹ Huber Pirker e ka bërë këtë deklaratë në konferencën “*Eine Strategie der Stärkung der Freiheit, der Sicherheit und des Rechts für die Menschen in der EU*”, e organizuar nga Renner Institut dhe IDM më 13 tetor 2006, Vienë. Qendra e SECI operon ngushtësisht me Inicativën e Paktit të Stabilitetit kundër Krimit të Organizuar (SPOC), që synon të forcoj kapacitetet rajonale për të luftuar krimin e organizuar ndërkufitar. Për të siguruar përkohësisht asistencë ligjore në qendrën SECI në Bukuresht, sekretariati i SPOC u integrua në departamentin ligjor në janar të 2008.

gradual të këtyre shteteve në shtete anëtare të zhvilluara, të afta për të marr pjesë në fushën evropiane të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Procesi i Stabilizim Asocimit është udhëhequr nga një strategji e transferimit të rregullave të bazuara në anëtarësimin e kushtëzuar. Kjo qasje është forcuar duke transformuar iniciativën e liberalizimit të vizave në një rrugë të fuqishme të mjetit të jashtëm për të inkurajuar reformat në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme të vendit në Ballkanin Perëndimor (shiko gjithashtu *Trauner, 2009*). Pavarësisht rëndësisë së saj, qeverisja në rrjet ka shërbyer më shumë si një plotësim dhe jo zëvendësim i qeverisjes së BE-së, nëpërmjet kondicionalitetit. Duke bërë kështu, BE-ja është përqendruar jo vetëm në forcimin e bashkëpunimit të vet operacional me Ballkanin Perëndimor, por edhe në mbështetjen aktive të iniciativave ose strukturave (si qendra e SECI) që synon nxitjen e bashkëpunimit operacional me Evropën Juglindore.

Bibliografia

Commission of the European Communities. Enlargement Strategy and Main Challenges 2008-2009. Brussels: COM, 674 final, 5 November, 2008.

Council of the European Union. Council Regulation (EC) No 539/2001 of 15 March 2001 listening the third countries whose nationals must be in possession of visas when crossing the external borders and those whose nationals are exempt from that requirement. Brussels: Official Journal, L 81, 21. 3. 2001a.

Council of the European Union. Press Release, 2356th Council Meeting. Luxembourg: General Affairs, PRES/O1/226, 11-12 June, 2001 b.

Council of the European Union. EU-Western Balkans Forum. Joint Conclusions. Brussels: 15578/03, 28 November, 2003 a.

Council of the European Union. EU Action against Organised Crime in the Western Balkans. Brussels: 14810/03, 2 December, 2003 b.

Council of the European Union. The Thessaloniki agenda for the Western Balkans: Moving towards European Integration. Thessaloniki:Western Balkans – General Affairs and External Relations Council (GAERC) Conclusions, 16 June, 2003 c.

Council of the European Union. Council Regulation (EC) No 377/2004 of 19 February 2004 on the creation of an immigration liaison officers network. Brussels: Official Journal L 64 02 March, 2004.

Council of the European Union. Stabilisation and Association Agreement between the European Communities and their Member States, of the one part, and the Republic of Croatia, of the other part. Brussels: Official Journal L 26/3, 28 January, 2005 a.

Council of the European Union. A strategy for the External Action of JHA: Global Freedom, Security and Justice. Brussels: 15446/05, 6 December, 2005 b.

Council of the European Union. Action Oriented Paper on Improving Cooperation, on organised Crime, Corruption, Illegal Immigration and Counter-terrorism, between the EU, Western Balkans and relevant ENP countries. Brussels: 9272/06, 12 May, 2006 a.

Council of the European Union. Police Cooperation Convention for South East Europe. Vienna: Press Release of the Presidency of the European Union. 3-4 May 2006, b.

Council of the European Union. Presidency Statement on the EU-Western Balkan Forum on Justice and Home Affairs. Tirana, 16 and 17 November, 2006 c.

Council of the European Union. Second report on the state of implementation by Member States and EU bodies of Action-Oriented Paper on Improving Cooperation on Organised Crime, Corruption, Illegal Immigration and Counter-terrorism, between the EU, the Western Balkans and relevant ENP countries. Brussels: 8827/1/08, 8 May, 2008.

Council of the European Union. Council Regulation amending Regulation (EC) No 539/2001 listing the third countries whose nationals must be in possession of visas when crossing the external borders and those whose nationals are exempt from that requirement. Brussels: 2009/0104(CNS), 24 November, 2009 a.

Council of the European Union. Press Release. 2979th Council meeting Justice and Home Affairs. Brussels: 16883/1/09 REV 1, 30 November and 1 December, 2009 b.

Delevic, Milica. "Regional cooperation in the Western Balkans". *Chaillot Paper* No 104, July 2007, Paris, 2007.

Dimitrova, Antoaneta. „Enlargement, institution-building and the EU’s administrative capacity building.” *West European Politics* 25(4), 2002: 171–98.

Grabbe, Heather. Europeanization Goes East: Power and Uncertainty in the EU Accession Process. In: Featherstone, K. and C. M. Radaelli. (eds.). *The Politics of Europeanization*. Oxford: Oxford University Press, 2003: 303–31.

ICG. "EU Visas and the Western Balkans". *Europe Report* Nr 168 – 29 November 2005, Brussels, 2005.

Lavenex, Sandra. „EU external governance in ‘wider Europe’.” *Journal of European Public Policy* 11(4), 2004: 680–700.

Lavenex, Sandra. "A Governance Perspective on the European Neighbourhood: Integration beyond Conditionality?" *Journal of European Public Policy* 15(6), 2008: 938-55.

Lavenex, Sandra and William Wallace. Justice and Home Affairs In: Wallace, Helen, and William Wallace, Mark. A. Pollack. (eds.). *Policy-Making in the European Union. Fifth Edition.* Oxford: Oxford University Press, 2005.

Lavenex, Sandra and Nicole Wichmann. "The external governance of EU internal security". *Journal of European Integration* 31(1), 2009: 83-102.

Montanaro-Jankovski, Lucia. Good cops, bad mobs? EU policies to fight trans-national organised crime in the Western Balkans. "EPC Issue Paper No. 40, Brussels, 2005".

Occhipinti, John D. *The politics of EU police cooperation: toward a European FBI*, Boulder CO: Lynne Rienner, 2003.

Pippan, Christian. "The Rocky Road to Europe: The EU's Stabilisation and

Association Process for the Western Balkans and the Principle of Conditionality". *European Foreign Affairs Review* 9, 2004: 219-45.

Schimmelfennig, Frank and Ulrich Sedelmeier. "Governance by conditionality: EU rule transfer to the candidate countries of Central and Eastern Europe". *Journal of European Public Policy* 11(4), 2004: 661-79.

Sedelmeier, Ulrich. "Europeanisation in new member and candidate status". *Living Reviews in European Governance* 1(3), 2006. <<http://europeangovernance.livingreviews.org/Articles/ireg-2006-3/>>

The London Statement. "Defeating Organised Crime in South Eastern Europe". 25 November 2002, London, 2002.

Trauner, Florian. "From membership conditionality to policy conditionality: EU external governance in South Eastern Europe". *Journal of European Public Policy* 16(5), 2009: 774-90.

Trauner, Florian and Imke Kruse. "EC Visa Facilitation and Readmission Agreements: A New Standard EU Foreign Policy Tool?" *European Journal of Migration and Law* 10(4), 2008: 411-38.

Vachudova, Milada Anna. *Europe Undivided: Democracy, Leverage and Integration after Communism.* Oxford: Oxford University Press, 2005.

Wallace, Helen. "The policy process. A moving pendulum". In: Wallace Helen and William Wallace. (eds.). *Policy-making in the European Union.* Oxford: Oxford University Press, 2000: pp. 39-64.

Zagreb Summit. "The Declaration of the Zagreb Summit". Zagreb, 24 November, 2000.

Nga: Genti Bardhi

ASPEKTE TË SIGURISË RAJONALE NË BALLKAN DHE IMPAKTI MBI BASHKËPUNIMIN RAJONAL

1. Hyrje

Rajoni i Ballkanit mbart me vete një histori të gjatë konfliktesh dhe problemesh, histori kjo e cila është e lidhur ngushtë me dhunë politike, konflikte etnike dhe fragmentim shtetesh. Për arsye të konflikteve të shpeshta shprehja gjeografike “Ballkani Perëndimor”, ka marrë me kalimin e kohës një konotacion aq negativ, sa që gjithnjë e më shumë vende përpiqen të identifikohen si pjesë e Evropës Juglindore e cila përfshin Ballkanin Perëndimor, por bën të mundur shmangien e përdorimit të termit “Ballkani Perëndimor”.

Gjatë këtij studimi do të hidhet një vështrim mbi rajonin e Ballkanit Perëndimor duke analizuar disa nga çështjet e Sigurisë Rajonale. Në qendër të studimit do të jenë disa nga çështjet e sigurisë, të cilat jo vetëm prekin secilin prej shteteve të rajonit më vete, por dhe i lidhin këto shtete me njëri-tjetrin, duke bërë në këtë mënyrë të pashmangshme bashkëpunimin mes shteteve për të zgjidhur çështjet e sigurisë. Një theks i veçantë do ti vihet “sigurtizimit”¹ dhe “regjionalizimit”, të çështjeve të Sigurisë Kombëtare të secilit prej shteteve. Çështje historike, politike dhe ekonomike të çdo shteti në rajon, shpesh janë lidhur në mënyrë të tillë, sa që ata i kalojnë kufijtë shtetërorë dhe ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në shtetet e tjera në rajon duke ndikuar në Sigurinë Rajonale. Për këtë arsye marrëdhëniet mes shteteve të rajonit shkojnë përtej marrëdhënieve normale mes fqinjësh. Shpeshherë çështjet historike, ekonomike dhe politike “siguritizohen”, me qëllim mbështetjen e qëllimeve dhe objektivave të caktuara kombëtarë dhe politike.

1. Ky term i shqipëruar nga anglishtja (securitization) dhe që do të diskutohet më në detaj gjatë studimit, ka të bëjë me veshjen e çështjeve të ndryshme teknike (siç janë historia, ekonomia etj) me petkun e sigurisë, gjë e cila i politizon këto çështje dhe i nxjerr ato jashtë diskutimeve të ekspertëve duke i futur në vorbullën e politikës dhe diskutimeve politike.

Teza e hedhur në këtë artikull është që në këto kushte, bashkëpunimi rajonal mbetet një domosdoshmëri për të zgjidhur disa nga çështjet më sensitive të rajonit. Probleme të përbashkëta kërkojnë zgjidhje të përbashkëta dhe zgjidhje të përbashkëta në rajonin e Ballkanit Perëndimor mund të realizohen vetëm nëpërmjet bashkëpunimit rajonal.

Duke qenë se, analizimi i të gjitha çështjeve të Sigurisë në Rajon në një artikull të tillë është i pamundur, në të do të shihen vetëm dy aspekte të sigurisë. Ndikimi i historisë në mjedisin e sotshëm të Sigurisë në Rajon si dhe problematika e lidhur me çështjet sociale (etnike) të rajonit.

Pyetjet të cilat do të trajtohen në këtë studim janë:

- Si janë të lidhur me njëri-tjetrin shtetet e Ballkanit Perëndimor, nga këndvështrimi i sigurisë dhe çfarë natyre ka kjo lidhje?

- Cila është rëndësia e bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor dhe cilat janë shanset dhe sfidat e tij?

Për t'u përgjigjur këtyre pyetjeve, do të na duhet të ballafaqohemi me pikëpamjen që bashkëpunimi rRajonal në "fuçinë e barutit të Evropës" (Ballkanin) është i pamundur.

Me qëllim bërjen e një analize sa më të saktë, rajoni do të ndahet në dy sektorë bërthamat e të cilëve janë pikat e nxehta të rajonit siç janë Kosova dhe Bosnja-Hercegovina. Këto shtete përbëjnë ende pikat e nxehta jo vetëm për rajonin, por dhe për organizma ndërkombëtare siç janë NATO dhe BE, të cilat i sigurojnë këto dy shtete. Problematika e këtyre dy vendeve është e lidhur në mënyrë të pandashme me vendet e tjera të rajonit dhe ndikon në sigurinë e të tërë rajonit.

2. Aspekte teorike të Sigurisë Rajonale

Qëllimi i këtij kapitulli është t'i ofrojë lexuesit një vështrim të shkurtër mbi aspektet teorike të Sigurisë në përgjithësi dhe asaj Rajonale në veçanti.

Në lidhje me konceptin e Sigurisë, është e rëndësishme të theksohet që në këndvështrimin horizontal siguria nuk shihet më vetëm nga aspekti i mbrojtjes klasike të territorit të vendit, por përveç çështjeve ushtarake, siguria trajton një sërë çështjesh siç janë çështjet ekonomike, shoqërore, mjedisore. Sipas *David Baldwin* "Security is what you make of it"². Siguria nuk mund të jetë asnjëherë absolute, por duke pasur të bëjë me perceptimin

2. *Barry Buzan*. "People, States, and Fear: An Agenda for International Security Studies in the Post-Cold War Era", edicioni 2-të (New-York: Harvester Wheatsheaf, 2004).

e publikut, ajo është një vlerë e cila mund të manipulohet. Megjithëse siguria ka të bëjë me çështje të cilat parashtrohen si rrezik ekzistencial për shtetin, klasifikimi i një çështje si çështje e sigurisë është tepër e vështirë. Shpesh çështje të ndryshme bëhen pjesë e sigurisë jo vetëm për arsye se ekziston një rrezik i vërtetë por thjeshtë dhe vetëm se, një çështje prezantohet si e tillë. Çështje të ndryshme siç janë për shembull fakte historike, shpesh përdoren nga politika për të përmbushur objektiva të ndryshme politike duke dalë kështu nga dora e ekspertëve. Një gjë e tillë çon në manipulimin apo keqpërdorimin e fakteve historike dhe i fut këto çështje në vorbullën e politikës duke i “siguritizuar”³ çështjet në fjalë.

Mbas kolapsit të komunizmit në Ballkan, ka ndodhur një ndryshim radikal. Siguria e Rajonit tashmë ka të bëjë jo vetëm me Sigurinë Ushtarake, por dhe me çështje të tilla si siç janë nacionalizmi, çështjet ekonomike, kulturore, politike etj.⁴ Për këtë arsye domosdoshmërisht duhen analizuar jo vetëm çështjet ushtarake, por siguria duhet trajtuar në kuptimin e saj më të gjerë siç janë çështjet sociale, ekonomike apo historike.

Dimensioni vertikal i sigurisë fokusohet në aktorët e Marrëdhënive Ndërkombëtare dhe fillon nga individi, shteti deri tek organizatat rajonale dhe suprarajonale. Është për t'u theksuar se, megjithëqë një pjesë e madhe e studimeve sot fokusohet tek shteti si aktor qendror, ai nuk është aktori i vetëm. Në mjedisin post-modern të sigurisë shteti-komb, është i lidhur në një rrjet organizmesh ndërkombëtar dhe supranacionale dhe për shtetet nuk është më e mundur të veprojnë në mënyrë të pavarur, pa përlogaritur dhe kalkuluar veprimet e aktorëve të tjerë dhe sidomos të shteteve të tjera brenda rajonit. Ndërthurja e shteteve në mjedisin rajonal po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme për sigurinë e tyre.

Për të analizuar bashkëpunimin rajonal dhe Sigurinë Rajonale, është e nevojshme të analizohen marrëdhëniet mes shteteve. Duke e kuptuar qartë rajonin si dhe problemet e përbashkëta të shteteve që përbëjnë rajonin, është më e thjeshtë për shtetet të afrohen me njëri-tjetrin me qëllim zgjidhjen e problemeve të përbashkëta. Me qëllim analizimin e shteteve në përbërje të rajonit dhe problemeve të përbashkëta të sigurisë, *Bary Buzan* përdor “*Teorinë e Kompleksit të Sigurisë Rajonale*”, e cila

3. “Siguritizimi” ka të bëjë me përfshirjen e çështjeve të pastra teknike në vorbullën politike duke i trajtuar ato si çështje të Sigurisë Kombëtare.

4. *Stefano Bianchini*. The cultural scope of Balkan security. In *Mediterranean security. I përpunuar nga Blank, Stephen. J. (Carlisle: Strategic Studies Institute, 1999).*

sugjeron një skemë analitike për të sqaruar se si çështjet e sigurisë lidhen së bashku në një formacion rajonal.⁵ Në pamundësi për të trajtuar dhe për të përdorur gjerësisht teorinë e kompleksit të Sigurisë Rajonale, ky koncept vetëm do të përmendet pa hyrë në detaj.

Në kapitullin e ardhshëm do të lëvizim nga një nivel teorik në një nivel më praktik. Çështjet konkrete që shqetësojnë rajonin do të jenë në themel të këtij artikulli, duke e vënë theksin në domosdoshmërinë dhe nevojën e Bashkëpunimit Rajonal. Sigurisht që nuk do të jetë e mundur të preket i tërë spektri i problematikave të sigurisë për arsye të kufizimit të artikullit. Për këtë arsye fokusi do të mbetet vetëm tek çështjet historike dhe ato etnike.

3. Çështje të Sigurisë Rajonale

3.1 E kaluara e komplikuar e Ballkanit Perëndimor

• Sigurizimi i historisë së rajonit

Me qëllim që të kuptohet qartë lidhja midis vendeve të Ballkanit, në çështjet e sigurisë fillimisht është e nevojshme të hidhet një sy në historinë e tij dhe pasojat që historia ka lënë në marrëdhëniet e sotme mes shteteve. Pa njohur historinë, është e pamundur të analizohet rajoni. Gjatë një vështrimi në histori mund të shohim se, vetë historia e rajonit po “sigurizohet” gjithnjë e më tepër. Një shembull i mirë për këtë janë diskutimet mbi historinë e Kosovës. Gjatë diskutimeve mbi Kosovën, historianët serbë dhe shqiptarë kanë bërë debate të mëdha mbi çështjen nëse dhe përse Kosova është tokë shqiptare apo serbe. Shpesh këto debate nuk janë trajtuar nga ekspertë dhe mbi baza shkencore, por interesa të veçanta shtetërore kanë ndikuar analizat e ekspertëve duke e nxjerrë historinë nga analet e profesionalizmit dhe duke e bërë atë pjesë të debateve politike duke çuar në “sigurizimin” e historisë.

Si shembull i “sigurizimit” të historisë dhe keqpërdorimit të saj nga shtete të ndryshme në rajon mund të merret “beteja e Fushë-Kosovës”, e cila nga njëra anë përdoret nga historianët serbë për të vërtetuar që Kosova, është tokë serbe duke e quajtur këtë betejë një betejë serbe, ndërsa nga ana tjetër

5. Ole, Waever. Aberystwyth, Paris, Copenhagen - New ‘Schools’ in Security Theory and their Origins between Core and Periphery, *Studim i paraqitur në takimin vjetor të shoqatës ndërkombëtare të studimeve (International Studies Association), Montreal, mars 17-20, 2004.*

shqiptarët nuk e quajnë këtë një argument duke thënë që me të vërtetë kjo betejë është drejtuar nga një car serb, por kjo nuk vërteton asgjë për arsye se, pjesëmarrësit në betejë ishin të kombësive të ndryshme dhe si pasojë kjo nuk ishte një betejë serbe, por bashkim i disa kombësive për të shpëtuar nga pushtimi otoman.

Gjithashtu shpesh here analistët arrijnë në konkluzione të dobëta për arsye të mungesës së njohurive historike. Shpeshherë përdoren terma si për shembull “Shqipëria e madhe” të cilat pranojnë lehtë nga publiku pa pasur nevojë as edhe për një shpjegim. Por harrohet se terma të tillë mund të jenë konstruktive artificiale dhe jo realiste të krijuara vetëm për të impresionuar lexuesin. Duke u rikthyer në shembullin e “Shqipërisë së madhe”, nëse përpiqemi të trajtojmë në mënyrë realiste domethënien e kësaj shprehje do të shohim që “Shqipëria e madhe”, është territori i katër vilajeteve shqiptare të Perandorisë Osmane. Nëse hedhim një sy në situatën politike të rajonit të Ballkanit sot, mund të shihet qartazi që nuk ka baza reale për të mbështetur idenë që një “Shqipëri e madhe”, mund të rikrijohet për faktorë të ndryshëm politikë. Shprehje të tilla pa themel hidhen me qëllim përmbushjen e qëllimeve të caktuara politike si dhe për të krijuar efekte të caktuara tek audienca. Sidoqoftë, lidhja mes politikës dhe historisë në Ballkan është aq e forte, sa që pa njohur historinë është e pamundur analizimi i politikës aktuale.

• Një vështrim mbi historinë e rajonit

Le të hedhim një sy shkurtimisht mbi historinë e Ballkanit.

Ballkani Perëndimor karakterizohet nga një histori e gjatë bashkëjetese dhe konfliktesh, ndarje dhe bashkim kufijsh, dashurie dhe urrejtje, histori kjo e cila ka lënë pasojat e saja dhe në kohët tona.

Zotërimi i Perandorisë Osmane për një kohë të gjatë në rajon, çoi në formatimin e traditave politike, ekonomike dhe kulturore të rajonit. Pas një bashkëjetese të detyruar për një kohë të gjatë si pasojë e pushtimit osman, në rajon u vendos një kulturë e ngjashme e cila mund të shihet lehtësisht dhe sot në ngjashmëritë e traditave, ushqimit dhe zakoneve të vendeve të rajonit.

Menjëherë pas çlirimit nga sundimi otoman (në fillim të shekullit të XX), mes shteteve të Ballkanit u zhvillua një dinamikë tepër e fortë për sa i përket sigurisë. Në vitin 1912-1913 Ballkani ishte “pajisur” me luftërat e tij ballkanike, të cilat sollën krijimin e kufijve

dhe shteteve të reja. Shtetet e sapolindura krijuan një sistem të pavarur të balancimit të fuqive duke krijuar koalicione të qarta mes tyre dhe duke përcaktuar armiqhtë.⁶

Kjo gjë nuk zgjati shumë pasi menjëherë pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, Ballkani ishte përsëri pjesë e luftës së fuqive dhe kufijtë ndryshuan dhe një herë duke krijuar kufij të rinj. Krijimi i Jugosllavisë detyroi shtete të ndryshme të jetonin përsëri së bashku deri në fillimin e viteve '90 pavarësisht aspiratave të tyre kombëtare. Në fillim të viteve '90 nacionalizmi dominoi dhe një herë Ballkanin, duke sjellë rreziqe dhe kërcënime të reja në rajon.

Historia ka lënë gjurmë të thella në strukturën etnike dhe sociale, të shteteve të ndryshme të rajonit. Krijimi i kufijve të vendosur artificialisht (si për shembull krijimi i Jugosllavisë), si dhe copëzimi i shteteve (si në shembullin e Shqipërisë ku është lënë jashtë kufijve të saj një pjesë e mirë e territoreve shqiptare), ka çuar në një situatë të komplikuar etnike në rajon duke ndikuar së tepërmi Sigurinë e Rajonit.

3.2 Problemet etnike dhe rajoni

Siç u vu në dukje në kapitullin e dytë gjatë historisë së Ballkanit, popullsia me kombësi të ndryshme u detyruan të jetojnë së bashku. Shtete të ndryshme si për shembull Shqipëria u zvogëluan në kufij shumë më të ngushtë se rrënjët e tyre etnike.⁷ Për pasojë një pjesë e madhe e shteteve të Ballkanit Perëndimor, sot përbëhen nga një komunitet i përzier qytetarësh me kombësi të ndryshme siç janë serbë, kroatë, shqiptarë si dhe grupe të tjera më të vogla etnike.

Një ndër problemet më të mëdha për Ballkanin Perëndimor, ka qenë dhe vazhdon të jetë ende nacionalizmi. Nacionalizmi në Ballkan është përdorur si një enë bosh, e cila është mbushur nga ata të cilët shohin interesat e tyre në pavarësinë politike dhe të drejtat e shteteve.⁸

6. *Barry Buzan and Ole Waever. Regions and Powers. The structure of international Security. Në Cambridge Studies in International Relations 91. (Cambridge: Cambridge University Press, 2003), 380.*

7. *Barry Buzan and Ole Waever. Regions and Powers. The structure of international Security. Në Cambridge Studies in International Relations 91. (Cambridge: Cambridge University Press, 2003), 385*

Shih gjithashtu Noel Malcolm: Kosovo: A Short History. (New-York: New-York University Press, 1998).

8. *Susan L. Woodward. Ballkan tragedy. Chaos and dissolution after the cold war. (Washington DC: The Brookings Institution, 1995), 223.*

Përrjashtimi i etnive të tjera në rajon ka qenë po aq i rëndësishëm sa përrshirja e tyre në komunitetet përrkatëse. Në periudhën postkomuniste, përrjashtimi ishte një ndër çështjet kryesore. Etnitë e tjera janë parë si “ata të cilët nuk i përrkasin komunitetit tonë” si “të huajt” pavarësisht se, në kushtet ballkanike etni të ndryshme ishin të detyruar të jetonin së bashku.⁹ Mosbesimi dhe frika përrkundrejt “të tjerëve” rritej çdo ditë.

Në anën tjetër, përrshirja shihej më tepër si asimilim se sa gjetja e të përrbashkëtave dhe bashkëjetesa midis kombësive të ndryshme. E gjithë kjo çoi në një përrplasje kombësish të cilat kishin jetuar së bashku përr një sërë dekadash dhe shekujsh të tërë. Sigurizimi i çështjeve sociale dhe etnike mbetet ende dhe sot një nga çështjet më të mëdha të rajonit. Më poshtë do të analizohen lidhjet e shteteve të rajonit me njëri-tjetrin, përr sa i përrket sigurisë si dhe probleme të ndryshme që kanë të bëjnë me etnitë në rajon. Përr një analizë sa më të mire rajoni do të ndahet sipas lidhjes mes shteteve në dy sektorë (apo nënrajone).

3.2.1 Analizimi i sektorit të parë (Shqipëri, Maqedoni, Kosovë, Serbi dhe Mal i Zi)

Njëri nga dy sektorët e Ballkanit përrbëhet nga pesë shtete të cilat janë: Shqipëri, Maqedoni, Kosovë, Serbi dhe Mal i Zi. Problematika në fushën e sigurisë e secilit prej këtyre shteteve lidhet ngushtë me problematikën e shteteve të tjerë brenda sektorit. Aktori kryesor në këtë nën-rajon është Serbia dhe një ndër problematikat kryesore ka të bëjë me minoritetet shqiptare.

Serbia është një ndër shtetet më të rëndësishme të rajonit, jo vetëm përr arsye se ka popullsinë më të madhe,¹⁰ por gjithashtu sepse çështjet e Sigurisë Kombëtare të Serbisë, përrfshijnë në mënyrë të drejtpërrdrejtë të tëra vendet e rajonit. Ky shtet vazhdon ta shohë ende veten si pasardhësi i Jugosllavisë.¹¹ Në fillim të viteve ‘90 Serbia, nisi tre luftëra nga të cilat nuk fitoi asnjë prej tyre.¹² Konfliktet në Kroaci më 1991, Bosnjë në vitin 1992 dhe ai i Kosovës në vitin 1999, forcuan ndjenjat nacionaliste

9. *Po aty.*

10. *Popullsia e rajonit është: Serbia 7.5 mn, Kroacia 4.4 mn, Shqipëria 3.2 mn, Kosova 2.5 mn, FYROM 2.05 mn, BIH 4 mn, Mali i Zi 620.000.*

11. *Jugosllavia përrbëhej nga pothuaj të tëra shtetet e Ballkanit Perëndimor, plus Slloveninë, minus Shqipërinë*

12. *Stephen White and Judy Batt and Paul G. Luis, ed. Central and East European Politics. (Houndmills: Palgrave Macmillan, 2007), 81.*

jo vetëm në Serbi, por dhe mes serbëve të cilët jetonin në të tërë rajonin.¹³ Serbia shpejt zbuloi që minoritetet serbe në rajon, mund të ishin një mjet i fuqishëm për imponimin e politikave Serbe në shtetet e tjera të rajonit. Në 2009 Serbia lëshoi një ligj të ri, i cili merret me diasporën serbe. Ky ligj futi një term të ri në jurisprudencën serbe. Termi “*serbët e rajonit*”, do të përdorej tashmë gjithnjë e më tepër në terminologjinë ligjore dhe politike të Serbisë. Nocioni “*serbët e rajonit*”, në ligjin e ri sjell për institucionet serbe detyrime të reja përkundrejt popullatës serbe në rajon.

Sipas Ministrisë së Punëve të Jashtme të Serbisë nocioni “*serbët e rajonit*”: “...është, nga njëra anë, reflektimi i përpjekjes së Republikës së Serbisë për të identifikuar dhe **përcaktuar gjithë problemet në lidhje me qytetarët e tij dhe qytetarët me origjinë serbe, që jetojnë në shtetet e huaja, duke marr parasysh diversitetin lidhur me origjinën historike dhe situatën e tyre në vendin që jetojnë. Nga njëra anë, është rezultat i njohjes së situatës së vërtetë në terren, kryesisht në republikën e ish-Jugosllavisë dhe fqinjët pas shpërbërjes së dhunshme të ish-Jugosllavisë dhe shfaqjes së shteteve të reja dhe kufijve dhe si rrjedhim i kësaj, ndryshimeve demografike, të cilat sollën shumë **serbë në një situatë komplet të re përkundrejt, së pari dhe më së shumti, shteteve të sapo krijuara**”¹⁴**

Ligji i ri tregon që Serbia ka vënë re rolin tepër të rëndësishëm të minoriteteve në rajon. Rasti i Mitrovicës së Veriut tregon se, sa e prekshme është **Kosova** përkundrejt politikave serbe pas përdorimit të popullsisë serbe në këtë vend. Kjo popullsi është i vetmi mjet që i ka mbetur Serbisë, për të bllokuar qeverinë kosovare të shtrijë influencën e saj në të tërë territorin e vendit.

Kosova sipas politikës Serbe, përfaqëson për Serbinë një pjesë të rëndësishme të historisë së këtij vendi. Siç u përmend dhe më lart “beteja e Fushë-Kosovës”, quhet si një pjesë tepër e rëndësishme e historisë serbe për vetë faktin se Serbia e përdor këtë betejë për të vërtetuar se, Kosova është historikisht pjesë e Serbisë.¹⁵

13. Wolfgang Petritsch. Sovereignty, State failure and humanitarian intervention. The international community in the Post-Yugoslav space. *Crossroads. The Macedonian Foreign policy journal*, Vol. 1 nr:4, prill-tetor 2008, 155-162.

14. Shih faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Serbisë <http://www.mfa.gov.rs/Diasporaframe.htm>.

15. Ky fakt historik po diskutohet gjerësisht jo më nga historianët, por nga politikanët. Shembulli tregon se si shpesh herë historia e rajonit siguritizohet.

Largimi i përhershëm i Kosovës nga territori i Serbisë u pa nga popullsia serbe si një katastrofë kombëtare.¹⁶ Pavarësisht njohjes nga një pjesë e madhe shtetesh (deri tani rreth 80),¹⁷ si dhe shpalljes së ligjshme të pavarësisë nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë¹⁸, Serbia nuk pranon të njohë pavarësinë e këtij vendi duke pasur dhe një Ministri e cila merret me çështjet e Kosovës¹⁹.

Me gjithë faktin që Kosova është “de facto” një shtet i pavarur, ndikimi i Serbisë në situatën e sigurisë së këtij vendi është ende jashtëzakonisht e madhe. Veriu i Mitrovicës është populluar nga shtetas me kombësi serbe, të cilët refuzojnë ta njohin Republikën e Kosovës krijojnë struktura paralele të drejtuara nga Republika e Serbisë (siç janë për shembull gjykatat paralele²⁰). Ngjarjet e fundit në Mitrovicën e Veriut, tregojnë influencën e këtyre minoriteteve në situatën e Sigurisë së Rajonit. Nëpërmjet popullsisë serbe që jeton në vend Republika e Serbisë, përpiqet të imponojë politikat e saj përkundrejt republikës së Kosovës si dhe komunitetit ndërkombëtar të përfshirë në ruajtjen e sigurisë dhe rendit në Kosovë.

Gjithashtu në të kaluarën shpesh Serbia ka dhënë “rekomandime”, për popullsinë serbe në Kosovë duke i treguar asaj se si të silltet. Për shembull, ndër komentet e Republikës së Serbisë mbi “Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, mbi administratën e OKB-së në Kosovë” Serbia shkruan si më poshtë: “*Autoritetet e Republikës së Serbisë nuk mund të inkurajojnë popullsinë serbe në provincë të marrin pjesë në këto zgjedhje...*”²¹ Me fjalë të tjera Serbia i rekomandon popullsisë serbe të bojkotojë zgjedhjet parlamentare të vitit 2007. Për pasojë, pjesëmarrja e popullsisë serbe në zgjedhjet e 2007 ishte tepër e ulët, gjë që ndikoi në mënyrë të drejtpërdrejtë në pjesëmarrjen

16. Stephen White and Judy Batt and Paul GLuis, ed. Central and East European Politics. (Houndmills: Palgrave Macmillan, 2007), 82.

17. Shih faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës të Kosovës, <http://www.mfa-ks.net/?page=1,4,623>.

18. Shih vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. “Accordance with international law of the unilateral declaration of independence in respect of Kosovo Jurisdiction”. (Hagë: Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, 22 korrik, 2010).

19. Ministria e Kosovës dhe Metohisë.

20. Shih faqen e internetit të OSBE. Paralel structures in Kosovo 2006-2007, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. <http://www.osce.org/kosovo/24618>.

21. Shih Comments on the Report of the UN Secretary-General on the United Nations Interim Administration in Kosovo (1 September – 30 November 2007), Beograd: Republika e Serbisë, Ministria për Kosovën dhe Metohinë, 2007. <http://www.mfa.gov.rs/Foreinframe.htm>.

e serbëve në vendimarrjen politike të Kosovës si dhe vendosjen e veriut të Mitrovicës nën kontrollin e Prishtinës.

Mbështetja e **Shqipërisë** për Kosovën është gjithashtu e njohur. Për shkak të popullsisë shqiptare që jeton në Kosovë, Shqipëria ka qenë e lidhur gjithmonë me çështjen e Kosovës. Gjatë periudhës post-komuniste kërcënimet e jashtme kryesore të Shqipërisë kishin të bënin me çështjen e Kosovës. Tensionet mes Tiranës dhe Beogradit, kanë qenë të shpeshta dhe të rrepta. Ndërkohë që politikanët e Beogradit akuzonin Tiranën se, mbështeste lëvizjen e pavarësisë të Kosovës dhe se kërkonte të krijonte “Shqipërinë e madhe”, zyrtarët shqiptarë kritikonin dhunimet e të Drejtave të Njeriut nga ana e qeverisë së Serbisë, por njëkohësisht përjashtonin mundësinë e ndryshimit me dhunë të kufijve të rajonit.²² Duke qenë se Shqipëria ishte një ndër shtetet e para që njohu pavarësinë e njëanshme të Kosovës, marrëdhëniet e saj me Serbinë u përkeqësuan akoma dhe më tepër duke çuar në ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike mes dy shteteve për disa muaj. Çështja e Kosovës mbetet ende subjekt debatesh midis dy vendeve dhe me sa duket kjo situatë do të vazhdojë për një kohë të gjatë.

Përpyekjet e Serbisë për të hedhur idenë se Shqipëria, po përpiqet të krijojë “Shqipërinë e madhe” janë të mirë menduara. Dhe përse nuk ka arsye të besojmë në qëllimet e Shqipërisë për krijimin e një “Shqipërie të madhe”, kjo ide në vetvete mund të krijojë tepër probleme duke hapur vatra të reja konflikti në Maqedoni, luginën e Preshevës, Mal të Zi etj.

Maqedonia për Shqipërinë është një aktor tepër i rëndësishëm në rajon për vetë faktin se, një pjesë e madhe e popullsisë që jeton atje është shqiptare. Për këtë arsye elitat shqiptare përpiqen të afrohen sa me tepër me Republikën e Maqedonisë. Pavarësisht kësaj mund të vihet re se, Maqedonia shpesh është ndjerë e rrezikuar qoftë nga Kosova, ashtu dhe nga Shqipëria duke besuar në mundësinë e krijimit së “Shqipërisë së madhe”.²³ Duket se ndonjëherë terma të tillë të ndërtuara artificialisht dhe pa baza funksionojnë dhe rritin mosbesimin mes shteteve.

Konflikti i vitit 2001, rrezikoi balancat e dobëta etnike në Republikën Federale të Maqedonisë.

22. *Fabian Schmidt*. Albania: Precarious Stability. In *Brassey's Central and East European Security Yearbook 2002 Edition*. Përpunuar nga *Daniel N. Nelson dhe Ustina Markus*, (Virginia: *Brassey's Inc.* 2002), 230-231.

23. *Othon Anastasakis dhe Vanesa Bojicic-Dzelilovic*. Balkan regional cooperation & European Integration. (London: *The Hellenic Observatory of The London School of Economics and Political Science*, July 2002), 67-69.

Falë angazhimit ndërkombëtar më 13 gusht 2001, u bë e mundur firmosja e “Marrëveshjes së Ohrit”, marrëveshje kjo e cila ndryshoi drejtimin e politikës së Shkupit, duke i dhënë fund konfliktit mes shqiptarëve dhe maqedonasve, si dhe vuri bazat për reformat kushtetuese duke përmirësuar të drejtat e shqiptarëve etnike, që jetojnë në këtë vend. Këto reforma kushtetuese sollën përmirësime në të drejtat civile të popullsisë shqiptare duke përfshirë dhënien e një statusi zyrtar të gjuhës shqipe, integrimin e popullsisë shqiptare në jetën politike të vendit, si dhe heqjen dhe ndryshimin e preambulës së kushtetutës, e cila dukej se i trajtonte pjesëtarët e minoriteteve si qytetarë të dorës së dytë.²⁴

Autorë të ndryshëm siç janë Radovan Vukadovic argumentojnë se, për shkak të popullsisë shqiptare që jeton aty, Maqedonia është e ekspozuar kundrejt zhvillimeve të ndryshme në Kosovë. Sipas këtyre autorëve çdo përshkallëzim i tensioneve në Kosovë mund të transferohet në Maqedoni.²⁵ Në këtë kontekst, nëse analizojmë situatën në Maqedoni mund të shohim se me të vërtetë shqiptarët etnikë në Maqedoni, janë një pjesë tepër e rëndësishme e politikës së Maqedonisë si dhe kontaktet me Kosovën dhe Shqipërinë, janë tepër të rëndësishme për ta. Sigurisht që nuk mund të mohohet që Shqipëria apo Kosova mund të influencojë fraksionet shqiptare në Maqedoni, por influenca nuk është e njëanshme dhe aq më tepër negative. Dhe Maqedonia mund të ketë një ndikim të caktuar tek shtetet në fjalë nëpërmjet faktorit shqiptar. Për shembull si pasojë e ndikimit të faktorit shqiptar, Shqipëria ishte një ndër shtetet e para që njohu këtë shtet në 1992.²⁶ Gjithashtu gjatë krizës së vitit 2001 në Maqedoni, Shqipërisë i duhej të ishte tepër aktive në qetësimin e “Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare” të drejtuar nga Ali Ahmeti, duke mbajtur kontakte të ngushta me drejtuesit e UÇK.

Maqedonia ka gjithashtu marrëdhënie të ngushta me Serbinë, për shkak të vartësive ekonomike që ekzistojnë midis këtyre shteteve. Këto marrëdhëniet mes tyre u ndërprejnë për një periudhë të caktuar kohore pas njohjes së Kosovës nga ana e Maqedonisë. Siç shihet deri tani ekziston një lidhje e fortë midis Kosovës, Serbisë, Shqipërisë dhe Maqedonisë.

24. 2001-2002 Strategic Panorama. *Grupi i punës nr. 5/01*, (Madrid: Spanish Institute for Strategic Studies, 2002), 72.

25. Radovan Vukadovic. Former Yugoslavia: International efforts to link peace, stability and democracy, *Në Democratic consolidation in Eastern Europe. International and transnational factors, Vol. 2, Përpunuar nga Jan Zielonka and Alex Pravda*, (New York: Oxford University Press, 2001), 441-442.

26. Misha Glenny. The Macedonian Question. *In International perspectives on the Yugoslav Conflict. Përpunuar nga Danchev, Alex and Halverson, Thomas*, (New York: St. Martins press INC, 1996), 136.

Si Maqedonia, dhe **Mali i Zi** është një shtet multi-etnik por ndryshe nga pjesa tjetër e Ballkanit, minoritetet në këtë vend duket të jenë integruar mirë. Për arsye të historisë të gjatë dhe të përbashkët me Serbinë në këtë vend jeton një numër i madh minoritetesh serbe, gjë e cila i bën të domosdoshme marrëdhëniet mes Serbisë dhe Malit të Zi.

Distancimi i lider-shqiptit politik të Malit të Zi nga politika serbe, nisi në vitin 1990, kur nacionalisti radikal Slobodan Miloshevic filloi fushatën e tij nacionaliste në Jugosllavi. Aktiviteti diplomatik i këtij shteti u intensifikua veçanërisht, duke filluar nga viti 2000 ku filloi të dukej qartë shpëputja me Serbinë.

Problemi më kryesor i Malit të Zi, pas shpëputjes nga Serbia nëpërmjet referendumit të 21 majit 2006, është shmangia e alienizimit²⁷, të personave që votuan kundër pavarësisë së Malit të Zi.²⁸

Pjesa më e madhe e kundërshtarëve të pavarësisë përbëhej nga popullsia serbe, gjë e cila e bën problemin më të vështirë për ta zgjidhur sepse si në rastin e Mitrovicës së Veriut, kjo popullsi mund të ndikohet lehtësisht nga Beogradi. Popullsia serbe dhe në këtë vend shihet si një mjet për të plotësuar interesat e Serbisë. Integrimi i popullsisë serbe e cila jeton në Malin e Zi, varet krejtësisht nga politikat serbe.

Si në rastin e shteteve të tjera të rajonit pas njohjes së republikës së Kosovës, qeveria e Serbisë shpalli ambasadorin malazez në Beograd “persona non grata”. Sidoqoftë Mali i Zi vendosi të mos përgjigjet me të njëjtën masë për ambasadorin serb në Malin e Zi, dhe as të marrë masa të cilat mund ta përkeqësonin dhe më shumë situatën.²⁹ Kjo ishte një lëvizje e zgjuar nga ana e Malit të Zi për vetë faktin se, përkeqësimi i situatës me Serbinë mund të çonte në përkeqësimin e situatës brenda vendit për arsye se, do të acaronte popullsinë serbe në Malin e Zi.

3.2.2 Analizimi i sektorit të dytë (Serbia, Bosnje-Hercegovina, Kroacia)

Sektori i dytë i rajonit është krijuar nga tri shtete të cilët janë Bosnje-Hercegovina e cila është pika e nxehtë e rajonit, Serbia dhe Kroacia.

27. *Distancimi nga jeta politike dhe shteti i Malit të Zi.*

28. *Stephen White dhe Judy Batt and Paul G.Luis, Central and East European Politics. (Houndmills: Palgrave Macmillan, 2007), 81.*

29. *Shih faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Malit të Zi: <http://www.mip.gov.me/en/index.php/Bilateral-Relations/republic-of-serbia.html>.*

Ndërkohë që nënrajoni i parë ishte ndërtuar pak a shumë përreth pakicave shqiptare, në sektorin e dytë një rol të rëndësishëm luan Bosnje- Hercegovina si dhe minoritetet që jetojnë në këtë vend.

Bosnja-Hercegovina mbetet ende një ndër dy shtetet më problematike në rajon. Këtij shteti nga viti 1995-1999, i duhej të kalonte dy luftëra mes tre kombësive nga të cilat ai përbëhet. Kompozimi etnik i vendit (48% boshnjakë, 37% serbë, 14% kroatë dhe 1% të tjerë) e bën zgjidhjen e konfliktit tepër të vështirë. Konflikti kroato-mysliman si dhe konflikti mes forcave kroato-myslimane dhe atyre serbe, mundi të zbutej vetëm pas marrëveshjes së Dayton-it³⁰, i cili vuri bazat për ndërtimin e shtetit të ri të Bosnjës-Hercegovinës.³¹

Çmimi për kompromisin e Dayton-it, ishte një kushtetutë e cila fatkeqësisht thelloi dhe më tepër ndarjet etnike mes boshnjakëve (myslimanët sllav), kroatëve dhe serbëve duke njohur dy njësi shtetërore: Republika Srpska një njësi e cila është pothuajse shtet më vete të cilën serbët synojnë ta bashkojnë me Serbinë, si dhe federata e Bosnjës-Hercegovinës e formuar nën presion mes boshnjakëve dhe kroatëve (të cilët në atë kohë kanë luftuar njëri-tjetrin).³²

Siç shihet sot Bosnja, është një shtet i komplikuar federal dhe multi-etnik, i cili po mbahet nën vëzhgimin e Komunitetit Evropian nëpërmjet autoriteteve të veçanta civil të përfaqësuesve të lartë të BE-së. Me qëllim parandalimin e interesave kombëtare të kroatëve dhe serbëve, për copëzimin e Bosnjës dhe bashkimin e copëzave të shkëputura me Serbinë apo Kroacinë, marrëveshja e Dayton-it, i lejonte përfaqësuesit e lartë të drejta dhe kompetenca të jashtëzakonshme në bazë të të cilave “zyrtari i pazgjedhur i Bashkimit Evropian” ka fuqinë të ndërhyjë në mënyrë të drejtpërdrejtë në politikën e brendshme të vendit, të amendojë apo rrëzojë ligje të miratuara nga Presidenti. Autorë të ndryshëm e quajnë këtë “a quasi-dictatorial set-up” (një sistem pothuajse diktatorial).³³ Për

30. Qëllimi kryesor i marrëveshjes ishte nxitja e paqes dhe stabilitetit në Bosnje dhe Hercegovinë, dhe mbajtja e balancave rajonale brenda dhe rreth ish-Republikës së Jugosllavisë (art. V, annex I-B), e parë nga një perspektivë rajonale.

31. Radovan Vukadovic. Former Yugoslavia: International efforts to link peace, stability and democracy, në Democratic consolidation in Eastern Europe. *International and transnational factors*, Vol. 2, Përpunuar nga Jan Zielonka and Alex Pravda, (New York: Oxford University Press, 2001), 441

32. Stephen White and Judy Batt dhe Paul G.Luis, Central and East European Politics. (Houndmills: Palgrave Macmillan, 2007), 79.

33. Wolfgang Petritsch. Sovereignty, State failure and humanitarian intervention. The international community in the Post-Yugoslav space. *Crossroads. The Macedonian Foreign policy journal*, Vol. 1 Nr.4, prill-tetor 2008, 160.

shkak të minoriteteve interesat e dy vendeve fqinje (Kroacisë dhe Serbisë), janë të mëdha.

Pas rënies së regjimit të Milosheviçit, pushtetin në **Serbi** e mori politikani nacionalist Vojislav Kostunica³⁴, i cili kishte qenë avokat i Serbisë së madhe që në ditët e para të luftës së Bosnjës.³⁵ Kostunica ndoqi politikën e vendosjes së marrëdhënieve të drejtpërdrejta mes Serbisë dhe Republikës Srpska gjë e cila mund të shihet dhe në marrëveshjen e nxitur nga Kostunica mbi “marrëdhëniet e veçanta paralele ndërmjet Republikës së Serbisë dhe Republika Srpska”³⁶

Megjithëse këto lidhje të drejtpërdrejta lejohen nga marrëveshja e Dayton-it, ato mund t'i lejojnë Serbisë të influencojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë Republika Srpska duke bërë në çdo kohë eminent rrezikun e shkëputjes së Republikës Srpska dhe bashkimin e saj me Republikën e Serbisë. Ide të tilla janë tepër të rrezikshme dhe mund të sjellin me vete konflikte të reja në rajon. (Popullsia serbe apo shqiptare e cila jeton në pjesë të tjera të rajonit mund të ngrihet dhe të kërkojë të njëjtën gjë).

Përqasja e **Kroacisë** nga Bosnja-Hercegovina në dy dekadat e fundit ka ndryshuar në mënyrë radikale në vartësi të drejtuesve të vendit. Në dekadën e parë pas pavarësisë së Kroacisë ky vend i drejtuar nga nacionalisti radikal *Franjo Tudjman*, i cili kishte akumuluar fuqi pothuajse absolute hyri në rrugën e izolimit dhe nacionalizmit duke refuzuar të bashkëpunonte me Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës. *Tudjman* vendosi një lidhje të drejtpërdrejtë me ekstremistët kroatë të Bosnjës, si dhe arriti t'i mbështesë ata financiarisht dhe politikisht nëpërmjet “Unionit Demokratik Kroat të Bosnje-Hercegovinës” të krijuar që në vitin 1990. Kjo ishte një parti bijë e “Unionit Demokratik Kroat”, të krijuar dhe drejtuar nga *Tudjman* më 1989.³⁷

Për arsye të qëndrimit në fuqi të *Tudjman* dhe partisë së tij, influenca e nacionalizmit në Kroaci deri më 1999, ishte e

34. Kostunica ishte një President tepër i rëndësishëm në politikën serbe deri në vitin 2008. Ai ka qenë Presidenti i Republikës nga 2000 deri më 2003. Gjithashtu ai ka shërbyer në dy legjislatura si Kryeministër i Serbisë, nga 2004 deri 2007 dhe nga 2007 deri më 2008.

35. John R. Wise. Bosnia-Herzegovina: Security and other dilemmas. Në Brassey's Central and East European Security Yearbook 2002 Edition, (Virginia: Brassey's Inc. 2002), 257-258.

36. Shih faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Serbisë <http://www.mfa.gov.rs/Foreinframe.htm>.

37. Jed C. Snyder. Croatia after Tudjman, Finally to the West?. Në Brassey's Central and East European Security Yearbook 2002 Edition, (Virginia: Brassey's Inc. 2002), 299-323.

jashtëzakonshme. Shtylla kryesore e bashkëpunimit bilateral me Bosnjën ishte lidhja e drejtpërdrejtë me etninë kroate nëpërmjet “Unionit Demokratik Kroat të Bosnje- Hercegovinës”. Mbështetja financiare dhe politike e Kroacisë përkundrejt Bosnje-Hercegovinës shtyhej nga ndjenjat nacionaliste të kroatëve të Bosnjës.³⁸

Pas vdekjes së *Tudjman* në dhjetor 1999, situata në Kroaci ndryshoi në mënyrë radikale. Presidenti i ri kroat Stipe Mesic, ndryshoi drejtimin e politikës kroate përkundrejt Bosnjës, dhe shkatërroi ambicidet separatiste duke denoncuar vazhdimisht çdo ide për ndryshim territorial.

Në vitin 2000, ai vendosi që ndihma për kroatët e Bosnjës, të kalonte vetëm nëpërmjet institucioneve boshnjake si dhe do të bëhej transparente për komunitetin ndërkombëtar.³⁹ Si rezultat i këtij veprimi, mbështetja politike dhe financiare e CDU-së, së Bosnjës u ndërpre gjë e cila ndryshoi dinamikën mes Kroacisë dhe kroatëve të Bosnjës, duke qetësuar ndjenjat nacionaliste në Kroaci dhe Bosnje dhe duke kontribuar në Sigurinë Rajonale.

Dy politikat të ndjekura nga Kroacia në dy dekadat e fundit,⁴⁰ tregojnë qartë impaktin që kanë politikat nacionaliste apo konstruktiviste të një shteti në rajon në një shtet tjetër.

Siç shihet çështjet etnike në Ballkan po “siguritizohen” gjithnjë e më shumë. Etnitë janë mjete të fuqishme të cilat shpesh përdoren me efikasitet për të arritur qëllime të caktuara duke përkeqësuar situatën në rajon. Por në rast de-siguritizimit të këtyre çështjeve, etnitë mund të ndihmojnë në tejkalimin e problemeve të rajonit duke nxitur bashkëpunimin mes shteteve.

4. Bashkëpunimi Rajonal, një mjet për të përmirësuar sigurinë?

Siç u diskutua më lart problemet e sigurisë së shteteve të cilat përbëjnë Ballkanin Perëndimor, janë të lidhura me njëri-tjetrin në mënyrë të tillë që nuk mund të zgjidhen apo analizohen të ndara nga njëri-tjetri. Siguritizimi i historisë dhe shpërndarja

38. *Po aty.*

39. *John R. Wise.* Bosnia-Herzegovina: Security and other dilemmas. Në *Brassey's Central and East European Security Yearbook 2002 Edition*, (*Virginia: Brassey's Inc. 2002*), 257.

40. *Politikat e Tudjman (mbështetja e minoriteteve ekstremiste dhe idetë e tyre separatiste) vs. politikave të Mesic (mbështetja e minoriteteve Kroate, por vetëm nëpërmjet kanaleve kombëtarë dhe në mënyrë transparente përkundrejt komunitetit ndërkombëtar).*

e etnive të ndryshme në tërë rajonin si pasojë e historisë së përbashkët apo ndryshimit të kufijve e vërtetojnë këtë. Ajo për të cilën rajoni ka nevojë, është stabiliteti, mirëkuptimi mes shteteve si dhe rritja e dialogut politik.

Shtetet e rajonit kanë mësuar nga e kaluara. Ata e kanë kuptuar që problemet e sigurisë, të cilat prekin secilin prej tyre i kalojnë kufijtë shtetërorë dhe për këtë arsye këto probleme nuk mund të zgjidhen nga secili prej shteteve më vete, apo nëpërmjet një bashkëpunimi dypalësh. Në këto kushte bashkëpunimi rajonal është një mjet i domosdoshëm, jo vetëm për të zbutur problemet në fushën e sigurisë, por dhe për të përmbushur disa prej objektivave të përbashkëta të secilit prej vendeve që janë anëtarësimi në NATO apo BE.

Ndërhyrja e aktorëve ndërkombëtarë siç janë BE dhe NATO, deri tani ka qenë e nevojshme dhe e domosdoshme për përmirësimin e sigurisë në rajon. Këta aktorë ende vazhdojnë të jenë prezent në rajon dhe tashmë kanë të qartë natyrën e përbashkët të problemeve të rajonit. Duke qenë se probleme të përbashkëta kërkojnë zgjidhje të përbashkët, faktori ndërkombëtar është përpjekur të nxisë gjithnjë e më tepër bashkëpunimin rajonal në Ballkanin Perëndimor.

Sipas Komisionit Evropian,⁴¹ bashkëpunimi rajonal në Ballkanin Perëndimor është:

4. Përbërësi kryesor i stabilitetit;
5. Një faktor kyç i cili nxit pajtimin mes shteteve, fqinjësinë e mirë dhe marrëdhëniet e mira politike;
6. Një mjet i cili ndihmon në tejkalimin e nacionalizmit dhe intolerancës, si dhe nxit mirëkuptimin dhe dialogun politik në rajon.

Nëse do të analizonim situatën në rajon si dhe nismat rajonale të ndërmarra deri më sot, vihet re se bashkëpunimi rajonal, është nxitur në shumicën e rasteve nga aktorë të jashtëm dhe se i vetmi forum rajonal i iniciuar nga aktorë brenda rajonit i cili është "*South East European Cooperation Process*",⁴² dështoi gjatë krizës së Kosovës⁴³.

Gjithashtu dhe pasardhësi i Paktit të Stabilitetit, *Regional Cooperation Council*, i cili drejtohet gjithnjë e më tepër nga vetë

41. Regional cooperation in the western Balkans. A policy priority for the European Union. *Zyra për publikime zyrtare të Komunitetit Evropian, Belgjikë: Komisioni Evropian, 2006, 4.*

42. SEECP është një forum rajonal i krijuar nga një iniciativë Greko-Bullgare dhe fokusohet në disa çështje thelbësore për rajonin siç janë zhvillim ekonomik, çështje sociale, luftimi i kimit të organizuar etj.

43. SEECP nuk ishte e aftë të dilte me një qëndrim për çështjen e Kosovës në 1999.

rajoni është njëkohësisht shans dhe sfidë. Ai është një shans sepse drejtohet gjithnjë e më tepër nga vendet e rajonit, por njëkohësisht është një sfidë sepse duhet të jetë i suksesshëm për të nxitur më tepër iniciativa të ardhura dhe drejtuara nga vetë rajoni.

Sfida reale e Ballkanit Perëndimor, është krijimi i iniciativave rajonale të iniciuara nga vetë shtetet e rajonit.

Referenca

1. *2001-2002 Strategic Panorama*. Grupi i punës nr. 5/01, (Madrid: Spanish Institute for Strategic Studies, 2002)
2. Barry Buzan. *“People, States, and Fear: An Agenda for International Security Studies in the Post-Cold War Era”*, edicioni 2-të (New York: Harvester Wheatsheaf, 2004).
3. Barry Buzan and Ole Waever. *Regions and Powers. The structure of international Security*. Në *Cambridge Studies in International Relations 91*. (Cambridge: Cambridge University Press, 2003).
4. Fabian Schmidt. *Albania: Precarious Stability*. In *Brassey’s Central and East European Security Yearbook 2002 Edition*. Përpunuar nga Daniel N. Nelson dhe Ustina Markus, (Virginia: Brassey’s Inc. 2002)
5. John R. Wise. *Bosnia-Herzegovina: Security and other dilemmas*. Në *Brassey’s Central and East European Security Yearbook 2002 Edition*, (Virginia: Brassey’s Inc, 2002)
6. Jed C. Snyder. *Croatia after Tudjman, Finally to the West?* Në *Brassey’s Central and East European Security Yearbook 2002 Edition*, (Virginia: Brassey’s Inc, 2002)
7. Malcolm: *Kosovo: A Short History*. (New York: New York University Press, 1998)
8. Misha Glenny. *The Macedonian Question*. In *International perspectives on the Yugoslav Conflict*. Përpunuar nga Danchev, Alex and Halverson, Thomas, (New-York: St. Martins press INC, 1996)
9. Ole, Waever. *Aberystwyth, Paris, Copenhagen - New ‘Schools’ in Security Theory and their Origins between Core and Periphery*, Studim i paraqitur në takimin vjetor të shoqatës ndërkombëtare të studimeve (International Studies Association), Montreal, Mars 17-20, 2004.
10. Othon Anastasakis dhe Vanesa Bojicic-Dzelilovic. *Balkan regional cooperation & European Integration*. (London: The Hellenic Observatory of The London School of Economics and Political Science, July 2002).

11. Radovan Vukadovic. *Former Yugoslavia: International efforts to link peace, stability and democracy, Në Democratic consolidation in Eastern Europe*. International and transnational factors, Vol. 2, Përpunuar nga Jan Zielonka and Alex Pravda, (New-York: Oxford University Press, 2001).

12. *Regional cooperation in the western Balkans. A policy priority for the European Union*. Zyra për publikime zyrtare të komunitetit europian, Belgjikë: Komisioni europian, 2006

13. Stefano Bianchini. *The cultural scope of Balkan security*. In *Mediterranean security*. I përpunuar nga Blank, Stephen J. (Carlisle: Strategic Studies Institute, 1999).

14. Susan L. Woodward. *Balkan tragedy. Chaos and dissolution after the cold war*. (Washington DC: The Brookings Institution, 1995).

15. Stephen White and Judy Batt and Paul G.Luis, *Central and East European Politics*. (Houndmills: Palgrave Macmillan, 2007).

16. Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. "Accordance with international law of the unilateral declaration of independence in respect of Kosovo Jurisdiction". (Hagë: Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, 22 korrik, 2010).

17. Wolfgang Petritsch. *Sovereignty, State failure and humanitarian intervention. The international community in the Post-Yugoslav space*. Crossroads. The Macedonian Foreign policy journal, Vol. I Nr.4, prill-tetor, 2008.

18. Faqja e internetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, <http://www.mfa-ks.net/?page=1,4,623>.

19. Faqja e internetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Serbisë <http://www.mfa.gov.rs/Diasporaframe.htm>.

20. Faqja e internetit e Ministrisë së Punëve të Jashtme së Malit të Zi: <http://www.mip.gov.me/en/index.php/Bilateral-Relations/republic-of-serbia.html>.

21. Faqja e internetit e OSBE. *Parallel structures in Kosovo 2006-2007*, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, <http://www.osce.org/kosovo/24618>.

22. *Comments on the Report of the UN Secretary-General on the United Nations Interim Administration in Kosovo (1 September - 30 November 2007)*, Beograd: Republika e Serbisë, Ministria për Kosovën dhe Metohinë, 2007.

23. <http://www.mfa.gov.rs/Foreinframe.htm>.

Jonida Hoxha, LLM

ZHVILLIMI I PAKTIT TË STABILITETIT DHE MODELET E BASHKËPUNIMIT RAJONAL NË FUSHËN E SIGURISË TË FITUARA PREJ TIJ.

I - Hyrje

Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (*Regional Cooperation Council*) është një organizatë rajonale që shërben si një platformë bashkëpunimi ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore¹ me qëllim “promovimin e bashkëpunimit reciprok dhe integrimin Evropian dhe Euro-Atlantik të Evropës Juglindore, në mënyrë që të inspirojë zhvillimin e rajonit në përfitim të popullsisë”.

Një ndër fushat e fokusit të platformës së KBR-së, është dhe bashkëpunimi në fushën e sigurisë. Në këtë kuadër KBR-ja, ka ndërmarrë një sërë iniciativash që kanë të bëjnë me bashkëpunimin në fushën e shërbimeve sekrete ushtarake, kundërzbulimit dhe në bashkëpunimin e Autoriteteve të Sigurisë Kombëtare, në fushën e mbrojtjes së Informacionit të Klasifikuar.

Qëllimi është përforcimi i marrëdhënieve ndërmjet strukturave të sigurisë së vendeve anëtare nën mbikëqyrjen e Bashkimit Evropian; por a është kjo një nisëm pragmatiste apo një aspiratë tepër ambicioze kjo mbetet për t'u parë.

Qëllimi i këtij shkrimi është të analizojë rolin e KBR-së, në lidhje me bashkëpunimin në fushën e sigurisë duke shqyrtuar avantazhet si dhe dobësitë që kjo çështje mbart në rajonin e trazuar të Evropës Juglindore, si dhe potencialin real që mund të ofrojë vullneti politik i shprehur në mbështetje të kësaj nisme.

II - Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore

Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore ishte një nisëm e ndërmarr në qershor 1999, në përfundim të luftës së fundit në

1. RCC ka në përbërje 13 shtete. Shqipërinë, Bosnjë-Herzegovinën, Bullgarinë, Greqinë, Kroacinë, Kosovën (të përfaqësuar nga UNMIK sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB), ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi, Moldavinë, Rumaninë, Serbinë, Slloveninë dhe Turqinë.

ish-Jugosllavi, nga asokohe vendet e Bashkimit Evropian, me qëllim zhvillimin e një strategjie të përbashkët për stabilitet dhe zhvillim të rajonit dhe bashkëpunimin me njëri-tjetrin si dhe me donator të mëdhenj, me qëllim implementimin e kësaj strategjie.

Pakti i Stabilitetit përbënte një plan pune për nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe integrimin në strukturat Evropiane dhe Euro-Atlantike. Sekretariati i Paktit ishte i vendosur në Bruksel dhe i organizuar në tre njësi, secila prej të cilave merrej me një çështje të caktuar. Tivolina e Punës I, kishte për fokus Demokratizimin dhe të Drejtat e Njeriut. Tivolina e Punës II, fokusohet në rindërtimin ekonomik, bashkëpunimin dhe çështjet e zhvillimit dhe Tivolina e Punës III, me çështjet e Sigurisë.

Ky shkrim do të fokusohet vetëm në çështjet e trajtuara në Tivolinë e Punës III, çështjet e sigurisë pasi një analizë e hollësishme e tërë veprimtarisë së zhvilluar në kuadër të Paktit të Stabilitetit, do të kërkonte një hapësirë më të gjatë dhe botime shumë më voluminoze.

Tivolina e Punës III

Duke qenë se koha në të cilën u formua Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore përkonte me mbarimin e luftërave në ish-Jugosllavi, vetë misioni dhe qëllimi kryesor që u formua ishte krijimi i një atmosfere paqeje dhe stabiliteti në rajon si dhe mbikëqyrja e orientimi Evropian dhe Euro-Atlantik i këtyre vendeve, si pjesë përbërëse e politikave të brendshme të secilit prej vendeve anëtare.

Tivolina e Punës III u mor me çështje të Sigurisë si të brendshme ashtu edhe të jashtme. Qëllimi i së cilës ishte vendosja e një atmosfere sigurie të qëndrueshme në rajon, si dhe promovimi i bashkëpunimit rajonal në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit si dhe me çështjet e emigracionit.

Puna e kësaj tavoline ishte e ndarë në disa nënnyjësi të cilat në bazë të fushës së veprimit funksiononin në bazë të Taks Forcës.

Nëntryeza mbi Mbrojtjen dhe Sigurinë

Qëllimi kryesor të cilit kjo tryezë do t'i shërbente ishte sfida e rikonstruktimit të Sektorit të Sigurisë në Evropën Juglindore. Mbas rënies së sistemeve totalitare, të cilat mbartnin arsenale

të mëdha armatimesh në vendet e Evropës Juglindore, ishte e nevojshme gjetja e një metode të përbashkët dhe efikase për rikonstruktimin dhe zvogëlimin e forcës ushtarake, duke i përshtatur ato me realitetin e ri të sigurisë si dhe atë ekonomik të rajonit.

Kjo nisëm duhet thënë që më shumë se një ndër fokuset e Tryezës III, të punës së Paktit të Stabilitetit, ishte pjesë e strategjive të sigurisë së të gjithë vendeve anëtare të Evropës Juglindore, si dhe një ndër kërkesat e parashtruara në plan veprimin e anëtarësimit në NATO, organizatë pjesë e së cilës aspironin të bëheshin të gjitha vendet e rajonit.

Duhet përmendur që NATO², si drejtues i Taks Forcës, për transformimin e mbrojtjes në Paktin e Stabilitetit, u fokusua në monitorimin e programeve që lidheshin me ritrajnimin e pothuaj gjithë personelit të mbrojtjes dhe transformimin e pikave ushtarake në vendet e Evropës Juglindore.

Transformimi i mbrojtjes operoi me statusin e Taks Forcës prej vitit 2000 deri më 2005. Në këtë vit misioni i nëntryezës mbi transformimin e mbrojtjes iu delegua qendrës RACVIAC³ me qendër në Zagreb, Kroaci.

Iniciativa e përgatitjes ndaj dhe parandalimit të fatkeqësive

Kjo Taks Forcë ishte një ndër iniciativat mbi, të cilat nuk kishte precedent bashkëpunimi në rajon. Evropa Juglindore për vetë pozicionin gjeografik është pre e fatkeqësive që tejkalojnë kufijtë dhe tronditin mundësitë e angazhimit të një vendi. Për këtë arsye kjo iniciativë ka arritur të marr mbështetjen e 12 (dymbëdhjetë) prej vendeve anëtare të rajonit me mbështetjen e organizatave të tjera ndërkombëtare dhe shteteve të tjera, për të krijuar një strukturë për zhvillimin e programeve apo projekteve që lidhen me forcimin e kapaciteteve të parandalimit dhe reagimit ndaj

2. Në këtë proces kanë qenë të përfshirë edhe shumë aktorë të tjerë ndërkombëtarë si: DCAF, BICC, IOM, OSCE, UNDP, WB, COEDB si dhe shumë organizata lokale joqeveritare.

3. RACVIAC (Regional Arms Control Verification and Implementation Assistance Centre) u themelua në vitin 2000, nga qeveria Kroate në bashkëpunim me Republikën Federale Gjermane. Qëllimi i krijimit ishte trajnimi i forcave të armatosura, promovimi i besueshmërisë dhe ngritja e masave të sigurisë si dhe zgjerimi i bashkëpunimit në Evropën Juglindore. Më vonë fokusi i RACVIAC u zgjerua, duke përfshirë një gamë të gjerë çështjesh politiko-ushtarake, që përfshijnë reformën në sektorin e sigurisë me fokus në transformimin ushtarak dhe vizion përforcimin e stabilitetit rajonal.

fatkeqësive si atyre natyrore ashtu dhe atyre të shkaktuara nga njerëzit. Qëllimi i kësaj iniciative është forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit rajonal, në rastet e këtyre fatkeqësive.

Vlen për t'u përmendur që kjo iniciativë në ndryshim me të tjera nuk funksionon në bazë të një institucioni të ngritur prej vendeve anëtare, por ka për qëllim trajnimin e personelit të vendeve anëtare të cilët punojnë në fushën e parandalimit dhe reagimit ndaj fatkeqësive natyrore, për sfidat e përbashkëta me anë të shkëmbimit të eksperiencave, informacionit dhe mësimëve të nxjerra nga rastet e suksesshme të përballimit të situatave të emergjencës.

Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal

Pakti i Stabilitetit rezistoi dhe operoi me sukses për 9-vjet, deri më 27 shkurt 2008, ku dhe u lançua transformimi i Paktit të Stabilitetit në një organizatë rajonale, ai që quhet “Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal”. Qëllimi kryesor i këtij transformimi ishte indikator i besimit dhe angazhimit serioz të vendeve të Evropës Juglindore, në lidhje me platformën e Paktit të Stabilitetit, për këtë arsye KBR-ja, shërben si krahu operacional i Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEEC⁴).

Gjithashtu, integrimi i tre prej shteteve të Evropës Juglindore në BE⁵ dhe progresi i bërë prej të gjithë vendeve të tjera të Evropës Juglindore, në lidhje me integrimin e tyre në Organizatën e Bashkimit Evropian rrjedhimisht përforcoi besimin dhe solli në vëmendje të vendeve formuese të Paktit të Stabilitetit, domosdoshmërinë e transformimit të këtij pakti në një Organizatë Rajonale të përbërë dhe drejtuar nga vetë vendet anëtare të Evropës Juglindore.

Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal trashëgoi mandatin e Paktit të Stabilitetit, për të mbikëqyrur proceset e bashkëpunimit në Evropën Juglindore, si dhe për të mbështetur integrimin Evropian dhe Euro-Atlantik të rajonit dhe operon me këtë mandat që prej vitit 2008. KBR-ja, e ka shtrirë misionin e tij në kuadër të përshtatjes me realitetin e Evropës Juglindore⁶.

4. Themeluar në vitin 1996 është një platformë bashkëpunimi e vendeve të rajonit duke shërbyer si zëri i tij në lidhje me bashkëpunimin politik dhe atë të demokracisë me qëllim integrimin në BE dhe NATO.

5. Sllovenia në 2004 dhe Rumania me Bullgarinë në 2007.

6. RCC Strategy and Work Programme 2011-2013.

KBR-ja, e zhvillon aktivitetin e tij me bazë zhvillimin ekonomik dhe social, infrastrukturën, drejtësinë dhe çështjet e brendshme, bashkëpunimin në fushën e Sigurisë dhe ndërtimin e kapitalit human, duke mbajtur relata të ngushta pune me të gjithë aktorët përkatës si p.sh.: qeveritë, organizatat ndërkombëtare, institucionet financiare ndërkombëtare, organizatat rajonale, shoqërinë civile si dhe sektorin privat⁷.

Në fushën e Sigurisë KBR-ja, ka ndërmarr iniciativa që nuk janë parë më parë në rajon. KBR-ja, synon të krijojë forume bashkëpunimi ndërmjet:

- Drejtuesve të Politikave të Mbrojtjes në Evropën Juglindore
- Autoriteteve Kombëtarë për Sigurimin e Informacionit në Evropën Juglindore
- Shefave të Shërbimeve Inteligjente Ushtarake të Evropës Juglindore
- Shefave të Drejtorive të Kundër Zbulimit në Evropën Juglindore

Të gjitha këto iniciativa i kanë ndërmarr hapat e para dhe deri tani është zhvilluar të paktën një forum për secilën prej tyre. Tryeza e parë e punës së ekspertëve të Autoriteteve Kombëtare për Sigurimin e Informacionit është zhvilluar në Tiranë, gjatë muajit nëntor 2011, me mbështetjen e NATO-s dhe BE-së.

Konkluzione

Roli i Paktit në më të shumtën shërbeu si platformë për kanalizimin e fondeve të rindërtimit dhe koordinimin e aktiviteteve të donatorëve me bazë bashkëpunimin rajonal por jo vetëm, ai shërbeu si kupolë nxitëse dhe drejtuese në lidhje me aspiratat e integritit të vendeve të rajonit. Mandati i gjerë dhe mbështetja e madhe ndërkombëtare e lejuan atë të luante një rol kyç në nxitjen dhe konkretizimin e nismave rajonale në fushat e përcaktuara në Deklaratën e Kolonjës, më 10 qershor 1999.

Numërohen më shumë se 50 nisma rajonale në fushën e Sigurisë, shumica prej të cilave nuk zotërojnë as fondet as drejtimin e duhur për të përmbushur misionin e tyre.⁸ Ky është padyshim një problem që nuk mund të zgjidhet brenda ditës dhe

7. Pika 6, Statuti i Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, Sofje 2008. <http://www.stabilitypact.org/rt/RCC%20Joint%20Declaration%20-%20Final.pdf>.

8. Mitja Mocnic, "Slovenia and Euro-Atlantic Integration" *Lessons learned, Harvard Black Sea Security Program, 2010, p. 6-12.*

nuk do t'i shërbente misionit për të cilin vendet e rajonit i kanë ndërmarrë. Etja për integrim dhe reformim ka sjellë që çdo iniciativë e propozuar të ndërmerret, pa u marrë në konsideratë plan veprimet e caktuara. Megjithatë vihet re që në nivel operacional nismat kanë funksionuar dhe kanë tejkaluar dhe pritshmërisë së parashikuara nga vetë themeluesit për këtë arsye bazuar në eksperiencën e përfuar vendet e Evropës Juglindore, duhet të ndjekin shembujt më produktiv dhe të fokusojnë nismat e tyre drejt arritjes së rezultateve. Fatmirësisht, shembuj të tillë ekzistojnë.

**Rade Rajkovchevski, MSC
dhe Dimitar Kirkovski, MA**

DIMENSIONI RAJONAL I PJESËMARRJES NË MISIONET JASHTË VENDIT

Abstrakt

Ngjarjet e viteve '90 patën ndikim të rëndësishëm për Paqen dhe Stabilitetin në Evropë dhe më gjerë. Rënia e Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë, paqëndrueshmëria politike dhe fillimi i proceseve demokratike, që lidhen me ndryshimet si pasojë e tranzicionit në vendet post-socialiste, nevoja për të ripërcaktuar doktrinat kombëtare, duke përfshirë edhe strategjitë e NATO-s, efektet e intensifikimit të globalizimit që lidhen me migracionin për arsye ekonomike dhe kriza e refugjatëve; rritja e porozitetit të kufijve që krijoi mundësinë për kalimet e paligjshme të kufirit, trafikimin e mallrave të paligjshme dhe fluksin e madh të njerëzve në Evropë, e ndryshoi shumë tablonë e Sigurisë së Kontinentit. Në zonat që po e merrnin veten nga pasojat e konflikteve etnike, përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare për të zgjidhur çështjet e sigurisë mes shteteve rezultuan si zgjidhja e duhur për përsheptimin e reformave në Sektorin e Sigurisë, në kuadër të përmbushjes së kërkesave për proceset e integritimit Euro-Atlantik. Në vitin 2003 u nënshkrua Karta e Adriatikut, sipas modelit të grupit Vilnius disa vite më parë në 2000. Kështu, rajoni i Evropës Juglindore, nga përdorues i shërbimeve të misioneve të huaja ushtarake, filloi të kontribuonte në misionet që mbështesin paqen në botë. Megjithëse disa vite më parë ishte e pamundur, sot përfaqësuesit e shtetit dhe oficerët e ushtrisë po e shprehin hapur formimin e një njësie ushtarake të vendeve të Ballkanit Perëndimor, që do të ketë si detyrë trajnimin e forcave të sigurisë afgane, mbase më herët se viti 2012.

Bashkëpunimi Rajonal në misionet ushtarake, nuk është një praktikë e panjohur në Evropë. Republika Çeke dhe Sllovakia, vendet Skandinave, të Beneluksit dhe vende të tjera që ndodhen në një rajon kanë praktikuar dërgimin e trupave të tyre në misione të përbashkëta dekada më parë. Duke analizuar

situatën në fushën e mbrojtjes, ky shkrim ka për qëllim që të shpjegojë arsyet, që ekspertët i identifikojnë si baza për Bashkëpunimin Rajonal të vendeve të vogla në pjesëmarrjen në misionet ndërkombëtare.

Pjesëmarrja në misionet ushtarake nuk është një fjalë e panjohur në territorin e Ballkanit Perëndimor (BP): gjatë viteve '90, Perëndimi dërgoi kontingjente ushtarake në ish-Jugosllavi, me qëllim që të ndalonte konfliktet dhe gjakderdhjen. Sot, të njëjtat vende kanë tashmë një histori të vetën për sa i përket dërgimit të trupave në misionet ushtarake në rajonet e krizave në botë, si në Irak, Afganistan, Somali, Çad dhe në misionet e OKB-së, në Qipro, Liban, Liberi, Sudan, Sahara Perëndimore, etj.

Siguria e pandashme e botës moderne në ditët e sotme shtron një sfidë të re për vendet e Ballkanit Perëndimor: Bashkëpunimi Rajonal dhe pjesëmarrja në misionet jashtë vendit. Megjithëse shumica e këtyre vendeve kishin një bazë të përbashkët dhe më tepër se sa thjesht bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e sigurisë, meqenëse jo shumë kohë më parë ato ishin pjesë e të njëjtit shtet. Ky fakt specifik mund të jetë më shumë një barrë se sa një lehtësim, për shkak të natyrës së ngjarjeve gjatë dhe pas shpërbërjes së Jugosllavisë.

Bashkëpunimi rajonal në pjesëmarrjen në misione jashtë vendit tingëllon si diçka e re apo diçka e jashtëzakonshme, por në fakt ai nuk është i tillë. Nuk mund të mendojmë për një konflikt në historinë moderne me vetëm dy palë ndërluftuese. Brezi i IV i luftës thotë se, luftërat sot janë pa shtetësi, kundërshtari në vetvete është pjesë integrale e njerëzve dhe është shumë e vështirë për ta ndarë atë nga njerëzit.¹ Edhe nëse ne e shohim luftën në një qasje më klasike, përsëri do të gjejmë më shumë se dy “pjesëmarrës”, pavarësisht nëse jemi duke shqyrtuar një konflikt të vogël ose më të madh. Për vite me radhë, aleancat ushtarake janë krijuar nga vlerat apo interesa të përbashkëta. E shkuara e afërt tregon se edhe kur një superfuqi shtetërore mund të arrijë fitoren e vetme, ajo angazhohet në lloje të ndryshme koalicionesh,² në mënyrë që të legjitimojë ndërhyrjen.

Megjithatë, pyetja që bëhet në këtë rast është se cilat misione duhet të analizojmë nëse dëshirojmë që të shikojmë qasjen rajonale? E drejta ndërkombëtare justifikon ndërhyrjet kundër

1. Sipas gjeneratës së IV të luftës, si në William S. Lind et al., “Ndryshimi i Pamjes së Luftës: Në Gjeneratën e Katërt”. Gazeta e “Trupave Detare” (tetor 1989): 22-26.

2. Për shembull, Koalicioni i gatshëm, ose koalicioni antiterrorist.

çdo vendi që është një kërcënim për paqen në botë në përputhje me Kartën e OKB-së³, dhe lejon përdorimin e forcës nga anëtarët e OKB-së. Pa u ndalur shumë gjatë në çështjen e mandatit, ne duam të theksojmë vetëm një fakt: të gjitha shtetet e Ballkanit (me përjashtim të Serbisë) duan të bëhen (ose janë tashmë) pjesë e NATO-s. Kjo karakteristikë rajonale shumë specifike, ka ndikim thelbësor në drejtim të bashkëpunimit rajonal të vendeve të Ballkanit Perëndimor në misionet ushtarake.

Kjo është arsyeja pse në këtë shkrim, kur flasim për misionet ushtarake ne do t'i referohemi më së shumti misioneve të drejtuara nga NATO.

Bashkëpunimi ndërmjet vendeve të NATO-s dhe vendeve partnere në misionet ushtarake

Bashkëpunimi i vendeve të NATO-s, në misionet ushtarake është diçka logjike, sepse vetë Aleanca është e përbërë nga vende me kuadër ideologjik të ngjashëm, Demokraci⁴ Liberale. NATO u krijua si një Aleancë Ushtarake në vitin 1949, në mënyrë që të parandalonte kërcënimin që përbënte Bashkimi Sovjetik për Evropën Perëndimore. Për këtë qëllim, përveç vullnetit politik për bashkëpunim ushtarak midis vendeve anëtare, ishin të nevojshme forca ushtarake të fuqishme dhe konkrete. Komponenti ushtarak ishte një pjesë shumë e rëndësishme e Aleancës. Së bashku me këtë, strukturat komanduese ushtarake ishin të nevojshme për të shfaqur solidaritetin dhe unitetin e Aleancës dhe më tepër për aftësinë komanduese dhe të kontrollit të këtyre forcave. Në këto struktura të ndryshme komanduese,⁵ secili vend anëtar ishte i përfaqësuar nga oficerë dhe nënoficerë.

Ndryshimi i menjëhershëm i mjedisit të sigurisë së Evropës në vitet nëntëdhjetë (kryesisht për shkak të zhdukjes së kërcënimit Sovjetik), solli një sërë transformimesh në NATO. Deri në shpërbërjen e ish-Bashkimit Sovjetik fusha e operacioneve të NATO-s, ishte e kufizuar gjeografikisht në territorin e shteteve anëtare. Lufta në Ballkan e ndihmoi NATO-n, për të ripërcaktuar rolin e saj dhe për të filluar operacionet jashtë territorit të NATO-s, dhe pas kësaj jashtë territorit

3. Kapitulli 7 nga Karta e OKB-së (1945), neni 48: “Veprimi që nevojitet për të zbatuar vendimet e Këshillit të Sigurimit, për ruajtjen e paqes dhe Sigurisë Ndërkombëtare do të ndërmerret nga të gjithë Anëtarët e Kombeve të Bashkuara ose disa prej tyre, siç mund të vendosë Këshilli i Sigurimit”.

4. Nuk do zgjatemi shumë me këtë premisë për çështjen e liberalizmit të Turqisë.

5. Shtabi Ushtarak Ndërkombëtar dhe Komandat e ndryshme të përbëra (tokësore, detare dhe ajrore) të shpërndara në të gjithë Evropën.

të Evropës, p.sh. në Afganistan. Strategjitë e NATO-s, filluan të ndryshonin në përputhje me kërcënimet e reja. Një pjesë e këtij transformimi ishte fakti që NATO, ndërtoi programe dhe mekanizma të ndryshme për bashkëpunim me vendet që dolën nga Pakti i Varshavës dhe ish-Bashkimi Sovjetik, ish-Jugosllavia dhe vendet e Mesdheut gjithashtu, Lindja e Afërme, madje edhe shtete si Australia, Zelanda e Re, Koreja e Jugut dhe Japonia⁶. Partneriteti për Paqen (PPP) kishte si rol kryesor përgatitjen e anëtarëve të ardhshëm të NATO-s, për funksionet dhe detyrat e vetë anëtarësisë. Në shumicën e rasteve PPP, i shërbeu vendeve për transformimin e forcave të armatosura në mënyrë që ata të mund të kontribuojnë në mënyrë të barabartë në luftë së bashku me forcat e armatosura të anëtarëve të NATO-s. Një pjesë e këtyre vendeve kishin tashmë përvojë në misionet paqeruajtëse në zonën e Ballkanit⁷, por vetëm në vitin 1999, ata shfaqën gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë në luftime në fushatën ajrore të Kosovës pas anëtarësimit në NATO.

Një tjetër fakt që ndikon në bashkëpunimin rajonal të vendeve është se, nga fillimi i funksionimit të saj NATO nuk ka forca të vetat, por për çdo mision i gjeneron forcat nga anëtarët e saj. Kjo do të thotë që secili prej vendeve që duan të marrin pjesë në misione të caktuara kontribuojnë me forcat e tyre. Prandaj, bashkëpunimi nuk është çështje zgjedhjeje apo dëshire, por një çështje domosdoshmërie. Kjo nuk vlen vetëm për anëtarët e NATO-s: partnerët e saj janë gjithashtu një pjesë e rëndësishme e misioneve të drejtuara nga NATO. Në "Konceptin Strategjik për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Anëtarëve të NATO-s" nga 2010 i kushtohet më shumë vëmendje marrëdhënieve me shtetet partnere. Edhe në parathënie thuhet se Koncepti Strategjik, do të udhëheqë fazën tjetër të evolucionit të NATO-s, në mënyrë që ajo të vazhdojë të jetë efektive në një botë në ndryshim, kundër kërcënimeve të reja, me kapacitete dhe partnerë të rinj. Ky koncept i ofron partnerëve në të gjithë globin angazhim politik më të madh në Aleancë, si dhe një rol të rëndësishëm në formësimin e operacioneve të drejtuara nga NATO ku ata kontribuojnë. Dhe për sa i përket marrëdhënieve dhe bashkëpunimit me shtetet partnere në misionet ushtarake, koncepti strategjik në nenin 30 thotë "Ne do të rrisim partneritetet tona nëpërmjet formateve

6. Për shembull, Këshilli për Partneritetin Euro-Atlantik, nisma e Stambollit për Bashkëpunim dhe Vetat e Kontaktit.

7. Shumë vende nga PPP dhe marrëveshje të ndryshme morën pjesë në misionin e IFOR në Bosnje- Hercegovinë: Republika Çeke, Sllovakia, Polonia, Estonia, Lituania, Letonia, Ukraina, Suedia, Pakistani etj.

fleksibël që sjellin NATO-n dhe partnerët së bashku përtej kornizave ekzistuese... Ne do t'i japim partnerëve tanë operativë një rol strukturor në formësimin e strategjisë dhe vendimeve në misionet e drejtuara nga NATO, në të cilat ata kontribuojnë”.

Qëllimi i bashkëpunimit midis NATO-s dhe partnerëve në misionet ndërkombëtare në të gjithë botën përshkruhet më mirë me këtë fakt të vetëm: 48 vende janë pjesë e misionit të ISAF në Afganistan, si anëtarët e NATO-s ashtu dhe partnerët e NATO-s.⁸

Kushtet që paracaktojnë qasjen rajonale të vendeve të Ballkanit Perëndimor në misionet jashtë vendit

Transformimi i forcave të armatosura të vendeve të BP (së bashku me shoqëritë dhe sistemet politike në përgjithësi), pas ngjarjeve të viteve nëntëdhjetë çoi në ndryshimin e rolit kryesor të forcave të armatosura: kalimin nga mbrojtja nga sulmet e jashtme nga fqinjët në dhënien e kontributit për Paqen dhe Stabilitetin Rajonal dhe mbështetjen e politikës së jashtme të shtetit⁹. Ripërcaktimi i

8. NATO 2011. *Forca e Asistencës së Sigurisë Ndërkombëtare (ISAF): Faktet dhe shifrat kryesore. (Të dhënat e marra në 4 mars, 2011) SHAPE HQ të NATO-s, Mons, Belgjikë.* <http://www.isaf.nato.int/images/stories/File/Placemats/PLACEMAT.MARCH%2004...pdf>.

9. *Misioni i Ushtrisë së Republikës së Maqedonisë është “të përgatitet, organizohet dhe stërvitet për luftë dhe veprime të tjera me qëllim që të përmbushë rolin dhe funksionin e saj kushtetues për mbrojtjen e Republikës së Maqedonisë dhe të marrë pjesë në misionet për mbështetjen e paqes, misionet defensive dhe antiterroriste në vend dhe jashtë vendit, bashkë me ose si pjesë e sistemeve të tjera të përbashkëta mbrojtëse” (NATO, BE, PPP). Burimi: Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Maqedonisë, “Misija na Armijata na Republika Makedonija,” Shkup, Maqedoni, <http://www.morm.gov.mk/morm/mk/ARM.html>.*

Misioni i forcave të armatosura të Shqipërisë thotë se ato janë “të angazhuara në mënyrë aktive në përmbushjen e misionit kushtetues: ruajtjen e pavarësisë, sovranitetit dhe tërësisë territoriale të vendit, mbrojtjen dhe mbështetjen e popullit në kohë paqeje, krize e lufte, si dhe dhënien e kontributit për paqen dhe sigurinë në rajon e me gjere”. Burimi: Forcat e Armatosura Shqiptare. Misioni i Forcave të Armatosura Shqiptare. Tiranë, Shqipëri. <http://www.aaf.mil.al/mat.php?idr=61&idm=430&lang=EN>.

Në Kroaci, zhvillimi i kapaciteteve kryesore përqendrohet në planifikimin e proceseve dhe operacioneve të përbashkëta, si dhe operacionet shumëkombëshe në përgjigje të krizës, duke përfshirë vendosjen e Forcave të Armatosura Kroate, përtej territorit kombëtar por brenda Forcave Aleate (NATO, OKB, BE apo forca të tjera të koalicionit) dhe në përputhje me interesat kombëtare dhe burimet e Kroacisë”. http://www.osrh.hr/data/about_en.asp.

Në Bosnje-Hercegovinë, detyra kryesore e Forcave të Armatosura është “pjesëmarrja në operacionet e përbashkëta të sigurisë, në operacionet për të mbështetur paqen dhe vetëmbrojtjen, duke përfshirë luftën kundër terrorizmit”. Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kroacisë. Misioni i Forcave të Armatosura Kroate, Zagreb, Kroaci. <http://www.mod.gov.ba/en/text.asp?id=75>.

strategjive të sigurisë do të thoshte ndryshimin e besimeve dhe opinioneve, që kanë dominuar sistemin e mëparshëm me besime dhe opinione të reja në përputhje me konceptet moderne të sigurisë. Forcat e armatosura duhet të zgjerohin fushën e operacioneve dhe të fillonin përmbushjen e detyrave të tyre jashtë territorit përkatës, në bashkëpunim me shtete të tjera në struktura të ndryshme, me qëllim për t'iu përgjigjur terrorizmit dhe kërcënimeve të tjera. Të gjitha shtetet në rajon ende po përballen me problemet që kanë rrjedhur nga ndryshimi në ekonominë dhe në jetën e tyre politike të shoqëruara me efektet e krizës ekonomike globale. Siguria në këto vende përshkruhet më së miri me faktet e mëposhtme:

- Gjendja e rajonit në përgjithësi është e qëndrueshme ndryshe nga 10-15 vite më parë;
- Ekziston një konsensus lidhur me integrimin euro-atlantik dhe të ardhmen e rajonit që premtton siguri më afatgjatë, stabilitet ekonomik dhe rritje të qëndrueshme ekonomike;
- Reforma strategjike po ndërmerren në Sektorin e Sigurisë; dhe
- Përdorimi i ndihmës ndërkombëtare në fushën e sigurisë është ulur në minimum. Nga një konsumator, rajoni u bë një eksportues i shërbimeve të sigurisë¹⁰.

Rajoni i Ballkanit u rindërtua pas konflikteve dhe luftërave dhe shoqëria shumëetnike u rilind sërish, tani në një demokraci në tranzicion. Shumë modele të reja u përdorën dhe u provuan ekskluzivisht. Përfshirja e dukshme e komunitetit ndërkombëtar në rajon ka kontribuar shumë në ritmin e reformës së vendeve në shumë fusha: reformën e sektorit të sigurisë, trajnimin dhe drejtimin e misioneve ushtarake, parandalimin e konfliktit, trajtimin e refugjatëve, etj. Në të njëjtën kohë, bashkësia ndërkombëtare nuk e humbi kurrë interesin apo vëmendjen për proceset demokratike në zonën e Ballkanit dhe vazhdoi me investimet në bashkëpunimin rajonal. Është një proces në vazhdim në drejtim të realizimit të interesit rajonal dhe të përbashkët të secilit prej vendeve dhe në një mënyrë, kapërcimit të lëvizjeve kombëtare populiste dritëshkurtra. Anëtarësimi në NATO, pa asnjë dyshim, është një faktor që do të tërheqë drejtpërdrejtë investimet e huaja në këtë zonë, do ta çojë rajonin më afër ekonomikut drejt Evropës së zhvilluar dhe do të zgjerojë rajonalizmin në fushën e sigurisë.

10. Aktualisht vetëm dy misione të BE-së, janë ndërmarrë në Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë dhe një mision i NATO-s, në Kosovë.

Dilemat në rajon për pjesëmarrjen në misionet e përbashkëta jashtë vendit

Dërgimi i trupave në mision jashtë vendit është më shumë një çështje politike se sa sigurie. Përdorimi i forcave ushtarake është ngushtësisht kompetencë e vetë shtetit dhe në këtë rast edhe më tepër, sepse ushtarët po dërgohen me mijëra kilometra larg nga territori i shtetit. Gjërat e mëposhtme ndikojnë në këtë vendim: opinioni publik, shpenzimet e Ministrisë së Mbrojtjes, shteti në tërësi. Faktori kryesor - cilat janë fitimet në termat e interesave të shtetit.

Opinionin publik analizohet nga aspekti i mbështetjes, që njerëzit i japin politikës së mbrojtjes të vendeve. Ndryshe nga Evropa Perëndimore, ku orientimi i qeverisë (orientimi majtas ose djathtas), mund të ndikojë në vendimet për dërgimin e trupave në misione dhe ku (mos) pjesëmarrja në misione mund të jetë me shumë ndikim për të fituar zgjedhjet, në vendet e Ballkanit Perëndimor duket sikur këto gjëra nuk kanë fare rëndësi. Ndoshta kjo është për shkak të ndjesisë se, këto shtete “i detyrohen” NATO-s, për dhënien fund të gjakderdhjes dhe vendosjes së sigurisë. Popullsia në këtë rajon duket se është e imunizuar ndaj lëvizjeve pacifiste në botë dhe ajo nuk është aspak e interesuar (ose të paktën proaktive), në kufizimin e misioneve ushtarake jashtë vendit. Ekziston një përshtypje e përgjithshme se njerëzit e shohin NATO-n, BE-në dhe anëtarësimin në të dyja organizatat të lidhur me mirëqenien ekonomike dhe sociale, një gjendje e dëshiruar, kështu që pjesëmarrja në misionet ushtarake shihet si një kusht paraprak dhe një rrugë drejt qëllimit të integritetit Euro-Atlantik. Së fundi, kjo nuk është karakteristikë posaçërisht për këtë rajon: anëtarët e rinj të NATO-s, ose “Evropa e re” sipas ish- sekretarit të SHBA-së Donald Rumsfeld, janë më të zellshëm për të dërguar njësi luftarake në misione se sa shtetet e vjetra anëtare.¹¹

Kur flasim për shpenzimet e mbrojtjes dhe dërgimin e trupave në mision, në NATO ka një parim themelor për këtë temë: Kostoja bie mbi vetë vendet që angazhohen në Aleancë. Me pak fjalë, kjo do të thotë se, çdo vend që dëshiron të marrë pjesë në një mision duhet të paguajë për të gjithë shpenzimet e tij. Krahas të gjitha shpenzimeve për trajnimin e forcave, vendi duhet të paguajnë për të gjithë mirëmbajtjen e forcës dhe të pajisjeve. Ky është një

11. Donald H. Rumsfeld, Përmbledhje nga Sekretari i Mbrojtjes në Qendrën e Shtypit të Huaj, janar 22, 2003, <http://www.defense.gov/transcripts/transcript.aspx?transcriptid=1330> (parë për herë të fundit Maj 20, 2011).

proces i gjatë dhe që kërkon standarde të larta nga ana organizative dhe financiare sidomos për vendet më të vogla, në të cilin shumë kontraktues, nënkontraktues, shoqëri tregtare dhe punëtorë lokalë punësohen nga zona e vendit të misionit. Prandaj vendet më të vogla kur dërgojnë trupa në grup i bashkëngjiten shteteve më të mëdha për anën logjistike, duke nënshkruar marrëveshje të ndërsjella dhe kontingjentet e tyre janë një pjesë (nën komandën operativ-kontrollin) e kontingjenteve të shteteve më të mëdha. Vendet e Ballkanit Perëndimor deri më tani kanë dërguar kontingjente të vogla në zonat e krizave të ndryshme nëpër botë. Njësia më e madhe e dërguar nga Republika e Maqedonisë, në një mision është një njësi me madhësinë e një kompanie në ISAF në Afganistan (rreth 150 persona). E njëjta gjë vlen edhe për Republikën e Shqipërisë, njësia e tyre më e madhe gjithashtu ka madhësinë e një kompanie, dhe numri i personelit të vendosur në Afganistan është gjithsej 250. Pra, nuk është për t'u çuditur që njësia më e madhe e Republikës së Kroacisë e dërguar në një mision ka madhësinë e një kompanie dhe përsëri në Afganistan, ku numri i përgjithshëm i ushtarëve është rreth 300. Bosnje-Hercegovina sapo përfundoi rotacionin e parë të një njësie këmbësorie në Afganistan në prill 2011 – me madhësinë e një toge. Kur flasim për fitimet nga misionet për vendin në tërësi në lidhje me realizimin e interesave të një shteti, është shumë e vështirë të thuhet që ka reciprocitet ndërmjet realizimit të interesave të shtetit dhe shpenzimeve për vetë misionin. Në ndryshim nga shpenzimet të cilat mund të llogariten lehtësisht në Euro dhe Dollarë, realizimi i interesave të shtetit nuk mund të matet me lehtësi. Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare sjell një sërë detyrimesh dhe një spektër aktivitetesh në fushën e politikës së sigurisë në mënyrë që t'i përgjigjen rreziqeve dhe kërcënimeve ndaj interesave dhe vlerave të shtetit. Disa nga shtetet e BP edhe kur nuk ishin anëtarë të NATO-s, ishin pjesë e misioneve të saj dhe morën përgjegjësinë e tyre ndaj detyrimeve të sigurisë. Në fund të fundit, qëllimi i tyre ishte që të bëheshin pjesë e NATO-s dhe BE-së, si p.sh. të bëheshin pjesë e botës perëndimore e demokracive liberale. Detyrimet e tyre që të kishin 8%, të forcave të armatosura të dislokueshme dhe 2.5% të forcave të armatosura të dislokuara, të çojnë në atë drejtim. Në fund të fundit, interesi i përgjithshëm i vendeve të BP për të marrë pjesë në misione ndërkombëtare është që të jenë pjesë e “bashkësisë ndërkombëtare” dhe mos të mbeten mënjanë.

Suksesi i kontingjenteve, ndikimi i tyre në reputacionin e shtetit në politikën ndërkombëtare, është një kategori e pamatshme

gjithashtu. Kështu, thuhet shpesh që ushtarët që marrin pjesë në misione janë ambasadorët më të mirë të vendit. Deri më tani, vlera e jetës njerëzore nuk ishte pjesë e llogaritjes. Ky variabël mund të ndryshojë ndjeshëm vlerën e misionit, ai mund të ndryshojë opinionin publik dhe mbështetjen për vazhdimësinë e misionit dhe kjo madje mund të ndikojë dhe ndryshojë politikat e vendit.¹² Ky debat nuk është realizuar ende në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Aspirata për Bashkëpunim Ushtarak Rajonal në Ballkan fillimisht u manifestua me iniciativën e SEEBRIG (1998) - Brigada e Evropës Juglindore, një forcë shumëkombëshe ushtarake që mund të përdoret për ruajtjen e paqes ose operacionet e ndihmës në Ballkan dhe gjetkë. Sipas kushtetutës marrëveshja¹³, qëllimi i SEEBRIG, është që të kontribuojë në Sigurinë dhe stabilitetin rajonal dhe të nxisë marrëdhënie të mira me fqinjët ndërmjet vendeve në Evropën Juglindore, në kontekstin e procesit të SEDM-it (*Southeast Europe Defence Ministerial*), nën kujdesin e Këshilli të Partneritetit Euro-Atlantik (EAPC) dhe në kuadër të Partneritetit për Paqe (PPP). Gjithashtu, kjo brigadë shumëkombëshe përfaqëson një instrument për zgjidhjen e krizave me pjesëmarrjen e saj në operacionet paqeruajtëse dhe ndihmës humanitare. Siç ka theksuar Adam T. Joseph Lopez, ish-komandant suprem i Forcave Detare të SHBA-së, në Evropë dhe Komandant i forcave aleate të NATO-s, rajoni jugor, “SEEBRIG nuk do të jetë një zgjidhje për mosmarrëveshjet ekzistuese dypalëshe, por ajo mund të ndihmojë në largimin e perceptimeve negative që disa vende kanë për të tjerët duke zgjeruar dialogun ndërmjet vendeve anëtare¹⁴.” Në gusht të vitit 2005 u provua në praktikë qasja rajonale në misionet ushtarake jashtë vendit, kur personeli mjekësor u dërgua në Afganistan si pjesë e Ekipit të Kombinuar Mjekësor në formën A-3 (Maqedoni, Shqipëri, Kroaci)¹⁵. Këto vende vazhdojnë me misionin deri më sot. Nëse shohim sfidat me të cilat përballet misioni i përbashkët i vendeve të Ballkanit Perëndimor, shtrohen disa pyetje:

12. Për shembull, Spanja e ndërpreu misionin në Irak në 2004, si pasojë e sulmeve terroriste të Madridit dhe 11 viktimave në mision të mëparshme.

13. Shih marrëveshjen për Forcën Shumëkombëshe të paqes së Evropës Juglindore në http://www.morm.gov.mk/morm/sedm-pmsc/doc/mainColumnParagraphs/0/content_files/file/LMPFSEE-Agreement-comp.pdf.

14. Gary Dempsey and Spiros Rizopoulos, “Alternatives to a NATO-Dominated Balkans” in *NATO’s empty victory: a post-mortem on the Balkan War*, ed. Ted Galen Carpenter (Washington: CATO Institute, 2000), 146.

15. Dy vende të tjera iu bashkuan Kartës së Adriatikut (grupi A-3 i formuar nga Shqipëria, Kroacia, Maqedonia dhe SHBA) në 2008 (Bosnje-Hercegovina dhe Mali i Zi) duke formuar kështu grupin A-5.

1. Cilat janë pasojat me të cilat përballet shteti në qoftë se ai nuk merr pjesë në një mision të përbashkët?

Jo të gjitha shtetet e Ballkanit janë pjesë e NATO-s, por siç e vumë re më parë, ky fakt nuk ndikon në vendimin e tyre për të (mos) dërguar trupa si pjesë e misioneve të drejtuara nga NATO. Megjithatë, ne nuk mendojmë se do të ketë disa rrjedhoja politike për shtetin, kjo nuk do të jetë në përputhje me qëndrimet e tanishme të vendeve për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe marrëdhënieve të mira rajonale.

Nëse ka një iniciativë për formimin e forcave ushtarake rajonale që do të marrin pjesë sërish në misionin ISAF, ashtu si në të gjitha misionet e drejtuara nga NATO, nevoja për të qenë pjesë e “bashkësisë ndërkombëtare” do t'i kapërcejë interesat e ngushta kombëtare edhe më tepër për faktin se, këto vende kanë dërguar tashmë trupa në të njëjtat zona të krizave. Ashtu si grupi A-3, kuadri për Bashkëpunimin Ushtarak Rajonal mund të jetë grupi A-5, plus disa vende të tjera nga rajoni, nën drejtimin dhe udhëheqjen e SHBA-së. Ndoshta grupit do t'i vihet një emër tjetër në mënyrë që theksohet dhe njihet kohezioni dhe bashkëpunimi, si e Ballkani-7 ose diçka e ngjashme. Dihet, megjithatë, se vendet e Ballkanit Perëndimor kanë një tendencë për të përmbushur më mirë interesat e tyre ndonëse nën udhëheqjen e një fuqie më të madhe.

2. A munden forcat e sigurisë (Forcat e Armatosura dhe të Policisë) të bashkëpunojnë më mirë se politikanët? A mundet që “Sindroma e Ballkanit” të pengojë Bashkëpunimin Ushtarak Rajonal?

Ndryshe nga përshtypja e përgjithshme se ushtria është një organizatë e pandryshueshme, konservatore dhe që i reziston ndryshimeve, ushtritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor deri më tani kanë treguar vetëm të kundërtën: ato kanë pësuar ndryshime dhe transformime dhe janë të hapura për bashkëpunim me ushtri të tjera, sidomos si pjesë e një misioni jashtë vendit. Është e arsyeshme që të besojmë se, jo të gjitha fantazmat e të kaluarës janë larguar, kështu që disa anëtarë të forcave të armatosura nuk do të kenë besim të plotë tek homologët e tyre në Ballkan. Megjithatë, bindja ndaj urdhrave dhe hierarkisë si një nga parimet themelore të organizatave ushtarake do të ndihmojë në kapërcimin e këtyre sfidave, veçanërisht për shkak se një faktor shtesë i kohezionit është

armiku i përbashkët jashtë portave. Së fundi, bashkëpunimi me forcat e sigurisë afgane gjatë kryerjes së misioneve të përbashkëta, pas përfundimit të trajnimit të forcave afgane, do të diktojë që forcat rajonale të Ballkanit do të duhet të mbështeten jo vetëm tek homologët e tyre, por edhe tek kolegët e tyre afganë.

3. Cili autoritet do të përcaktojë numrin, strukturën dhe llojet e forcave dhe elementet e forcave rajonale të Ballkanit?

Nga përvoja, sfida më e madhe është që të arrihet marrëveshja politike mes liderëve të vendeve të BP. Pas kësaj, veprimet do të transferohen nga ato politike në nivel operativ për në nivelet më të ulta për të vendosur për detajet. Deri tani (në misionet në grupin A-3 ose SEEBRIG), komanda e misionit zakonisht realizohet me rotacion ndërmjet anëtarëve. Struktura dhe numri i forcave për misionin e kërkuar është në përputhje me kapacitetet e shteteve të BP. Pjesëmarrja edhe ajo simbolike, është një kontribut i madh për rritjen e Bashkëpunimit Rajonal në fushën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë.

Përfundime

Vendet e Ballkanit Perëndimor, në mënyrë që të zbatojnë strategjitë e tyre të sigurisë, janë duke rritur vazhdimisht sasinë dhe qëllimin e forcave që marrin pjesë në misionet ushtarake ndërkombëtare, pavarësisht nëse janë pjesë e NATO-s, ose të drejtuara nga organizata të tjera ndërkombëtare ku ata janë anëtarë apo me të cilën ata kanë një marrëdhënie partneriteti. Kontributi dhe reputacioni i ushtrive të BP, po çon drejt destigmatizimit të mëtejshëm të rajonit nga ngjarjet e së kaluarës. Edhe pse rajoni kishte nevojë për një impuls të jashtëm për të forcuar vullnetin e liderëve politikë për bashkëpunim, ato tani kanë një histori të vetën në dhënien e kontributit për paqen dhe sigurinë në botë. Forcat e armatosura, kur dislokohen në një mision jashtë vendit, kanë treguar se, ato mund të komunikojnë në fushë shumë më mirë se sa politikanët në tavolinë dhe se qasja e tyre profesionale i bën ata imun ndaj sfidave që dalin vazhdimisht në zonën e Ballkanit: destabiliteti politik, pasiguria ekonomike dhe marrëdhëniet e tensionuara etnike. Bashkëpunimi rajonal i tanishëm vendos një bazë për vendet e Ballkanit Perëndimor, për krijimin e forcave ushtarake rajonale për një mision të përbashkët jashtë vendit, vetëm ose së bashku me

forcat e armatosura të disa prej fuqive më të mëdha. Në çdo rast, kjo do të zgjerohet ndjeshëm bashkëpunimin rajonal dhe do të ndihmojë në integrimin e rajonit në sferën Euro-Atlantike

Referencat

Forcat e Armatosura Shqiptare. Misioni i Forcave të Armatosura Shqiptare. Tiranë, Shqipëri. <http://www.aaf.mil.al/mat.php?idr=61&idm=430&lang=EN>.

Dempsey, Gary dhe Spiros Rizopoulos. 2000. Alternativat ndaj njw Ballkani tw dominuar nga NATO. *Në fitoren e boshe të NATO-s: një post-mortem në Luftën Ballkanike*, ed. Ted Galen Carpenter, 139-154. Uashington: CATO Institute.

Qendra e Shtypit të huaj, 22 janar, 2003. <http://www.defense.gov/transcripts/transcript.aspx?transcriptid=1330>.

Lind, William S. Keith Nightengale, John F. Schmitt, Joseph W. Sutton dhe Gary I. Wilson. Tetor 1989. Ndryshimi i Pamjes së Luftës: Në Gjeneratën e Katërt. *Gazeta e "Trupave Detare"*: 22-26.

Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kroacisë. Misioni i Forcave të Armatosura Kroate, Zagreb, Kroaci. <http://www.mod.gov.ba/en/text.asp?id=75>.

Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Maqedonisë. Misija na na Armijata Republika Makedonija. Shkup, Maqedoni. <http://www.morm.gov.mk/morm/mk/ARM.html>.

NATO. 2011. Forca e Asistencës së Sigurisë Ndërkombëtare (ISAF): Faktet dhe shifrat kryesore. SHAPE HQ të NATO-s, Mons, Belgjikë. <http://www.isaf.nato.int/images/stories/File/Placemats/PLACEMAT.MARCH%2004.pdf>.

Kombet e Bashkuara, 1945. Karta e OKB-së, San-Francisko, SHBA.

Rade Rajkovchevski është asistent profesor në lëndët që lidhen me sigurinë dhe çështjet e punës së policisë në Fakultetin e Sigurisë në Shkup, Republika e Maqedonisë. Diplomuar në Akademinë Ushtarake në Shkup (ish-oficer këmbësorie në Ushtrinë e Republikës së Maqedonisë). Ai i përfundoi studimet pasuniversitare (me mesatare 9.12 nga 10) dhe mbrojti me sukses temën e Masterit me titull "Elemente të politikës së sigurisë që kanë për qëllim parandalimin e konflikteve në Republikën e Maqedonisë" (maj 2010). Studiues në projektin e financuar nga BE "COMPOSITE: Studime krahasuese të policisë në BE" (2010-2014) nga FP-7, Programi i Sigurisë.

Dimitar Kirkovski u diplomua në Akademinë Ushtarake në Shkup, Republika e Maqedonisë në vitin 2002, dhe tani është Oficer Këmbësorie në ushtrinë e Republikës së Maqedonisë. Ai përfundoi studimet pasuniversitare për Politikën Ndërkombëtare në Fakultetin Juridik “Justinian Primus” (me mesatare 9.85 nga 10) dhe mbrojti me sukses tezën e MASTERIT me titull “Vendimmarrja në NATO” (dhjetor 2009). Në vitin 2010 u vendos në Afganistan, si pjesë e Taks Forcës “Phoenix” dhe ka përvojë me sfidat që dalin në një vend dhe njësitë kur merr pjesë në një mision jashtë vendit.

ABSTRACTS

Cristina Galusca
Prospects of the Western Balkans Development in terms of Security and Economic Cooperation

The profound economic crisis requires the re-evaluation of the usefulness of EU's policy instruments. It is said that structural and cohesion funds must be used more to counteract the recession's effects and for fiscal consolidation is the euro area countries.

The current challenges to peace and security require a global response based on cooperation and an effective multilateral system. At the level of the financial-economic system, in the component states of the former Federal Republic of Yugoslavia, we can speak of a differential evolution, driven by specific national policies. All countries need to focus on good governance, rule of law and the acceleration of economic reform.

Western Balkan countries are surrounded on all sides by EU Member States. The prospect of membership encouraged them to prioritize their objectives that they share with the EU. Cooperation between NATO and the EU in the Balkans provided the best example of what the two organizations can do together.

Enis Fita
Global Security Challenges and the Necessity of Regional Cooperation for the Integration of Western Balkans

Balkan' region countries are involved in a persistent process of integration into EU and NATO structures. In terms of this concrete problematic, they are determining their future development tendencies of complying and restructuring towards global and regional security behaviour models. The old-time security challenge of Western Balkan countries relied in securing sovereignty and territorial integrity.

The geopolitical and geostrategic changes that evolved in the region after the fall of communism and consequently the dissolution of Yugoslavia brought also tensions and interethnic conflicts. Now, the concept of regional security is broader and involves the protection of values and fundamental principals of democratic systems. Fulfilling the standards of EU and NATO integration from the WB countries has been an unstoppable process, not only in terms of long democratic transition of these countries but also in terms of missing political will of political elites in the region to overcome the tensions of the past.

Balkan region, since the disintegration of Yugoslavia and the end of religious and ethnic conflicts in Bosnia and Herzegovina and Kosovo, has radically changed; thus the content and the quality of security have become more specific. Still unresolved issues and problems such as: the continuous tensions between communities in Bosnia-Herzegovina, the political conflict between Kosovo and Serbia, the name issue of Macedonia ect. are seriously threatening the stability and security of the region. This characteristic of the region makes it vulnerable to security.

The article focuses on these keen issues of regional security and their impact in EU integration of Western Balkan countries.

Governance by conditionality, network governance or both? Studying EU internal security policies in the Western Balkans

Florian Trauner

This paper aims at analyzing the EU's internal security strategy in the Western Balkans through an 'external governance' lens, differentiating between external governance by conditionality and network governance. It is argued that network governance has gained importance in the EU-Western Balkans relations, yet rather as a compliment than a replacement of the EU's governance by conditionality. In ensuring external influence, the EU has strongly relied on the leverage that has derived from the incentive of future membership. The EU's conditionality approach was strengthened by using the incentive of visa liberalization to encourage comprehensive reforms in the justice and home affairs sector. In terms of network governance, the EU has

sought on the one hand to foster the operational cooperation and networking between the EU and Western Balkans, and on the other hand to create regional cooperation structures and networks within the region.

Aspects of Regional Security in the Balkans and its Impact on Regional Cooperation

Genti Bardhi

“Western Balkans” region has a long history of conflicts and problems. It is often associated with political violence, ethnic conflicts and fragmentation of states. Even in the last two decades, this region has experienced many changes. After the disintegration of Yugoslavia, it had to pass through radical territorial changes and armed conflicts. Therefore, improving security is important not only for the region itself but also for the international actors being involved on securing and supporting the region. All these actors are looking for tools to enhance security. Due to common issues affecting the region, regional cooperation might have a great impact on improving security as well.

This article attempts to look at the region of “Western Balkans” and to support the idea that regional cooperation is an indispensable tool to resolve the issues affecting the region. It analyses some of the key issues for each country by focusing on the securitisation and regionalisation of national issues. Historical, political and economic issues might be so interlinked that they are crossing national borders and affects severely the relations (interactions) between them. Due to this linkage, relations of the countries go beyond normal relations between neighbours. Often the history, economy and politics are being securitised in order to support several national political objectives. These conditions make regional cooperation a necessity to resolve some of the most sensitive problems of the region. Common problems need common solutions and common solutions can be arranged only in the framework of regional cooperation.

The question addressed in this paper is: How are the states in the western Balkans interconnected to each-other in terms of security and what is the nature of the connection among them? Why regional cooperation in Western Balkans is important, and what are its chances and challenges?

The Evolution of the Stability Pact and its regional Cooperation Models in the Security Field.

Jonida Hoxha

Regional Cooperation Council is a regional organization working as a cooperation platform between Southeastern Europe countries for the “promotion of mutual cooperation and European and Euro-Atlantic integration of South East Europe, in order to inspire development in the region to the benefit of its people.”

One of the main focuses of the RCC is cooperation in security field. In this framework, RCC has undertaken a number of initiatives dealing with cooperation in the area of military secret services, counterintelligence and cooperation of National Security Authorities in the field of protection of Classified Information. The aim is to strengthen the relations between security structures of member states under EU oversight; but whether this is a pragmatic approach or an ambitious aspiration, is to be further observed.

The purpose of this article is to analyze the role of RCC in relation to cooperation in the security field while observing the advantages and the shortcomings of this issue in the Southeastern Europe trouble region and the real potential that the expressed political will can offer in the support of this initiative.

Regional Dimension of Participation in Missions Abroad

Rade Rajkovchevski, MSc and Dimitar Kirkovski, MA

The events in the 90s had serious implications on the peace and stability in Europe and beyond. The collapse of the USSR and Yugoslavia; political instability and the initiation of democratic processes associated with transitional changes in post-socialist countries; the need to redefine national doctrines, including NATO's strategies; the intensifying effects of globalization associated with economic migration and refugee crises; increasing porosity of borders that allowed illegal crossings, trafficking of illicit goods and large influx of people to Europe considerably changed the security picture of the continent. In the areas that were recovering from the consequences of ethnic conflicts, the efforts of the international community to resolve the security issues between states turned out to be the appropriate solution for the acceleration of reforms in the security sector in the framework of fulfilling the requirements set for the

Euro-Atlantic integration processes. In 2003 the Adriatic Charter was founded, following the pattern of the Vilnius group several years before in 2000. Thus, the region of Southeastern Europe, from users of services of foreign military missions, began contributing to world peace support missions. Although several years ago it was impossible, today the state representatives and army' officials think loudly about forming a military unit of the Western Balkans countries which will have the task to train the Afghan security forces, maybe as soon as year 2012. Regional cooperation in the military missions is not an unknown practice in Europe. The Czech Republic and Slovakia, Scandinavian countries, Benelux and others regionally connected countries practiced sending their troops on joint missions decades ago. This paper, by analyzing the situation in the defence sphere, aims to explain the reasons that experts identify as the basis for the regional cooperation of the smaller countries in participation in international missions.

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM
ÇËSHITJE EUROPIANE DHE TË SIGURISË - 20

Formati: 15.5x24 cm
Shtypur në Shtypshkronjën TOENA
Tel: + 355 4 22 40 116
Tiranë, 2011